

# **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Sektori i mbikëqyrjes, rregullativës bankare dhe stabilitetit financiar  
Drejtoria e stabilitetit financiar dhe rregullativës bankare



## ***RAPORT PËR RREZIQET E SISTEMIT BANKAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË PËR VITIN 2016***

Prill, 2017

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pranë  
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë (i pa lekturuar).



## PËRMBAJTJA

<b>Rezyme.....</b>	<b>5</b>
<b>I. Struktura e sistemit bankar .....</b>	<b>8</b>
<b>1. Karakteristikat themelore e modeleve afariste të bankave.....</b>	<b>9</b>
<b>2. Numri i bankave dhe qasja gjer te shërbimet bankare.....</b>	<b>12</b>
<b>3. Punësimi në sistemin bankar.....</b>	<b>14</b>
<b>4. Struktura sipas pronësisë dhe përqëndrimi i sistemit bankar .....</b>	<b>15</b>
<b>Analiza krahasimore në mes tre bankave nga vendet e regjionit, sipas lartësisë së treguesve të zgjedhur për veprimtarinë e tyre dhe ekspozimin ndaj rreziqeve</b>	<b>17</b>
<b>II. Rreziqet në punët bankare .....</b>	<b>20</b>
<b>1. Rreziku i kredisë.....</b>	<b>21</b>
1.1 Realizimi i riskut të kredisë në bilancet e bankave.....	23
1.2 Kapaciteti i bankave për t'u përballur me humbjet eventuale nga kreditë me probleme	26
1.3 Burime të tjera të mundshme të realizimit të rrezikut të kredisë.....	27
1.4 Simulimi i stres-testit për ndjeshmërinë e sistemit bankar në rritjen e rrezikut të kredisë .....	35
<b>2. Rreziku i likuiditetit.....</b>	<b>37</b>
2.1 Dinamika dhe përbërja e mjeteve likuide.....	37
2.2 Treguesit e likuiditetit.....	43
2.3 Struktura e maturitetit të mjeteve dhe detyrimeve .....	46
2.4 Simulimet e stresit për goditjet e likuiditetit.....	47
<b>3. Rreziku valutor .....</b>	<b>49</b>
<b>4. Rreziku nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare .....</b>	<b>55</b>
<b>5. Rreziku nga josolventiteti.....</b>	<b>61</b>
5.1. Treguesit e solventitetit dhe kapitalizimit të sistemit bankar dhe niveli i rrezikut të aktiviteteve .....	61
<b>Përparimi i kornizës rregullatore për bankat .....</b>	<b>65</b>
5.2. Lëvizjet dhe cilësia e mjeteve vetanake të sistemit bankar .....	67
5.3. Lëvizjet dhe struktura e kërkesave të kapitalit dhe kapitali i lirë i sistemit bankar .....	70
5.4. Stres-testimi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj goditjeve hipotetike .....	71
<b>Analiza e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm të bankave.....</b>	<b>72</b>
<b>III. Ndryshime të dalluara bilancore dhe profitabiliteti i sistemit bankar.....</b>	<b>76</b>
<b>1. Aktivitetet e bankave .....</b>	<b>77</b>

1.1 Kredi të subjekteve jofinanciare.....	80
1.2. Depozite të subjekteve jofinanciare .....	83
1.3. Aktivitete tjera.....	88
<b>2. Profitabiliteti .....</b>	<b>92</b>
2.1 Tregues të profitabilitetit dhe efikasitetit të sistemit bankar .....	92
2.2 Lëvizja e normave të interesit dhe diapazonit të tyre .....	96



## Rezime

Në vitin 2016 dhe veçanërisht në pjesën e parë të vitit, aktivitetet e sistemit bankar vendor ishin nën ndikim të fuqishëm të situatave politike jostabile vendore, të shoqëruara me spekulime rreth devalvimit të kursit të denarit dhe stabilitetit të bankave vendore si dhe depozitave të deponuara tek ato. Presioni spekulativ në një ambient politik të pavarur solli gjer te luhatja e opinionit dhe besimit publik në sistemin bankar (në veçanti kjo e theksuar te familjet) dhe tërheqjen e depozitave nga entitetet jofinanciare në muajin prill të vitit 2016. Tërheqja e depozitave ishte e përcjellur edhe me një prirje të lartë të familjeve për të disponuar valuta të huaja në të gatshme dhe të depozituara, që solli një rritje të kërkesës valutore në tregun e këmbimit dhe tregun valutor. Zhvillimet e pavoritshme në tregun valutor dhe atë depozitar imponuan nevojën e intervenimit të Bankës popullore për të qetësuar situatat në tregun valutor, si edhe shtrëngimin e politikave monetare nëpërmjet rritjes së normës së interesit të bonove të thesarit, si edhe të normës së rezervës së detyrueshme për detyrimet bankare në denarë me klauzolë valutore. Gjithashtu, u riaktivizuan edhe ankandet e depozitave valutore te Banka popullore edhe atë me kushte tejet të volitshme kontraktuese (normë interesi), ashtu që për bankat më e pagueshme u bë që të ruajnë valutat e tyre likuide në vend (si përgjigje e kërkesës së rritur të valutave nga klientët e bankave), që pritet të ketë efekte transmetuese pozitive edhe te normat pasive të interesit të bankave. Masat e ndërmarra nga Banka popullore dhe menaxhimi i mirë me likuiditetin nga ana e bankave, të cilat pandërprerë i realizuan të gjitha kërkesat për pagesën e detyrimeve i dhanë efektet pozitive transferuese të pritura në pjesën e dytë të vitit. Kështu që erdhi gjer te stabilizimi gradual i pritjeve të subjekteve ekonomike dhe qetësimi i ngjarjeve të pavoritshme të tregut valutor dhe atij depozitar. Kjo nga ana e saj krijoi mundësi që sistemi bankar të mbyll vitin me rritje të gjithsej mjeteve prej 5%, që është gati për një pikë përlind më pak në krahasim me rritjen e aktivitetit në vitin 2015 (5.8%).

Depozitat e subjekteve jofinanciare, pas rënies së ndodhur në gjysmën e parë të vitit 2016, në gjysmën e dytë filloi të lëviz në rritje dhe në bazë vjetore shënoi rritje solide (prej 5.4%) edhe pse diç më e ngadaltë në krahasim me vitin 2015 (6.7 %). Depozitat nga shoqëritë jofinanciare kontribuan gati dyfish në rritjen e depozitave në krahasim me familjet. Megjithatë, depozitat e familjeve e ruajtën rolin e burimit më të lartë individual të financimit të aktiviteteve të sistemit bankar (me pjesëmarrje prej 49.7% në gjithsej pasivin). Procesi kontinual i decentralizimit të depozitave të bankave, karakteristike për disa vite të kaluara, u ndërpre në vitin 2016, që është si pasojë më e theksuar e prirjes së familjeve në këtë vit për të deponuar valuta si depozita, ku në të njëjtën kohë kishte rritje të ngadalësuar të plasmanëve në denarë te ky sektor. Kontribuues më i madh në rritjen vjetore të depozitave kishin depozitat në të parë (përfshirë dhe llogaritë transkacionale te bankat), me një rënie të njëkohshme të totalit të depozitave me afat, për të cilat përsëri, familjet kanë kontributin më të madh. Zhvillimet e këtilla tregojnë për një besim të shkatërruar të familjeve ndaj bankave vendore, ku për rikthimin e plot të tij sipas të gjitha gjasave do të duhej qetësimi i proceseve politike në vend. Gjithashtu, edhe pse transformimi valutor dhe afatizues i depozitave kontribuan për shpenzime më të ulëta interesin bilancin e bankave, por prapë se prapë e vështirësuan menaxhimin me riskun e likuiditetit dhe imponuan nevojën për kujdesshmëri më të lartë, në fakt ruajtja e në volumi më të lartë të mjeteve likuide, të cilat janë me më pak rendiment.

Tërheqja e depozitave nga sistemi bankar në tremujorin e dytë të vitit 2016 paraqiste stres test i vërtet të mjaftueshmërisë së vëllimit të mjeteve likuide të bankave, të cilat u zvogëluan për më shumë se 10% për vetëm një tremujor. Megjithatë, për një sasi më të madhe të mjeteve likuidet akumuluar paraprakisht, si edhe instrumentet e Bankës popullore për krijimin e likuiditetit, në mënyrë të suksesshme u menaxhua kjo seri krize në sistemin bankar vendor dhe madje mundësoi arritjen e normave pozitive të rritjes së kredisë si burim kryesor i të ardhurave për sistemin bankar. Gjer në fund të vitit 2016 aktivitetet e depozitave në mënyrë graduale rikuperoheshin, kombinuar me mundësinë e dhënë për vendosjen e depozitave në valutë të huaj të bankave të Banka popullore me norma interesi më të larta, krahasuar me normat e marra nga bankat e huaja, ndikuan në rritjen e prirjes së bankave për të investuar në instrumente financiare likuide. Kështu, në vitin 2016, aktivet likuide të sistemit bankar u rritën me 3.5%, pavarësisht rënies së vogël në vitin 2015, të cilat kontribuan në mbajtjen e treguesve të likuiditetit në nivele të ngjashme me ato të fundit të vitit 2015, ndërkohë që treguesit për likuiditet valutor të sistemit bankar vuri në dukje edhe disa përmirësime të theksuara. Jostabiliteti në ambientin familjar dhe turbulencat në tregun valutor kishin efekte transferuese graduale edhe ndaj aktiviteteve kredituese të bankave. Kreditë e bankave e mbaruan vitin me rritje prej vetëm 1.2%, që është një performancë dukshëm më e ulët krahasuar me vitin paraprak (9.7%). Megjithatë, lëvizjet e kredive në masë të madhe u kushtëzuan kryesisht nga ndryshimet në rregulloret ekzistuese të Bankës Popullore, sipas të cilave, deri më 30 qershor 2016, bankat kishin detyrimin për të "pastruar" portofolin e kredive e të gjitha kërkesave që ishin rezervuar plotësisht më tepër se dy vite. Efektet më të fuqishme të këtyre ndryshimeve në rregullore u ndjenë në tremujorin e dytë të vitit, kur u "shlyen" vlerat e konsiderueshme e rezervimeve të plota të kredive jofunksionale, ndërse gjer kah fundi i vitit shënoi shterimin e efekteve të ndryshimeve rregullatore. Nëse efektet e këtyre ndryshimeve rregullativë do të ishin izoluar, norma vjetore e rritjes së aktivitetit kreditues të bankave në fund të vitit 2016 do shënon normë më të lartë (6%), por përsëri është dukshëm më e ulët krahasuar me atë të realizuar në vitin paraprak (9.7%). Vëmendja e bankave mbeti e fokusuar në kreditimin e familjeve për blerjen dhe rinovimin e hapësirës për banim ose për financimin e konsumit të këtij sektori. Në të kundërt, mbështetja e kredisë për sektorin korporativ u ul në vitin 2016 dhe nëse efektet e masës për "shlyerjen" e detyrueshme të kredive jofunksionale për këtë sektor janë të përjashtuara, atëherë kreditë e shoqërive jofinanciare tregojnë një normë vjetore pozitive, por modeste dhe gati tre herë më të ulët se norma e rritjes krahasuar me vitin paraprak. Spastrimi i detyrueshëm i portofolit kreditues nga kreditë e vjetra dhe tërësisht të zhvlerësuara i përmirësuan treguesit për kualitet të portofolit kreditues të bankave, por gjithashtu duhet të inkurajojë një fokus më të madh në menaxhimin e kredive me më pak rezervime dhe kredi jofunksionale, të cilat mund të krijojnë humbje në të ardhmen. Kështu, më 31 dhjetor 2011 ra pjesëmarrja e kredive jofunksionale në totalin e kredive në nivelin 6.6%, që është dukshëm më e ulët krahasuar me fundin e vitit të kaluar (10.8%). Nëse efektet e kësaj mase përjashtohen, atëherë cilësia e përgjithshme e portofolit të huave të subjekteve jofinanciare mbetet e pandryshuar. Por, analizuar sipas sektorëve, ka një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredive të korporatave me zvogëlim të aktivitetit kreditues të bankave ndaj këtyre klientëve, ndërkohë që cilësia e kredisë për familjet është përmirësuar.

Rreziku për fondet e veta të bankave nga realizimi eventual i rrezikut të kredisë nga kreditë jofunksionale nuk është i lartë për shkak të mbulimit të lartë të tyre me zhvlerësimin e alokuar (80.9%), por edhe për shkak të vëllimit dhe kualitetit të kënaqshëm të fondeve vetanake të bankave.



Përmirësim të cilësisë shënon edhe portofoli i rregullt të kredisë të sistemit bankar, me çka nivelit mesatar i rrezikut të kredive të rregullta shënoi rënie (2.8%). Rëndësi të jashtëzakonshme për dinamikën e ardhshme të cilësisë së portofolit kreditor ka dimensionin kualitativ i procesit të ristrukturimit të kërkesave, më saktësisht sa bankat do të tregojnë sukses në vlerësimin e aftësisë kredituese të klientëve të tyre dhe në një përshtatshmëri adekuate të kushteve kontraktuese të kredive, veçanërisht në kushte rrjedhëse në ambienti të brendshëm politik të paqëndrueshëm.

Në vitin 2016, bankat treguan fitim afarist për një të tretat më shumë krahasuar me vitin paraprak, çka u mundësoi vazhdimi i trendit të rritjes së margjinës së profitit, si edhe normës së kthimit të kapitalit (13.6%) dhe mjeteve (1.5%). Përmirësimi i profitabilitetit të bankave më së shumti rrjedh nga zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve të interesit, gjatë një rritje modeste e të hyrave nga interesi, që është veçanërisht e dukshme në ndërmjetësimin financiar me sektorin "familje". Zvogëlimi i zhvlerësimit të vlerës, veçanërisht për mjetet jofinanciare, paraqet nxitësin e dytë më të rëndësishëm të normës së lartë të rentabilitetit të sistemit bankar. Gjithashtu, vërehet një përmirësim i vazhdueshëm i efikasitetit operacional të bankave.

Treguesit e solventitetit dhe të kapitalizimit të sistemit bankar shënoi një ulje të theksuar, e cila më së shumti rrjedh si pasojë e rritjes së përshpejtuar e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve. Përveç rritjes së aktiviteteve kredituese të bankave, rritja e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqet rrjedh edhe nga masat rregullatore të ndërmarra, me aplikim nga 01.01.2016, me qëllim të ndalimit të rritjes së tepruar të ekspozimit në bazë të produkteve të veçanta kreditore të dedikuara për financimi të familjeve (kartelat kreditore, lejimi i tejkalimeve, si edhe kreditë konsumatore me afatizim të barabartë ose më të gjatë se një vit). Megjithatë, norma e përshtatshmërisë së kapitalit në fund të vitit 2016 është i lartë dhe shënon 15.2% (15.5% më 31.12.2015) dhe mundëson hapësirë të mjaftueshme për absorbimin e humbjeve eventuale të bankave. Në drejtim të mbulimit të ekspozimit të bankave ndaj rreziqeve nga puna, fakt i volitshëm është pjesëmarrja vendore (më kualitativ) në kapitalin themelor (90.9%) në strukturën e mjeteve të veta të bankave, si edhe fakti që gjysma e mjeteve të veta janë "të lira", mbi minimumin ligjor të lejuar të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve. Ndryshimet e reja të Ligjit mbi bankar, i sjell në tetor të vitit 2016, i cili filloi të zbatohet nga marsi i vitit 2017, shënojnë modernizim të rëndësishëm të kornizës rregullativë nëpërmjet inkorporimit të rregullave të reja të Komitetit të Bazelit dhe rregullativave Evropiane për të ashtuquajtura shtresa mbrojtëse të kapitalit, përmbushja e së cilave do të përmirësoj aftësinë paguese të bankave.

Gjatë fundit të vitit 2016 si dhe fillimit të vitit 2017, në kushte të një teprice të rritur të likuiditetit dhe situatave qetësuese të tregut depozitues dhe atij valutor, Banka popullore ju qas një normalizimi të politikës monetare si një rezultat i stabilizimit gradual të pritjeve të subjekteve ekonomike dhe të rikuperimit të vlerësimeve të stabilitetit të fundamentit të ekonomisë vendore. Me atë që Banka popullore e rriti ofertën e bonove të thesarit duke zvogëluar normën e tyre të interesit gjatë tre rasteve, me çka baza e normës së interesit u kthye në nivelin e fillimit të vitit 2016 (3.25%). Gjithashtu nga tetori i vitit 2016, Banka popullore ndërpreu realizimin e ankandeve publike për depozitat valutore, të cilët u riaktivizuan në maj të vitit 2016 përballë zhvillimeve të turbullta në tregun valutor dhe në tregun e depozitave. Megjithatë, rreziqet e brendshme që lidhen me pasigurinë në mjedisin politik ditor janë akoma aktuale dhe paraqesin një faktor të rëndësishëm rreziku për ecurinë e ardhshme të sektorit bankar.

## **I. Struktura e sistemit bankar**






## 1. Karakteristikat themelore e modeleve afariste të bankave

Grafik.1

Struktura e aktivitet (lartë) dhe pasivi (poshtë) e bankave, më 31.12.2016

Në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.  
Rradhitja e bankave është i rastësishëm.


**Bankat në Republikën e Maqedonisë në punën e tyre zbatojnë modelin afarist tradicional-grumbullimin e depozitave nga sektori vendor privat dhe plasimi në kreditë ndaj shoqërive tregtare dhe familjeve.** Gjatë vitit 2016 vazhdoi rritja e depozitave të familjeve si një burim më i theksuar i financimit të aktiviteteve bankare, por me një rritëm të ngadalësuar, me ç'rast pjesëmarrja e tyre në gjithsej pasivin e sistemit bankar u zvogëlua për 1.1 pikë përqindje dhe arriti në 49.7%. Në të kundërt pjesëmarrja në përqindje e depozitave në gjithsej pasivin e shoqërive jofinanciare u rrit për 1.4 p.p., e që përbën rreth 20% të gjithsej burimeve të mjeteve. Analizuar në veçanti bankat, te njëmbëdhjetë prej tyre depozitat e familjeve kanë pjesëmarrje më të lartë në gjithsej burimet e mjeteve, te një bankë depozitat e shoqërive jofinanciare kanë pjesëmarrje më të theksuar në pasivin, te dy banka pjesëmarrja e depozitave familjare me ato të shoqërive financiare kanë gati pjesëmarrje identike. BMPZh SHA Shkup, duke u bazuar në natyrën specifike financohet me linja kreditore nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat i plasojnë gjer te shfrytëzuesit përfundimtar nëpërmjet bankave tjera vendore. Pjesëmarrja e burimeve tjera të financimit<sup>1</sup> nuk shënojnë një rritje të rëndësishme vjetore dhe më 31.12.2016 shënoi rreth 14%. Kreditë e shoqërive jofinanciare<sup>2</sup> akoma kanë më shumë pjesëmarrje në aktivin e sistemit bankar (prej 30%), edhe pse në vitet e fundit është i pranishëm trendi i sforcimit të kreditimit të familjeve pjesëmarrja e së cilëve është rritur për 3.6 p.p.

<sup>1</sup> Depozitist nga institucionet financiare, detyrime në bazë të kredive, instrumente kapitale subordinuese dhe hibride.

<sup>2</sup> Kreditë e shoqërive jofinanciare dhe familjeve janë analizuar në bazë neto (duke pasur parasysh korigjimin vlerës dhe amortizimit të akumuluar të kredive), por konkluzionet nuk do ishin ndëruar edhe nëse analiza e kredive do realizohej në bazë bruto.

Analizuar bankat në veçanti konstatojmë se gjashtë banka janë më të orientuara drejt huadhënies ndaj shoqërive jofinanciare, pesë banka janë kryesisht kreditues të familjeve, tre banka në mënyrë të barabartë financojnë të dy sektorët dhe një bankë i plasom kreditë tek bankat vendore. Në vitin 2016, u shënua një rritje më e theksuar prej 3.4 p.p. të pjesëmarrjes së përgjithshme të parave në të gatshme, llogarive dhe depozitave te BPRM dhe te bankat tjera, si një nga mjetet më likuide të sistemit bankar. Plasmanëve të letrave me vlerë (para së gjithash bonove të thesarit dhe bonove shtetërore<sup>3</sup>) shënojnë rënie prej 13% nga aktivi që është një zvogëlim prej rreth 1 p.p. në krahasim me fundin e vitit 2015. Pjesa më e madhe ose rreth 84% e plasmanëve të bankave në letra me vlerë klasifikohen si instrumente të disponueshme për tu shitur, dhe vetëm 0,8% si instrumente për tu tregtuar.

Grafik.2  
Struktura e të hyrave të përgjithshme të bankave në vitin 2016  
Në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave. Radhitja e bankave është i rastësishëm.

**Depozitat dhe kreditë me klauzolë valutore përfshijnë rreth 43% dhe 45% nga gjithsej depozitat dhe kreditë te subjektet jofinanciare,** përkatësisht, që paraqet rritje vjetore prej rreth 1 p.p. të depozitave<sup>4</sup> dhe zvogëlim vjetor prej 2 p.p. te kreditë. Aktivitetet me jorezidentët në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë shënojnë rënie të lehtë për gjatë vitit 2016. Pak më shpejt në anën e pasivit, se sa në atë të aktivit, me një pjesëmarrje prej 8.3% dhe 8.1%, përkatësisht.

**Modeli tradicional i afarizmit në punën e bankave shikohet edhe nga struktura e të hyrave të përgjithshme të bankave.** Rreth dy të tretat nga gjithsej të hyrat e sistemit bankar në mënyrë kontinuale bien në neto të hyra nga interesi, të cilat bankat gati në mënyrë të shkëlqyer i dimensionojnë sipas shënjestimeve të vendosura për profit (edhe në

<sup>3</sup> Janë inkorporuar letrat me vlerë vendore dhe ato të huaja.

<sup>4</sup> Ambienti vendor jostabël, dhe pritjet e keqësuar të njëpasnjëshme të subjekteve ekonomike shkaktuan tërheqje të depozitave nga sistemi bankar, në prill dhe pjesërisht në maj të vitit 2016, që njëkohësisht ishin të përcjellur me transformime valutore të depozitave denarike. Zhvillimet e këtilla kontribuan të ndërpritet trendi rënës të Eroizimit, i pranishëm disa vite më parë.




ambiente me norma të ulëta interesi), nëpërmjet aplikimit aktiv të mundësisë kontraktuese të përshtatshme të normave të interesit te produktet kredituese por më shumë tekat depozituese.

**Ecuria e pranishme e riorientimit të punës bankare kah puna me familjet vërtetohet edhe me analizën e strukturës sektoriale të neto të hyrave nga interesi a në suaza të tyre parasëgjithash i të hyrave nga interesi.** Pjesëmarrja individuale e të hyrave nga interesi nga puna me shoqëritë jofinanciare është zvogëluar për 3.6 p.p. në krahasim me vitin 2015, në llogari të rritjes së pjesëmarrjes së neto të hyrave nga interesi prej aktiviteteve me familjet për 4 p.p.. në drejtim të njëjtë janë edhe ndryshimet edhe të hyrave nga interesi, ku në vitin 2016, pjesëmarrja e të hyrave nga interesi nga familjet në gjithsej të hyrat nga interesi u rritën për 2.5 p.p. ndërsa pjesëmarrja e të hyrave nga interesi i shoqërive jofinanciare u zvogëluar për 2.1 p.p.

**Pjesëmarrje individuale më të lartë në strukturën e shpenzimeve, në nivel të sistemit bankar kanë shpenzimet për të punësuarit dhe korrigjimi i vlerës së mjeteve financiare dhe jofinanciare.** Më datë 31.12.2016, shpenzimet për të punësuarit kishin pjesëmarrje individuale më të lartë në shpenzimet e përgjithshme të sistemit bankar, e cila është rritur për 1.1 p.p. për gjatë vitit 2016. Kundrejt tyre pjesëmarrja e korrigjimit të vlerës në shpenzimet e përgjithshme vazhdoi të shënon rënie edhe për gjatë vitit 2016 gati me rreth 3 p.p.

Grafik.3  
Struktura e shpenzimeve të përgjithshme e bankave në vitin 2016  
Në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.  
Radhitja e bankave është i rastësishëm.

Analizuar bankat në veçanti, ekzistojnë dallime të theksuara në strukturën e shpenzimeve. Veçanërisht i dukshëm është dallimi i pjesëmarrjes së korrigjimit të vlerës në shpenzimet e përgjithshme te bankat në mënyrë individuale, që sipas gjitha gjasave tregon natyrën specifike (individuale, të veçantë për çdo bankë) për eksponueshmërinë rrjedhëse të


bankave ndaj rrezikut kreditues dhe nivelit të rrezikut, si edhe të aktiviteteve të bankave të veçanta për pagesën e kërkesave të "Këqija".

## 2. Numri i bankave dhe qasja gjer te shërbimet bankare

Më datë 31.12.2016 në Republikën e Maqedonisë funksionojnë tetëmbëdhjetë institucione depozitar, përkatësisht pesëmbëdhjetë banka dhe tre kursimore<sup>5</sup>. Në raport me vitin paraprak, struktura e sistemit bankar ngeli e pandryshuar. Në aspekt të pjesëmarrjes së parëndësishme të kursimoreve në sistemin e përgjithshëm bankar, ata nuk janë objekt i analizës në këtë raport<sup>6</sup>.

Grafik.4

Rrjeti bankar \* (majtas) dhe numri i banorëve për njësi afariste (djathtas), sipas regjioneve në Republikën e Maqedonisë



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave. Enti shtetëror i statistikave të R.Maqedonisë, sipas të dhënave oficiale të regjistrimit të vitit 2002.

\*Në përlogaritje nuk janë inkorporuar sportelet e bankave.

<sup>5</sup> Pjesëmarrja e kursimoreve shënon vetëm 0.6% nga mjetet e përgjithshmeohtë depozitave të institucioneve financiare (bankat dhe kursimoret), 0.7% nga gjithsej kreditë kah subjektet jofinanciare dhe 0.4% nga gjithsej depozitat e familjeve.

<sup>6</sup> Profili i rrezikshmërisë dhe vëllimi i aktiviteteve të kursimoreve analizohet në raportin e stabilitetit financiar të Republikës së Maqedonisë.



Tabela. 1  
Treguesit e krahasueshëm të numrit të banorëve për bankë dhe për njësi afariste të bankave

Vendi	Numri i qytetarëve për bankë	Vendi	Numri i qytetarëve për njësi afariste bankare
Luksemburgu	3,856	Spanja	1,494
Austria	11,605	Qiproja	1,504
Qiproja	13,235	Franca	1,770
Malta	14,805	Portugalia	1,853
Lituania	33,196	Bullgaria	1,951
Mali i Zo	44,436	Italia	1,995
Gjermania	47,735	Austria	2,095
Danimarka	50,988	Gjermania	2,385
Polonia	60,712	Luksemburgu	2,524
Suedia	61,304	Polinia	2,656
Portugalia	69,165	Belgjika	3,200
Hungaria	74,663	Hungaria	3,403
Letonia	76,388	Slovenia	3,502
Estonia	82,179	Kroacia	3,596
Slovenia	89,690	Mallta	3,939
Italia	101,495	Rumania	4,017
Belgjika	117,055	Serbia	4,144
Franca	117,678	Slovakia	4,199
Kroacia	128,040	Greqja	4,270
Maqedonia	137,945	Maqedonia	4,846
Holanda	170,714	Rep.Çeke	5,081
Spanja	177,968	Danimarka	5,085
Shqipëria	180,769	Lituania	5,235
Rep.Çeke	184,882	Suedia	5,482
Slovakia	200,791	Shqipëria	5,785
Bosna dhe Hercegovina	224,142	Letonia	7,196
Serbia	237,146	Holanda	9,581
Greqja	241,289	Estonia	12,289
Bullgaria	257,221	Mali i Zi	n.e.
Rumania	551,962	Bosna dhe Hercegovina	n.e.

Burimi: BPRM, EU Structural Financial Indicators 2015, BSCEE Review 2015, www.dbresearch.com ueb faqa e UE dhe BB, Banka Popullore e Shqipërisë (Supervision Annual Report 2015), Banka popullore e Serbisë (Sektori bankar në Serbi, Raport për tremujorin e III të vitit 2016).

Vërejtje: Të dhënat për Maqedoninë, janë për 31.12.2016, për Serbinë për 30.9.2016, ndërsa për vendet tjera për 31.12.2015.


**Rrjetin bankar e** konstituojnë 433 njësi afariste<sup>7</sup> të shpërndara gati në të gjitha qytetet në territorin e Republikës së Maqedonisë. Numri i njësive afariste u rrit për gjashtë, ndërsa pjesa më e madhe njësive të reja të hapura shtrihen në Regjionin jugperëndimor. Rrjeti bankar edhe matej në numër më të lartë është në regjionin e Shkupit, ku **qasja e shërbimeve bankare** matur sipas numrit të banorëve për njësi afariste është ma i miri. Sipas regjioneve, qasja gjer te shërbimet bankare mbahet në nivel të pandryshuar, përveç në regjionet Jugperëndimor dhe atë Lindor ku shënohet një përmirësim i vogël.

**Bankat në Republikën e Maqedonisë akoma kanë rrjet bankar më të pazhvilluar në krahasim me numrin më të madh të vendeve të përfshira në këtë analizë.** Sipas numrit të qytetarëve që shërbehen nga një bankë, përkatësisht nga një njësi afariste, Maqedonia gjendet në gjysmën e dytë të tabelës së vendeve të analizuara, që gati është e pandryshuar në raport me vitin paraprak.

<sup>7</sup> Në numrin e njësive afariste është inkorporuar edhe selia e bankave, por nuk inkorporohen edhe sportelet e bankave.

Grafik.5

Numri i të punësuarve në sistemin bankar



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

### 3. Punësimi në sistemin bankar


**Në vitin 2016, qe ndërprerë ecuria e zvogëlimit të numrit të të punësuarve në sistemin bankar krahasuar me dy vitet paraprake.** Numri i të punësuarve në sistemin bankar shënonte 5,985 dhe për gjatë vitit 2016 u rrit për 17<sup>8</sup> ose për 0.3%. struktura e të punësuarve sipas kualitetit në sektorin bankar vazhdoi të përmirësohet, pasqyruar nëpërmjet në rritje vjetore të pjesëmarrjes së numrit me të paktën arsimim të lartë në gjithsej numrin të punësuarve, prej 2 p.p. (më 31.12.2016, kjo pjesëmarrje shënon 76.7%)

**Produktiviteti i sistemit bankar i matur nëpërmjet vëllimit të aktivitetit për të punësuar, vazhdoi të përmirësohet.** Në vitin 2016 aktiviteti rritej me një rritëm të ngadalshëm me një normë e cila disa herë është më e lartë krahasuar me normën e ndryshimit të numrit të personave të punësuar. Analizuar në veçanti sipas bankave, produktiviteti ka shënuar përmirësim te trembëdhjetë banka, që më së shpeshti është si rezultat i rritjes së shpejtë të aktivitetit në raport me numrin e të punësuarve (përfshirë paraqet një bankë, tek e cila vlera e rritur e aktivitetit në raport me të punësuarit rrjedh si pasojë e zvogëlimit më të shpejtë e të punësuarve në krahasim me zvogëlimin e vlerës së aktivitetit). Edhe krahas rritjes së produktivitetit në nivel të sistemit bankar, dallimi i produktivitetit të bankave në veçanti është përmirësuar. Ashtu që shtrirja në mes bankave me produktivitet më të lartë si dhe shtrirja në mes tremujorit të parë dhe të tretë të treguesve për aktivitetin për punonjës edhe matej shënon zgjerim në vitin 2016.

Grafik.6

Aktiviteti për të punësuar\*

Në një mijë denarë



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

\*BMPZh nuk është përfshira në analizë për shkak të llojit të aktivitetit që kryen.

<sup>8</sup> Në rritje më të konsiderueshme të numrit të punonjësve ka në dy bankat e mëdha (për 30 dhe 20 persona ndaras) dhe në një bankaë të mesme (për 21 persona), ndërsa zvogëlim më të lartë ka te një bankë e vogël (për 64 persona). Neto ritja tjetër e numrit të punonjësve rezulton nga tetë bankat tjera.



#### 4. Struktura sipas pronësisë dhe përqëndrimi i sistemit bankar

Në vitin 2016, numri i bankave të cila janë në pronësi të aksionarëve të huaj ngeli i pandryshuar (njëmbëdhjetë), por numri i filialeve të bankave të huaja (aktualisht, gjashtë) u zvogëluan për një<sup>9</sup> në raport me fundin e vitit 2015.

Tabela. 2

Strukture e Struktura e numrit të bankave dhe zërave më të rëndësishëm të bilancit, sipas pronësisë dominues të bankave (më 31.12.2016)

Në milionë denarë dhe në përqindje


Lloji i pronësisë	Numri i bankave	Kapitali dhe Rezervat		Aktivi		Kreditë ndaj sektorit jofinanciar		Depozitat nga sektori jofinanciar		Gjithsej të hyra*		Rezultati financiar*	
		Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %	Vlera	në %
<b>Bankat me pronësi dominante të aksionarëve të huaj</b>	<b>11</b>	<b>32.756</b>	<b>69,4%</b>	<b>310.956</b>	<b>69,9%</b>	<b>217.700</b>	<b>77,5%</b>	<b>225.023</b>	<b>69,7%</b>	<b>16.829</b>	<b>73,6%</b>	<b>5.329</b>	<b>84,3%</b>
- Filialet e bankave të huaja	6	28.289	59,9%	257.002	57,8%	179.563	63,9%	187.235	58,0%	13.994	61,2%	4.940	78,1%
- Austria	1	2.256	4,8%	18.904	4,3%	12.032	4,3%	12.301	3,8%	1.199	5,2%	213	3,4%
- Bullgaria	1	1.205	2,6%	8.414	1,9%	5.240	1,9%	6.077	1,9%	367	1,6%	1	0,0%
- Greqia	1	11.436	24,2%	86.153	19,4%	61.742	22,0%	66.265	20,5%	5.144	22,5%	2.240	35,4%
- Sllovenia	1	6.668	14,1%	71.834	16,2%	51.056	18,2%	56.916	17,6%	4.037	17,6%	1.579	25,0%
- Turqia	1	4.140	8,8%	35.815	8,1%	23.976	8,5%	20.283	6,3%	1.675	7,3%	471	7,5%
- Franca	1	2.585	5,5%	35.882	8,1%	25.518	9,1%	25.394	7,9%	1.571	6,9%	435	6,9%
- Banka të tjera me pronësi dominante të huaj	5	4.467	9,5%	53.954	12,1%	38.137	13,6%	37.788	11,7%	2.835	12,4%	389	6,1%
- Bullgaria	2	1.759	3,7%	17.428	3,9%	11.515	4,1%	12.944	4,0%	899	3,9%	140	2,2%
- Gjermania	1	1.773	3,8%	21.403	4,8%	16.468	5,9%	13.759	4,3%	1.093	4,8%	272	4,3%
- Zvicra	2	936	2,0%	15.123	3,4%	10.154	3,6%	11.085	3,4%	844	3,7%	-23	-0,4%
<b>Bankat me pronësi dominante të aksionarëve vendor</b>	<b>4</b>	<b>14.434</b>	<b>30,6%</b>	<b>133.725</b>	<b>30,1%</b>	<b>63.262</b>	<b>22,5%</b>	<b>97.774</b>	<b>30,3%</b>	<b>6.049</b>	<b>26,4%</b>	<b>996</b>	<b>15,7%</b>
- Pronësi private	3	12.072	25,6%	118.863	26,7%	63.224	22,5%	97.774	30,3%	5.871	25,7%	893	14,1%
- Pronësi shtetërore	1	2.362	5,0%	14.862	3,3%	38	0,0%	0	0,0%	178	0,8%	103	1,6%
<b>Gjithsej:</b>	<b>15</b>	<b>47.191</b>	<b>100,0%</b>	<b>444.680</b>	<b>100,0%</b>	<b>280.962</b>	<b>100,0%</b>	<b>322.797</b>	<b>100,0%</b>	<b>22.878</b>	<b>100,0%</b>	<b>6.325</b>	<b>100,0%</b>

Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

\*Të hyrat e përgjithshme dhe rezultati financiar të bëj me vitin 2016.

Grafik.7

Struktura pronësore e kapitalit dhe rezervave të sistemit bankar Në përqindje




Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Bankat me pronësi dominante të aksionarëve të huaj mbizotërojnë në sistemin bankar në republikën e Maqedonisë, të cilët në atë mënyrë janë nën ndikim të faktorëve me rrezik ekonomik dhe joekonomik të ndërlidhur me personat vendor të bankave dhe vendeve nga e kanë prejardhjen. Me përjashtim të ndryshimit të pronarit të një bankë, në vitin 2016 nuk janë vërejtur ndryshime të theksuara në strukturën pronësore të bankave. Bankat me pronësi dominante të aksionarëve të huaj mbizotërojnë te të gjitha pozicionet e bilanceve të bankave.**

Dominimi i tyre veçanërisht është i theksuar te aktiviteti kreditues dhe rezultati financiar. Në mes aksionarëve të huaj, sipas vendit të prejardhjes, pjesëmarrja më e madhe në gjithsej kapitalin e sistemit bankar është e aksionarëve nga Greqia dhe Sllovenia (përfshirë

<sup>9</sup> Ka të bëj me shitjen e "Alfa Bankës" SHA Shkup (realizuar, më 9.5.2016, nëpërmjet bllok translacionet në Berzën e letrave me vlerë të RM, me çka "Silk rod kapital" AG Zvicër (Silk Road Capital AG, Switzerland) u bë pronar i plotë i „Алфа банка” SHA Shkup (më vonë i riemëruar në "Silk rod kapital" SHA Shkup).

**Grafik.8**  
**Indeksi i Herfindalit\***  
Në poena indeksi



Burimi: BPRM, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

\* Indeksi i Herfindahlit llogaritet sipas formulës

$$HI = \sum_{j=1}^n (S_j)^2$$

ku S është pjesëmarrja e secilës bankë në

shumën e përgjithshme e kategorisë e cila analizohet (për shembull: aktivë e përgjithshme, gjithsej depozita etj.), ndërsa n është numri i përgjithshëm i bankave në sistemin. Kur indeksi lëvizë në interval prej 1,000 njësi deri në 1,800 njësi, niveli i koncentrimin të sistemit bankar llogaritet e pranueshme.

**Tabela. 3**

Treguesit për përqendrimin e pozicioneve më të rëndësishme të bilanceve në tre dhe pesë bankat më të mëdha

Në përqindje

Në përqindje	2015		2016	
	CR3	CR5	CR3	CR5
Gjithsej aktive	59,4	74,3	58,2	74,3
Kreditë ndaj familjeve	64,2	79,8	62,9	79,2
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	59,7	76,7	55,5	74,9
Depozitat e familjeve	71,3	80,2	70,5	79,9
Depozitat e ndërmarrjeve	54,2	77,3	53,9	76,9
Rezultati financiar*	70,6	87,2	72,7	87,0
Gjithsej të hyra*	61,4	74,7	61,3	75,5

Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

\*Të hyrat e përgjithshme dhe rezultati financiar ka të bëjë me vitin 2016.

edhe rezervat), e cila shënon 22.4% dhe 13.8% përkatësisht. Në vitin 2016, zvogëlohet pjesëmarrja e aksionarëve nga Greqia<sup>10</sup> (për 2.9 p.p.) në gjithsej kapitalin (përfshirë edhe rezervat) e sistemit bankar, ndërsa pjesëmarrja e aksionarëve me prejardhje nga Zvicra<sup>11</sup> shënuan rritje. Sipas llojeve të aksionarëve në kapital (përfshirë edhe rezervat) pjesëmarrje më të lartë kanë institucionet jofinanciare, edhe pse në vitin 2016 pjesëmarrja e tyre shënoi rënie nga 2.6 p.p., në llogari të rritjes së pjesëmarrjes së personave juridik jofinanciare (më së shumti si pasojë e ndryshimeve paraprake të përmendura të pronarit të një banke).

**Në sistemin bankar veçohen disa banka sipas madhësisë realizimet e së cilave kanë rol udhëheqës në gjithë sistemin bankar dhe ekonominë vendore. Përqendrimi i sistemit bankar zvogëlohet ngadalë, por në mënyrë të vazhdueshme.**

Për herë të parë gjer më tani, në fund të vitit 2016 të gjitha vlerat e indeksit Herfindal janë në suazat e intervalit e vlerave të pranueshme. Më datë 31.12.2016 treguesit CR5 dhe CR3<sup>12</sup> tregojnë zvogëlim vjetor jo të rëndësishëm të të gjitha segmentet e punëve bankare, përveç pjesëmarrjes së tre bankave më të mëdha në kreditimin e shoqërive tregtare, e cila u zvogëlua për 4.2 p.p.. Nuk ka ndryshim në pjesëmarrjen e pesë bankave më të mëdha në sistemin e gjithsej aktivitet (74.3%), por vërehet zvogëlim të pjesëmarrjes së tre bankave më të mëdha prej 1.2 p.p..

Dallimi në mes bankave me pjesëmarrje më të lartë (22.6%) dhe bankave me pjesëmarrje më të vogël në aktivin (0.7%) në sistemin është edhe më tej e lartë, ndërsa nëntë bankat (me gjithsej pjesëmarrje prej 20%) që kanë pjesëmarrje individuale më të vogël se 5%.

<sup>10</sup> Për shkak të shitjes së "Alfa Bank" SHA Shkup, e cila ishte në pronësi të plotë greke, "Silk Road Capital" AG Zvicër.

<sup>11</sup> Për shkak të shitjes së "Alfa Bank" SHA Shkup, e cila ishte në pronësi të plotë greke, "Silk Road Capital" AG Zvicër..

<sup>12</sup> Treguesi CR5, apo CR3, tregon pjesën e kategorisë së veçantë të analizuar (për shembull, aktivitet) e pesë, apo tre bankat me vlerën më të lartë të asaj kategorie në totalin e vlerës së asaj kategorie të analizuar (për shembull, në totalin e aktiveve) në sistemin bankar.






### Analiza krahasimore në mes tre bankave nga vendet e regjionit, sipas lartësisë së treguesve të zgjedhur për veprimtarinë e tyre dhe ekspozimin ndaj rreziqeve

Qëllimi i kësaj analize është ti krahasojmë tre bankat më të mëdha të vendeve të regjionit (Maqedonia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia), sipas lartësisë së treguesve të caktuar për operacionet e tyre dhe ekspozimin ndaj rreziqeve individuale. Për këtë qëllim është shfrytëzuar baza e të dhënave të "Orbis bank fokus" (Orbis Bank Focus)<sup>13</sup>, ndërsa të dhënat e prezantuara janë sipas gjendjes së 31.12.2015. Në vendet e analizuar, përqendrimi i sistemit bankar, sipas aktivitet të tre bankave më të mëdha është relativisht e lartë (lëvizën në intervalin prej 42% gjer 60%) dhe që aty, gjendjet dhe zhvillimet e nivelit të agreguar (në nivel të sistemit bankar të çdo vendi të analizuar) në masë të madhe janë kushtëzuar nga (ose i reflektojnë) situatat dhe zhvillimet te tre bankat më të mëdha. Njëkohësisht, gjatë shfrytëzimit të mikro të dhënave (në nivel të bankave individuale) më së miri mëren parasysh specifikat e institucioneve të veçanta në sistemet bankare, ashtu që mundësojnë nxjerrjen e konkluzioneve më precize pa humbje të panevojshmet informatave (që realisht ekzistojnë gjatë shfrytëzimit të të dhënave mesatare apo të agreguara në nivel të sistemit), në lidhje me situatat në sistemet bankare të veçanta.

Grafik.9

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (majtas) dhe norma e kapitalizmit \* (djathtas) e tre bankave më të mëdha të vendit dhe të regjionit

Në përqindje



Burimi: "Orbis bank fokus".


\*Norma e kapitalizmit paraqet raportin në mes të kapitalit dhe rezervave me gjithsej aktivin.

<sup>13</sup> Në këtë bazë të dhënash mungojnë të dhënat për disa tregues për bankat e caktuara.

Grafik.10

Norma e kthimit e aktiveve mesatare (majtas) dhe norma e kthimit të kapitalit mesatar dhe rezervave (djathtas), e tre bankave më të mëdha vendore dhe të regjionit

Në përqindje



Burimi: "Orbis bank fokus".


Gjatë krahasimeve, përkatësisht rangimit të bankave të regjionit, sipas nivelit të treguesve të analizuar, çdonjëra nga tre bankat e Maqedonisë janë në pozicione të ndryshme (në pjesën e sipërme, të mesme dhe të poshtme të listës). Prandaj, nuk mund të nxirret përfundimi i përgjithshëm se sipas lartësisë së një treguesi të veçantë, tre bankat nga Maqedonia (si grup), krahasimisht janë më të mira, apo krahasimisht më të dobëta krahasuar me bankat e regjionit. Megjithatë, mund të vërehet se, sipas nivelit të disa prej treguesve, njëra prej bankave të Maqedonisë shfaqet midis tre bankave më të mira ose tre bankave më të dobëta, në listën e bankave të analizuar në rajon. Kështu, një bankë e Maqedonisë është e pranishme në mesin e tre bankave më të mira, sipas nivelit të treguesve të rentabilitetit (normat e kthimit të aktiveve mesatare dhe kapitalit dhe rezervave), shkalla e kapitalizimit dhe treguesi për pjesëmarrjen e aktiveve likuide në depozita dhe burimet afatshkurtra të financimit. Në të kundërt, një bankë e Maqedonisë radhitet ndër tre bankat në rajon me treguesin më të lartë të nivelit mesatar të rrezikut të kredisë (raporti midis zhvlerësimit të huave dhe vlerës së bruto kredive). Sipas nivelit të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, tre bankat e Maqedonisë janë radhitur kryesisht në gjysmën e dytë të listës së bankave të analizuar, ndërkohë që sipas raportit midis kredive dhe depozitave, dy nga bankat janë në gjysmën e dytë të listës së bankave të analizuar dhe njëra është ranguar si e katërta.



Grafik.11

Niveli mesatar i rrezikshmërisë së kredive (majtas)\* dhe raporti i neto kredive me gjithsej aktivin (djathtas), e tre bankave më të mëdha vendore dhe regionale

Në përqindje




\* Bruto kreditë kanë të bëjnë me subjektet jofinanciare.

Burimi: "Orbis bank fokus".

Grafik.12

Raporti i aktiveve likuide me depozita dhe burimet afatshkurtra të financimit (majtas) \* dhe raporti i kredive neto ndaj totalit të depozitave (djathtas) \*\*, nga tre bankat më të mëdha vendore dhe regjioni

Në përqindje



\*Aktivet likuide përfshijnë para dhe mjete para te bankat qendrore (pa rezervat e detyrueshme), instrumente financiare të cilët ruhen për tregtim dhe instrumente financiare që maten në vlera objektive nëpërmjet bilancit të suksesit, kërkesat ndërbankare (në bazë neto) dhe kërkesat në bazë të repo operacioneve dhe letra me vlerë të huazuara. Depozitat përfshijnë depozita nga subjektet financiare dhe jofinanciare, ndërsa burimet financiare afatshkurtra kanë të bëjnë me huazimet afatshkurtra dhe letra me vlerë afatshkurtra të lëshuara.

\*\*Kreditë neto dhe depozitat kanë të bëjnë për subjektet jofinanciare.

Burimi: "Orbis bank fokus".

## **II. Rreziqet në punët bankare**



## 1. Rreziku i kredisë

Në vitin 2016, kreditë me probleme shënojnë një rënie të ndjeshme, ndikuar kryesisht nga ndryshimet në rregulloren e Bankës Popullore<sup>14</sup>, sipas të cilës bankat janë të detyruara të transferojnë të gjitha kërkesat të cilat janë të rezervuara plotësisht për më shumë se dy vite në të dhënat jashtë bilancit. Ky pastrim i detyrueshëm i portofolit të kredive të bankave është nxitësi kryesor për përmirësimin e treguesve të rrezikut të kredisë. Efekti nga masa rregullator ishte më i theksuar në tremujorin e dytë të vitit, kur ajo arriti ndryshime më të dukshme në vëllimin e kredive me probleme dhe treguesve të cilësisë së tyre, ndërsa në pjesën tjetër të vitit pasoi shterimi gradual i efektit nga zbatimi i detyrueshëm i shlyerjeve. Pjesëmarrja e kredive me probleme në totalin e kredive në fund të vitit 2016 ka rënë në 6.6%<sup>15</sup>. Mbulimi i lartë i kredive me probleme me zhvlerësimin e alokuar, me vëllim dhe cilësi të kënaqshme të fondeve të veta të bankave, i kufizon efektet e mundësisë së mospagesës totale të këtyre kredive në fondet e veta të sistemit bankar. Përmirësimi i cilësisë shënon edhe portofol të rregullt të kredisë të sistemit bankar. Në portofolin e rregullt të kredive të bankave janë të pranishëm disa faktorë të rrezikut, efektet negative të të cilëve mund të shkaktojnë humbjet nga realizimi i mundshëm që rreziku i kredisë të tejkalojë pritjet (rezerva të ndara) të bankave. Kjo kryesisht ka të bëjë me nivelin e përqendrimit të portofolit të kredive të bankave, kostot e larta apo pamundësisë për shitjen e kolateralit të vendosur për kreditë (me çmim të volitshëm), ose prania e kredive ku më me vështirësi mund të zbulojë në kohë problemet financiare të klientit (kreditë me periudhë faljeje ose kredi me një pagesë të vetme të principalit). Dimensioni cilësor i procesit të ristrukturimit të kërkesave, më saktë sa do të jenë bankat të suksesshme në ri-vlerësimin e aftësive kreditore të klientëve të tyre dhe përshtatjen përkatëse të kushteve kontraktuale të kredive, paraqet një aspekt të rëndësishëm për dinamikën e ardhshme të cilësisë së portofolit të kredive të bankave, natyrisht së bashku me cilësinë e kredive të reja të miratuara.

Në vitin 2016, **ekspozimi total i kredisë** të sistemit bankar u rrit për 2.2% dhe arriti në 469,675 milionë denarë, që është një rritje jashtëzakonisht më e dobët krahasuar me vitet e mëparshme. Megjithatë, duhet të merret parasysh se niveli i ekspozimit total të kredisë në vitin 2016 ishte nën ndikimin e efektit të zbatimit të zhvlerësimeve të detyrueshme, në përputhje me ndryshimet rregullator. Kështu, duke përjashtuar efektin e zhvlerësimeve totale të zbatuara<sup>16</sup>, ekspozimi ndaj kredisë shënon rritje prej 5.5%.

<sup>14</sup> Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për administrimin e rrezikut të kredisë ( "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15), sipas të cilit, bankat ishin të detyruara për të transferuar të gjitha kërkesat të cilat janë rezervuar plotësisht për më shumë se dy vjet në të dhënat jashtë bilancit më së voni deri më 30.6.2016. Ky detyrim vazhdon edhe mëtej për llogaritë e arkëtueshme me probleme të cilat i plotësojnë kriteret e mësipërme. Edhe përkundër shlyerjes, bankat e mbajnë të drejtën për pagesën e këtyre kërkesave.

<sup>15</sup> Nëse do të përjashtohen efektet e kësaj mase, cilësia e portofolit të kredisë të subjekteve jo-financiare, matur nëpërmjet pjesëmarrjes së kredive me probleme ndaj totalit të kredive, nuk ka ndryshuar. Por sipas sektorëve, ka përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredive të korporatave në aktivitetin kreditor të zvogëluar të bankave ndaj këtyre klientëve, ndërsa cilësia e kredive për ekonomitë familjare është përmirësuar.

<sup>16</sup> Shlyejtet e kryera në përputhje me ndryshimet rregullatore dhe shlyerjet e rregullta.






kaluar për 1.1 pikë përqindje. Pa efektin e shlyerjeve, rritja vjetore e kredive me probleme për kompanitë jo-financiare do të ishte i moderuar dhe do të ishte 5.2% në krahasim me rritjen e realizuar në fund të vitit 2015 (5.9%) duke sinjalizuar disa përmirësime të cilësisë në këtë segment të portofolit kreditorë. Për kredite me probleme për ekonomitë familjare, rritja vjetore do të jetë 5.8%, që në krahasim me lëvizjen në rënie të kredive "të këqija" në fund të vitit të kaluar (-0.1%), ndërsa një sasi relativisht e vogël e shlyerjeve të detyrueshme të realizuara, shënon përkeqësim të caktuar në cilësinë e kredive për këtë sektor.

Grafik.17

Pjesa e kredive me probleme në totalin e kredive për kompanitë jofinanciare, sipas aktiviteteve në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

\* Me kredite në "tregun e pasurive të patundshme" nënkuptohen kredite për kompanitë jofinanciare që merren me aktivitetet e ndërtimitarëve dhe të pasurive të patundshme, si dhe kredi për persona fizik, bazuar në kredite për blerjen dhe renovimin e hapësirave të banimit dhe afariste.

**Ndryshimet në nivelin e totalit dhe kredive me probleme si rezultat i shlyerjeve të kryera çuan në një përmirësim të dukshëm në normën e kredive me probleme<sup>19</sup>** ndaj subjekteve jofinanciare, e cila në fund të vitit 2016 u reduktua në 6.6%. Pa efektin e shlyerjeve, kjo normë është 10.8% dhe është në të njëjtin nivel si në fund të vitit të kaluar.

**Në kuadër të sektorit të "kompanive jo-financiare",** norma e kredive me probleme është zvogëluar që nga nisja e obligimit të shlyerjes së detyrueshme, dhe në fund të vitit 2016 u reduktua në nivelin një shifrorë prej 9.9%. Një nivel i tillë për së fundi herë është regjistruar në fund të vitit 2009, prej kur norma e kredive "të këqija" në përgjithësi ka shënuar tendencë të qëndrueshme rritëse (deri në futjen e shlyerjes së detyrueshme). Nëse përjashtojmë ndikimin e shlyerjeve, kjo përqindje do të ishte 15.6%, që është nivel më i lartë në krahasim me fundin e vitit të kaluar (15.2%). Sipas aktiviteteve<sup>20</sup>, rreziku i kredisë është më i lartë në kërkesat e bankave nga veprimtaritë "ndërtimtari dhe aktivitete lidhur me pasuritë e patundshme" dhe "industria". Megjithatë, rreziku i kredisë është reduktuar në këto dy aktivitete, duke

<sup>19</sup> Norma e kredive me probleme paraqet pjesëmarrjen e kredive me probleme në gjithsej kredite.


<sup>20</sup> Ekspozimi kreditor për klientët nga aktivitetet e bizneseve me shumicë dhe pakicë ka pjesëmarrjen më të lartë në ekspozimin e përgjithshëm të kredisë për kompanitë jo-financiare (34.5%). Për më tepër, kredite me probleme për klientët në këtë veprimtari kanë një pjesëmarrje më të madhe, prej 30.6%, në totalin e kredive me probleme për kompanitë jo-financiare.





Grafik.19


Pjesëmarrja e kredive me probleme në totalin e kredisë për ekonomitë familjare, sipas llojeve të kredisë në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik.18

Krahasimi në mes të përqendrimit të portofolit total dhe të kredive me probleme të subjekteve jofinanciare, sipas bankave në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Shënim: Vija e zezë tregon trendin. BMMZH SHA Shkup është përjashtuar nga analiza për shkak të aktiviteteve të saj specifike (ka numër të vogël të klientëve jofinanciar).

përfshirë edhe "tregtinë me shumicë dhe pakicë". Në sektorin e ndërtimtarisë, kjo lëvizje mund të lidhet edhe me performancat e favorshme të sektorit. Gjegjësisht, sektori i ndërtimtarisë është ndër sektorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe përmirësimi i performancës së këtij aktiviteti është një reflektim i aktivitetit në rritje të ndërtimit të ndërtesave për banim, ndërsa një rritje solide kanë shënuar edhe investimet kapitale shtetërore. Për më tepër, vlerësimi i gjendjes ekonomike të kompanive të ndërtimit është e favorshme, dhe për periudhën e ardhshme priten zhvendosje të favorshme në porositë (kontratat) për ndërtim dhe çmimet e shitjes së apartamenteve<sup>21</sup>. Në rrezikun e zvogëluar të kërkesave nga aktiviteti tregtar referojnë edhe vlerësimet e favorshme të gjendjes aktuale afariste dhe financiare të kompanive, si dhe pritjet për porosi të rritura dhe rritja e çmimeve të shitjes në të ardhmen, duke pasur parasysh rritjen në vlerën e qarkullimit në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me automjete<sup>22</sup>.

### Kreditimi i ekonomive familjare sjell rreziqe më të vogla ndaj bankave.

Norma e kredive me probleme në këtë sektor është 2.6%, ose 4.9% pa efektin e shlyerjeve. Niveli më i ulët i kësaj norme në krahasim me fundin e vitit 2015 (5.2%), përveç se me ndryshimet rregullative lidhet edhe me mbështetjen solide të kreditimit për ekonomitë familjare, që rrjedh nga faktorë, si nga ana e ofertës, ashtu dhe nga ana e kërkesës e këtyre kredive. Sipas produkteve të veçanta kreditore, ulja më e madhe në normën e kredive me probleme<sup>23</sup> u regjistrua për "kartat e kreditit", e cila është ndoshta një rezultat i shlyerjeve të detyrueshme të kryera (kreditë bazuar në kartat e kreditit janë ulur çdo vit nga 824 milionë denarë ose për 6.1%) për këtë lloji të kërkesave nga ekonomitë familjare, pavarësisht kreditimit të ngadalësuar në këtë bazë pas futjes së kërkesave më të larta kapitale për ekspozimin

<sup>21</sup> Burimi: Anketa mbi tendencat e biznesit në ndërtimtarin për tremujorin e katërt të vitit 2016, ESHS.


<sup>22</sup> Burimi: Anketa e trendeve në tregtinë me pakicë për tremujorin e katërt të vitit 2016, ESHS.

<sup>23</sup> Për kreditë e automobilave kjo normë është ulur për 17.3 pikë përqindjeje, por tradicionalisht, norma e kredive me probleme është më e lartë për këtë lloj kredie. Në vitet e fundit ka një trend të shuarjes së këtij lloji të kredisë në bilancet e bankave.

në bazë të llogarive rrjedhëse dhe kartave të kreditit.<sup>24</sup>

**Përqendrimi i portofolit të kredive me probleme është jashtëzakonisht i lartë,** duke pasur parasysh se dhjetë ekspozimet më të mëdha me probleme përbëjnë 62.0% të totalit të ekspozimeve me probleme të sistemit bankar. Kjo do të thotë se kërkesat me probleme të bankave janë kryesisht për shkak të disa klientëve më të mëdhenj. Sipas bankave, pjesëmarrje e dhjetë ekspozimeve më të mëdha me probleme në pjesën e portofolit me probleme lëviz në interval prej 26.5% deri në 93.3%. **Ekspozimet më të mëdha me probleme të bankave janë solide të rezervuara (83.1%), duke i reduktuar humbjet e papritura nga këto ekspozime dhe efektin e mundshëm negativ mbi mjetet e veta.**

Grafik.20  
Struktura (lartë) dhe normat vetore të ndryshimit (poshtë) të korigjimit të vlerës, sipas sektorëve në milionë denarë (lartë) në përqindje (poshtë)



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

## 1.2 Kapaciteti i bankave për t'u përballur me humbjet eventuale nga kreditë me probleme

Në vitin 2016, korigjimi i vlerës të totalit të portofolit të kredive të bankave u zvogëlua për 11,198 milionë denarë, ose për 32.4%. Zvogëlimi më i ndjeshëm i korigjimit të vlerës rezulton nga transferimi i lartpërmendur i kredive me probleme të rezervuara plotësisht në evidencën jashtëbilancore.

**Mbulimi i kredive me probleme me korigjimin e vlerës të ndarë është i lartë, që tregon një kapacitet të kënaqshëm të sistemit bankar për absorbimin e humbjeve të pritshme të kredive,** dhe gjithashtu e "zbut" nivelin e rrezikut të ndërmarrë të kredisë. Në fund të vitit 2016, mbulimi i kredive me probleme me korigjimin e vlerës për kreditë me probleme


<sup>24</sup> Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14, 223/15 dhe 218/16) është rritur kërkesa kapitale për kreditë e reja konsumatore (miratuar më 01.01.2016) për një periudhë të barabartë ose më të gjatë se tetë vjet (për të ngadalësuar rritjen e madhe të këtij lloji të kredisë). Për të parandaluar transferimin drejt tejkalimit të llogarive bankare dhe kartave të kreditit, janë vendosur kërkesa më të larta kapitale për rritjen bazuar në këto produkte, realizuar në 31.12.2015.



është ulur, por akoma është e lartë. Rënia e treguesit është për shkak të shlyerjeve të detyrueshme të kryera.

Grafik.21

Mbulimi i kredive me probleme dhe pjesëmarrja e kredive neto me probleme në mjetet vetanake të bankave në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Mbulimi solid i kredive me probleme me korigjimin e vlerës së alokuar i kufizon efektet negative nga mundësia e mospagesës totale mbi kapitalin e bankave.** Gjegjesisht, pjesa e pambuluar e kredive me probleme përfshinë vetëm 7.1% të totalit të mjeteve vetanake të sistemit bankar, nga të cilat do të mbuloheshin humbjet e papritura në rast të skajshëm hipotetik të mospagesës së plotë të këtyre kredive. Në një supozim të këtillë ekstrem, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar do të ulej për me vetëm 1.1 pikë përqindje (për 0.2 pikë përqindje më pak se ulja e supozuar në vitin paraprak).

### 1.3 Burime të tjera të mundshme të realizimit të rrezikut të kredisë

Në vitin 2016, norma vjetore e mospagimit të ekspozimit të kredisë me status të rregullt<sup>25</sup> është 1.8% dhe është më e ulët se niveli mesatar i rrezikut të kredive të rregullta për entitetet jo-financiare<sup>26</sup> (2.8%), të përcaktuara nga bankat. Kjo tregon se bankat janë më të kujdesshme dhe kanë ndarë korigjimin të vlerës diçka më të lartë se norma historike e mospagesës së ekspozimeve me status të rregullt.

Analizuar sipas aktiviteteve individuale (te kompanitë jo-financiare) dhe produktet e kredisë (te ekonomitë familjare) normat vjetore të mospagesës në përgjithësi shënojnë trend të pandryshueshëm, me përjashtim të përmirësimit të ndjeshëm në aktivitetin e "ndërtimitarisë dhe aktiviteteve të lidhura me pasuri të patundshme". Zhvendosja e favorshme e normës vjetore të mospagesës për ekspozimet e këtij aktiviteti është pjesërisht për shkak të bazës së lartë

<sup>25</sup> Norma vjetore e mos-pagesës së ekspozimit të kredisë është llogaritur si përqindje e ekspozimit të kredisë me status të rregullt, e cila për një vit kalon në ekspozim me status me probleme.


<sup>26</sup> Llogaritur si raport midis korigjimit të vlerës të kredive të rregullta dhe të shumës bruto të kredive të rregullta.

fillestare (përkeqësimi i konsiderueshëm në portofolin e kredisë gjatë vitit 2015). Gjithashtu, në të njëjtën periudhë janë miratuar ekspozime të reja të kredisë për kompanitë ndërtimore cilësia e të cilëve, në periudhën e ardhshme njëvjeçare (31.12.2015 – 31.12.2016), ka mbajtur një nivel solid.

Këto zhvillime japin këshilla të caktuara për ndalim të trendit të përkeqësimit të cilësisë së ekspozimeve nga aktivitetet e klasifikuara më të rrezikshme në sektorin e "kompanive jo-financiare", të cilat, megjithatë, mbetet të monitorohen dhe konfirmohen në të ardhmen.

Grafik.22

Norma vjetore e mospagimit\* të ekspozimit të kredisë me status të rregullt dhe nivelin mesatar të rrezikut për kreditë e rregullta (majtas), dhe pjesëmarrja e kredive të rregullta të pasiguruara në totalin e kredive të rregullta (djathtas), sipas aktiviteteve individuale dhe llojeve të kredisë në mjetet vetanake të bankave në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

\* Shënim: Norma vjetore e mospagimit të ekspozimit të kredisë llogaritet si përqindje e ekspozimit të kredisë me status të rregullt, që për periudhë njëvjeçare kalon në ekspozim me status me probleme.


**Pavarësisht mbulimit të duhur të kredive me korigjimin e vlerës së ndarë (duke i marrë parasysh normat historike vjetore të mospagesës), për t'u shënuar është edhe pjesëmarrja e lartë e kredive për të cilat është vendosur sigurim i veçantë (86.1% e totalit të kredive të rregullta të subjekteve jo-financiare), që e "zbut" nivelin e**



rrezikut të kredisë të marrë nga bankat dhe njëkohësisht, mund të shërbejë si një burim potencial (dytësor) për pagesë. Politikat më konservatore të bankave në kuptim të mbulimit të kredive me sigurim u mundëson siguri më të madhe gjatë kreditimit, por nga ana tjetër, mund të jetë një faktor kufizues për zgjerimin e kreditimit bankar dhe të vështirësojë qasjen e konsumatorëve në burimet e nevojshme të financimit. Gjithashtu, kolaterali i vendosur zakonisht është një burim i kostove shtesë edhe për bankat dhe klientët (kostoja e vendosjes së kolateralit, kostoja e vlerësimit të rregullt të vlerës së kolateralit, kostot e marrjes dhe shitjes së pronës të vendosur si kolateral, paaftësia për të shitur pronën me një çmim të favorshëm, etj.). Niveli i lartë i mbulimit me kolateral është kryesisht karakteristike për kërkesat e rregullta të kompanive jofinanciare (ku mbulimi me kolateral është 98%<sup>27</sup>). Në ekonomitë familjare, kreditë e rregullta për banim janë pothuajse plotësisht të mbuluara me kolateral (99.6%), por mbulimi i kredive të rregullta për financim të konsumit<sup>28</sup> është më pak se dy të tretat, që rezulton nga kërkesat më liberale për kolateral për shkak të natyrës së këtij lloji të kredive. Gjithashtu, në 70.8% të kredive të rregullta të siguruara për financim të konsumit, sigurimi i vendosur i përket vetëm garantuesit dhe kambialit.

Grafik.23

Treguesit e nivelit të përqendrimit të ekspozimit ndaj subjekteve jofinanciare në përqindje



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Pavarësisht përqindjes më të lartë të korigjimit të vlerës të vendosur për kreditë e rregullta, krahasuar me normat historike vjetore të mospagesës së një ekspozimi kreditor të rregullt, si dhe pjesëmarrja e lartë e kredive me kolateral të vendosura, humbjet nga mundësia e materializimit të rrezikut të kredisë mund të tejkalojnë pritjet (rezervat e ndara) të bankave, veçanërisht në rast të kushteve të pafavorshme të biznesit.


Humbjet për shkak të realizimit të rrezikut të kredisë mund të jenë mbi pritjet e bankave për shkak të përqendrimit **relativisht të lartë të**

<sup>27</sup> Shkalla e mbulimit është e njëjtë edhe tek kërkesat me probleme.

<sup>28</sup> Ekspozimi kreditor për të financuar konsumin e personave fizikë përfshin ekspozimin në bazë të kredive konsumatore, tejkalimet në llogaritë rrjedhëse, kartat e kreditit, kredi e automobilave dhe kredi të tjera, përveç kreditë për banim dhe kreditë për hapsira afariste.

Grafik.24

Dinamika e kredive të vazhduara dhe treguesit strukturorë (lart) dhe treguesit e cilësisë së tyre (mes dhe poshtë) në milionë denarë dhe në përqindje (lart), në përqindje (mes dhe poshtë)



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**portofolit të kredive të bankave të veçanta,** si për klientët individualë, ashtu dhe sipas disa karakteristikave të tjera të klientëve (për shembull, që i përkasin aktiviteteve të caktuara). Kjo **çon në korrelacion më të theksuar në mes të cilësisë së portofolit të kredisë totale dhe kryerjes së aktiviteteve të veçanta, veçanërisht të pranishme në kushte të paqëndrueshme të biznesit.** Në fund të vitit 2016, dhjetë ekspozimet më të mëdha të bankave ndaj entiteteve jo-financiare zënë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve vetanake të bankave (103.3%), edhe atë në interval prej 5.3% deri në 191.7%, sipas bankave individuale. Niveli mesatar i rrezikut të këtyre ekspozimeve ndaj bankave është zakonisht i ulët dhe korrespondon me kategoritë e rrezikut "A" dhe "B", por te disa banka në strukturën e ekspozimeve më të mëdha janë vërejtur edhe ekspozime me rrezik më të lartë. Nivel të lartë të koncentrimit të ekspozimit të kredisë tregon edhe treguesi për pjesëmarrjen e ekspozimeve<sup>29</sup> të mëdha në mjetet vetanake të bankave (63.9%), pavarësisht prirjes rënëse të vitit të kaluar (80.8% më 31.12.2015). Përqendrimi është veçanërisht i lartë në disa nga bankat (sipas bankave të veçanta, pjesëmarrja e ekspozimeve të mëdha ndaj subjekteve jofinanciare lëviz në interval prej 0% deri në 194.4%). Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e lartë të ekspozimeve të mëdha në mjetet vetanake, mjaft e rëndësishme është ruajtja e nivelit të tyre të rrezikut, sepse realizimi eventual i rrezikut të këtyre ekspozimeve dhe paaftësia për t'u paguar, efekti në mjetet vetanake të bankave do të ishte i madh.


**Kreditë e vazhduara (sipas rregullave, vazhdimi i maturimit të kredive nuk është rezultat i përkeqësimit të gjendjes financiare të klientëve) përfaqësojnë 8.8% të totalit të kredive të subjekteve jo-financiare.** Kjo pjesëmarrje është në nivel të ngjashëm edhe në dy segmentet e sektorit jofinanciar (8.1% për kompanitë jo-financiare dhe 9.9% për ekonomitë familjare). Sidomos është e theksuar rritja e

<sup>29</sup> Ekspozimi i lartë kah personat dhe personat e ndërlidhur me to paraqet ekspozimin e barabartë apo më të lartë se 10% nga mjetet e vetë bankës.



Grafik.25

Treguesit për cilësinë e kredive me periudhë faljeje të miratuar (lart), pjesëmarrja e kredive me periudhë faljeje të miratuar në totalin e kredive (mes) dhe pjesëmarrja e kredive me probleme me periudhë faljeje të miratuar në totalin e kredive me periudhë faljeje të miratuar (poshtë), sipas aktivitetet individuale dhe llojeve të kreditit në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

pjesëmarrjes së kredive të zgjata në portofolin e ekonomive familjare, megjithatë, vlen të përmendet cilësia shumë e lartë e këtyre kredive të zgjata<sup>30</sup>. Norma e kredive me probleme për kompanitë jo-financiare të cilat kanë qenë të vazhduara më parë (9.8%) është pothuajse në të njëjtin nivel si në totalin e portofolit të kredisë në këtë segment dhe shënon një rënie të dukshme në krahasim me fundin e vitit 2015 (kur ishte 20.4%). Tendencat e tilla në vitin 2016 ndoshta sugjerojnë se një marrëveshje e mirë e kredive të zgjata për kompanitë jo-financiare që kanë pasur status me probleme kanë qenë të mbuluara me detyrimin rregullator të shlyerjes së detyrueshme të kërkesave me probleme të rezervuara plotësisht. Prandaj, është i nevojshëm monitorimi i kujdesshëm i kësaj kategorie të kredive, për shkak se në periudhën para vitit 2016, te një pjesë e mirë e kredive të zgjata, pikërisht gjendja financiare e përkeqësuar e konsumatorëve, ndoshta, ka qenë arsyeja për vazhdimin e maturimit (në pajtim me rregullativën, zgjatja e afatit të kredisë për shkak të gjendjes së përkeqësuar financiare të klientit ka një trajtim të ristrukturimit).


**Kreditë me periudhë faljeje të miratuar<sup>31</sup> janë dukshëm të pranishëm në portofolit e bankave dhe ato përbëjnë rreth 22% të totalit të kredive të subjekteve jo-financiare (pra 28.0% dhe 16.7% e totalit të kredive për kompanitë jo-financiare dhe ekonomitë familjare, respektivisht), me prirje rritëse të theksuar në vitin e kaluar. Më shumë se një e treta (36.5%) e kredive të aktivitetit të "ndërtimtarisë dhe aktiviteteve të lidhura me pasuri të patundshme", janë me një periudhë faljeje, dhe kjo përqindje është më e lartë edhe në veprimtaritë si "industria" (28.3%) dhe "transport dhe inventarizim" (25.2%). Gjithashtu, sipas produkteve të caktuara të kredive për ekonomitë familjare, rreth një e katërta e kredive konsumatore janë me periudhë faljeje të**

<sup>30</sup> Matur nëpërmjet të pjesëmarrjes së kredive me probleme që janë të vazhduara më parë në gjithsej kreditë për ekonomitë familjare (0.6% në 31.12.2016), në nivelin mesatar të rrezikut të kredive të zgjata të rregullta për ekonomitë familjare (0.2% në 31.12.2016) dhe mbulimi solid i kredive me probleme për ekonomitë familjare që më parë kanë qenë të vazhduara, me korrigjim të vlerës gjithsejt dhe individuale (102.1% dhe 56.4%, respektivisht).

<sup>31</sup> Periudha e mospagimit logaritet si diferencë midis datës së parë të maturimit të principalit dhe datës së miratimit të partive të kreditit tek të cilat kjo diferencë është më e madhe se 90 ditë.

Grafik.27


Struktura e kredive me periudhë mospagimi që ende nuk ka skaduar në datën përkatëse sipas sektorëve dhe data e skadimit (majtas) dhe struktura e kredive me periudhë mospagimi që ende nuk ka skaduar, sipas aktiviteteve të caktuara të kompanive jofinanciare dhe llojeve të kreditve për ekonomitë familjare (djathtas) në milionë denarë



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik.26

Dinamika e kredive me një shlyerje të vetme të principalit dhe treguesit e strukturës dhe cilësisë së tyre (në grafik - EOG) në milionë denarë



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat

miratuar, ndërsa kreditë për banim dhe për hapësira afariste kjo pjesëmarrje është 12.3%, me tendencë të konsiderueshme në rritje. Pjesëmarrja e rritur e kredive me një periudhë faljeje (mospagimi) e ndihmon procesin e ndërmjetësimit financiar dhe çon në rritjen e fleksibilitetit të bankave dhe gatishmërinë për të përmbushur nevojat specifike të klientëve të tyre (për shembull, për të financuar një projekt të caktuar). Megjithatë, nuk duhet të anashkalohej fakti se derisa nuk skadon periudha e miratuar e mospagimit (gjatë së cilës paguhet vetëm interesi) bankat kanë më pak mundësi për rishikimin në kohë të aftësisë kreditore aktuale të klientit. Është pozitive se rreth 40% e kredive të miratuara me një periudhë faljeje (mospagimi) (43.5% dhe 28.5% e kredive për kompanitë jofinanciare dhe ekonomitë familjare, respektivisht) kanë periudhë relativisht të shkurtër mospagimi, jo më shumë se një vit, ndërsa niveli i cilësisë, matur nëpërmjet pjesëmarrjes së kredive me probleme në totalin e kredive me një periudhë mospagimi<sup>32</sup> është 4.7%. Në segmentin e "kompanive jo-financiare" kjo pjesëmarrje është më e lartë dhe arriti në 6.4%<sup>33</sup>, ndërsa në ekonomitë familjare është dukshëm më e ulët dhe arriti në vetëm 1.2%<sup>34</sup>. Megjithatë, shkalla e kredive me probleme në përgjithësi ka një prirje rënëse në subjektet jo-financiare dhe në sektorë të veçantë.

**Një kategori e veçantë e kredive përfaqësojnë kreditë me një shlyerje të vetme të principalit, ku bankat nuk kanë njohuri për rregullsinë aktuale të konsumatorëve në shlyerjen e detyrimit në bazë të principalit deri në skadimin e afatit të maturimit të kredive.** Kreditë me një pagesë të vetme të principalit janë dukshëm të pranishëm në portofolet e bankave për kompanitë jo-financiare, ku në fund të vitit 2016

<sup>32</sup> Kryesisht bëhet fjalë për kredi për të cilat miratohet periudha e faljes gjatë ristrukturimit.

<sup>33</sup> Sipas sektorëve të veçantë, të kompanitë jofinanciare rreziku i kredisë është më i lartë në "ndërtimtari dhe aktivitete lidhur me pasuri të patundshme" (7.5%), ndërsa "industria" renditet aktiviteti i dytë në të cilin norma e kredive me probleme (6.2%) është në një nivel të ngjashëm si në sektorin "kompani jofinanciare".


<sup>34</sup> Sipas llojeve e veçanta të kredisë për ekonomitë familjare, norma e kredive me probleme është më e lartë vetëm për kreditë e tjera (6.3%) dhe kreditë të tregtisë me pakicë (4.9%), por pjesa e tyre në gjithsej kredite për ekonomitë familjare me një periudhë mospagimi është i papërfillshëm (2.9%), ndërsa kreditë konsumatore të cilat janë 76.1% të portofolit të kredisë të ekonomive familjare me periudhë të miratuar mospagimi, norma e kredive me probleme është në të njëjtin nivel (1.2%).





Grafik.28


Pjesëmarrja e kredive me probleme me EOG në totalin e kredive me probleme (lartë), kreditë me probleme me EOG në totalin e kredive me EOG (mes) dhe niveli mesatar i rrezikut të kredive të rregullta me EOG (poshtë), sipas aktivitetit në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik.29

Dinamika dhe niveli mesatar i rrezikut të kredive me afat maturimi për shlyerjen e principalit midis 61 dhe 90 ditëve në milionë denarë në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

rreth një e treta e kredive kanë një klauzolë për shlyerjen e vetme e principalit, por kjo pjesëmarrje ka tendencë rënë në dy vitet e fundit. Kreditë me probleme me një shlyerje të vetme të principalit zënë pjesë të konsiderueshme 27.3% të totalit të kredive me probleme për kompanitë jo-financiare, dhe pjesëmarrja e tyre është më e lartë në tregtinë me shumicë dhe pakicë me 38.9% dhe industria me 29.4%. Përkundër rrezikut më të lartë të pandarë të kredive me një shlyerje të vetme të principalit (për shkak se bankat nuk kanë njohuri për rregullsinë aktualë të klientëve për shlyerjen e detyrimeve në bazë të principalit), korrigjimi i vlerës, siç përcaktohet nga bankat, për kreditë e rregullta të kompanive jo-financiare me një shlyerje të vetme të principalit është në nivel më të ulët (3.0%) në krahasim me totalin e portofolit të kredisë të përbërë nga kompanitë jo-financiare (3.8%)<sup>35</sup>, që sinjalizon se humbjet nga realizimi i rrezikut të kredisë të këtyre kredive mund të jenë më të larta nga pritjet e bankave.

Vonesa në pagesën e kërkesave të veçanta më shumë se 90 ditë është një nga kriteret bazë për përfitimin e statusit me probleme. Prandaj, **rritja e mundshme në kreditë me ditë vonesë me periudhën e vonesës në shlyerjen e principalit në mes të 61 dhe 90 ditë është një sinjal** i rëndësishëm për të rritur nivelin e kredive me probleme në të ardhmen, pra për realizimin e mundshëm të rrezikut të kredisë në të ardhmen në portofolet e bankave. Në vitin 2016, këto kredi kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej 1,294 milionë denarë, ose për 82.1%<sup>36</sup>, që rezulton nga përkeqësimi i cilësisë së disa konsumatorëve nga sektori "kompani jo-financiare" në fund të vitit. Duke supozuar se asnjë nga kreditë me ditë vonesë në mes të 61 dhe 90 ditëve nuk do të realizohet shlyerja e borxhit në muajin e


<sup>35</sup> Sipas aktiviteteve të ndara të kompanive jofinanciare, diferenca midis nivelit mesatar të rrezikut të kredive të rregullta gjithsejt dhe kredive të rregullta me shlyerjen e njëhershme të principalit është si vijon: industria 4.2% dhe 3.4%; ndërtimtaria dhe aktivitetet e pasurive të patundshme 3.1% dhe 2.4% dhe tregtia me shumicë dhe pakicë 3.1% dhe 2.4%, respektivisht.

<sup>36</sup> Rritja e kredive të vonuara me vonesë në shlyerjen e principalit prej 61 në 90 ditë, e përfshin pjesën e vonuar por edhe pjesën e munguar të principalit të këtyre kredive.

Grafik.30

Dinamika e kredive të rregullta të ristrukturuara dhe treguesit e cilësisë së tyre


në milionë denarë në përqindje



Burimi: Regjistri i Kredive të Bankës Popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik.31

Pjesëmarrja kredive të rregullta të ristrukturuara në totalin e kredive të ristrukturuara (lart) dhe në totalin e kredive me probleme (mes), dhe niveli mesatar i rrishtit të kredive të rregullta të ristrukturuara (poshtë), sipas aktiviteteve në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

ardhshëm, 1.1% e totalit të kredive të rregullta me gjendjen në 31.12.2016 do të kishin kaluar në jofunksionale (me probleme), me çka vetëm mbi këtë bazë kreditë me probleme do të ishin rritur për 2,869 milionë denarë, ose për 15.5%. Megjithatë, në fillim të vitit të ardhshëm (janar 2017) rritja mujore e kredive me probleme është dukshëm më e ulët se sa ky supozim ekstrem dhe është vetëm 0.2%, ose 42 milionë denarë, duke treguar një pagesë solide të pjesës për ty shlyer prej 61 deri në 90 ditë dhe vetëm rritje në vonesë të rastësishme më shumë se 61 ditë ( deri në 90 ditë).

**Trendi dhe cilësia e kredive të ristrukturuara janë një tregues i rëndësishëm i rrishtit të kredisë,** pasi që


lidhen me vështirësitë financiare të klientëve të bankave të cilët ka të ngjarë të marrin statusin me probleme në qoftë se bankat nuk i kanë ristrukturuar. Kreditë e rregullta të ristrukturuara përbëjnë rreth një të tretën e totalit të kredive të ristrukturuara dhe shënojnë një prirje rënëse të qëndrueshme gjatë viteve. Në strukturën e këtyre kredive mbizotërojnë kompanitë jofinanciare. Duke supozuar se ristrukturimi i kredive të rregullta ka qenë i pasuksesshëm, këto kredi do të kishin marrë statusin me probleme, dhe norma e kredive me probleme në fund të vitit 2016 do të ishte më e lartë për 1.8 pikë përqindjeje. Në kompanitë jofinanciare kjo normë do të ishte më e lartë për 3.1 pikë përqindjeje, gjë që vë në dukje rrishtin më të lartë të kreditimit të sektorit të korporatave.

**Suksesi i bankave në ristrukturimin e kredive vlerësohet në detaj duke monitoruar performancën e kredive dy vjet pas ristrukturimit,** duke pasur parasysh se dy vjet janë të mjaftueshme për të vëzhguar efektet e këtij aktiviteti bankar.

Për kredi të ristrukturuara me "sukses" konsiderohen kreditë që janë paguar ose kanë status të rregullt dy vjet pas ristrukturimit. Kështu, në fund të vitit 2016 ristrukturimi ishte i suksesshëm në rreth më shumë se një të tretën e ristrukturimeve të realizuara gjatë vitit 2014.




**Grafik.33**  
Struktura e kredive të ristrukturuara dy vjet më parë me gjendjen e datës përkatëse në përqindje



Burimi: Banka Popullore, bazuar në të dhënat e

**Grafik.32**  
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas aktiviteteve dhe produkteve kreditore sipas simulimit të parë (lartë) dhe të dytë (poshtë)  
Në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.


Vitet e fundit është përmirësuar kapaciteti i bankave për përshtatjen në kohë dhe adekuate të kushteve të kredisë në përputhje me vështirësitë aktuale financiare të klientëve. Zvogëlimi i konsiderueshëm i kredive të rregullta të ristrukturuara (për 1,336 milionë denarë, ose për 21.1%) vjen nga shlyerjet solide gjatë vitit 2016 të kredive që janë ristrukturuar më parë, duke sugjeruar përmirësimin e praktikave të bankave për identifikimin në kohë të vështirësive financiare të klientëve dhe rrjedhimisht, ristrukturimin në kohë dhe të duhur të kërkesave sipas nevojave dhe mundësive të klientëve të tyre. Përveç suksesit të ristrukturimeve të realizuara, shlyerja e shumicës së kredive të ristrukturuara gjithashtu tregon për përmirësimin e gjendjes së klientëve me vështirësi financiare. Gjatë këtyre sinjaleve pozitive, konsiderohet se ristrukturimet e kryera në dy vitet e fundit (2015 dhe 2016) janë të karakterizuara nga një cilësi shumë më e lartë, që do të konfirmohet me anë të një analize të tillë të ngjashme të kryer në periudhën e ardhshme.

### 1.4 Simulimi i stres-testit për ndjeshmërinë e sistemit bankar në rritjen e rrezikut të kredisë

Stres-testet të cilat janë kryer në mënyrë të rregullt, në bazë tremujore kanë për qëllim që të shqyrtojnë ndjeshmërinë e sistemit bankar në përkeqësimin e cilësisë së segmenteve të caktuara të portofolit të kredisë. Ato përbëhen nga një simulim të një transferimi hipotetik prej 10% (simulim i parë) dhe 30% (simulimi i dytë) të ekspozimit të kredisë për kompanitë jofinanciare (sipas aktiviteteve) dhe ekonomive familjare (sipas llojeve të kreditit), veçmas dhe për të dy sektorët së bashku, drejt dy kategorive të ardhshme me rrezik më të lartë. Rezultatet e simulimeve konfirmojnë rezistencën e sistemit bankar ndaj goditjeve të simuluar, por janë pak më të dobëta krahasuar me një vit më parë. Kjo është për shkak të mjaftueshmërisë së kapitalit më të ulët të sistemit bankar para simulimeve, por edhe nga ndjeshmëria më e shprehur e disa

bankave ndaj goditjeve të supozuara. Megjithatë, mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar nuk është reduktuar nën 8% në asnjë nga simulimet, edhe pse te bankat individuale shihet nevoja hipotetike për rikapitalizim, por vetëm nën goditjet e simuluar nga simulimi i dytë ekstrem<sup>37</sup>. Rënia më e madhe në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit në zbatimin e dy simulimeve vërehet gjatë përkeqësimit të dukshëm në aftësinë kreditore të klientëve nga aktivitetet "industria" dhe "tregti me shumicë dhe pakicë", si dhe në ekspozimet në bazë të kredive konsumatore.

Grafik.34  
Norma i mjaftueshmërisë së kapitalit para dhe pas tre goditjeve të kombinuara në përqindje



Burimi: Regjistri i kredive të Bankës popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Si një test plotësues të ndjeshmërisë së sistemit bankar të realizimit të rrezikut të kredisë zbatohen tre simulime të kombinuara hipotetike të përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredisë për subjektet jo-financiare. Më konkretisht, është supozuar se të gjitha kreditë me probleme për entitetet jo-financiare janë krejtësisht të këqija, gjithsej ekspozimi i ristrukturuar i rregullt merr statusin me probleme dhe bankat zbatojnë ristrukturimin e ri të pjesës së rregullt të portofolit të kredisë të cilat sipas madhësisë korrespondojnë me shumën e ekspozimeve të ristrukturuara që kanë marrë statusin me probleme<sup>38</sup>. Në këtë simulim të kombinuar jashtëzakonisht ekstrem norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar është reduktuar në 13.2% dhe është për vetëm 2.1 pikë përqindje më i ulët se niveli aktual (më pak se ulja e supozuar në fund të vitit të kaluar që ishte 2.5 përqindje pikë).

<sup>37</sup> Mjaftueshmëria e kapitalit bie nën 8% në dy banka me goditje të simuluar nga simulimi i dytë.


<sup>38</sup> Sqarim më të detajuar rreth mënyrës së realizimit të tre tipeve të kombinuara të simulimeve është dhënë te Raporti i rreziqeve të sistemit banka në Republikën e Maqedonisë në tremujorin e tret të vitit 2016.



## 2. Rreziku i likuiditetit

Ne vitin 2016, likuiditeti i sistemit bankar, si një nga faktorët kryesorë për stabilitetin e saj dhe rezistencën ndaj goditjeve, mbeti në një nivel të kënaqshëm. Përkundër episodeve të arritjes së rrezikut të likuiditetit për shkak të rrjedhjes së konsiderueshme të depozitave në gjysmën e parë të vitit 2016 (para se gjithash, në prill dhe maj, kur depozitat nga subjektet jofinanciare u zvogëluan për 2.2% dhe 0.7% në muaj) bankat ofruan një funksionim normal (të qetë). Pra, kujdesi i bankave dhe menaxhimi i mirë i likuiditetit, si dhe masat monetare të Bankës popullore kontribuan në stabilizimin e shpejtë të depozitave, e deri në fund të vitit 2016 treguesit e likuiditetit iu afruan nivelit të periudhës së fundit të vitit 2015. Simulimet për goditjet e kombinuara të likuiditetit konfirmojnë se bankat në Republikën e Maqedonisë mbajnë një nivel të kënaqshëm të mjeteve likuide, që u mundëson atyre që të menaxhojnë siç duhet rrezikun e likuiditetit dhe një rezistencë të kënaqshme ndaj rrjedhjeve ekstreme të supozuara të likuiditetit.

Grafik. 35  
Mjetet likuide, struktura dhe rritja  
Në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

### 2.1 Dinamika dhe përbërja e mjeteve likuide


Në fund të vitit 2016, mjetet likuide<sup>39</sup> në nivel të sistemit bankar arrijnë në 132,663 milionë denarë. Edhe përkundër ndryshueshmërisë gjatë vitit, si pasojë e jostabilitetit të prolonguar në mjedisin e brendshëm politik për të vijuar me zhvillimet negative në tregun e depozitave<sup>40</sup>, mjetet likuide të sistemit bankar u rritën për 4,483 milionë denarë (ose për 3.5%), në baza vjetore.

Rritja vjetore e mjeteve likuide është tërësisht rezultat i rritjes së shumës së mjeteve në para dhe mjeteve të bankave të plasuara në

<sup>39</sup> Mjetet likuide i mbulojnë: 1) paratë e gatshme dhe kërkesat e Bankës popullore, ku janë të përfshira paratë e gatshme efektive, paratë e gatshme në llogaritë e bankave në Bankën popullore, depozitat valutore dhe depozitat e disponueshme në Bankën popullore dhe bonot e thesarit; 2) depozitat afatshkurtra në bankat e huaja, përfshirë dhe mjetet e bankave në llogaritë e tyre korresponduese jashtë vendit dhe 3) vlera kontabël e plasmaneve në letrat me vlerë të emetuara nga qeveritë qendrore d.m.th. letra me vlerë shtetërore të emetuara nga Republika e Maqedonisë dhe të emetuara nga vendet e huaja. Për nevojat e analizës së rrezikut të likuiditetit, mjetet dhe detyrimet në denarë me klauzolën valutore konsiderohen si denarë.

<sup>40</sup> Në gjysmën e parë të vitit 2016, janë vërejtur disa presione mbi bazën e depozitave të bankave, si pasojë e përqendërimit të pritshmërive të subjekteve ekonomike, shkaktuar nga veprimet e faktorëve jo-ekonomike - jostabiliteti i situatës politike në vend dhe deklaratimet publike "dyshime" nga individët rreth stabilitetit të bankave dhe depozitat tek ta. Kjo u ndje posaçërisht në prill dhe maj të vitit 2016, kur sistemi bankar u përball me tërheqjen e depozitave nga ana e personave fizik, si dhe me rritjen e kërkesës për valutë. Përveç kësaj, rënia e depozitave ishte më e theksuar tek depozitat në denarë të ekonomive familjare, ku me ç'rast norma mujore e rënies në muajt prill dhe maj ishte përkatësisht 3.0% dhe 3.6%.

**Grafikk. 36**  
Ndryshimet absolute vjetor (lartë) dhe relative (poshtë) i mjeteve likuide sipas komponentëve të veçantë  
Në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Bankën popullore. Komponentët e tjerë të mjeteve likuide të bankave (plasmanet e bankave në letrat me vlerë shtetërore dhe mjetet valutore afatshkurtra në bankat e huaja), u zvogëluan në baza vjetore. Kështu që, në strukturën e mjeteve likuide të bankave pati një rënie vjetore të pjesëmarrjes së letrave me vlerë shtetërore (nga 28.4% në 24.2%) dhe të depozitave afatshkurtra në bankat e huaja (nga 25.8% në 24.2%), për shkak të rritjes së pjesës strukturore të mjeteve në para dhe plasmanëve të bankave në instrumentet e Bankës popullore (nga 45.8% në 51.6%).

Bartësi i rritjes vjetore të mjeteve në para dhe kërkesat e bankave nga Banka popullore në vitin 2016 (për 9,290 milionë denarë, ose për 15.8%), në pjesën më të madhe ishte rritja e plasmanëve të bankave në depozita valutore në Bankën popullore dhe depozitat e disponueshme në Bankën popullore me afat maturimi prej shtatë ditësh, ndërkohë që investimet brenda natës<sup>41</sup> të bankave në depozitat e disponueshme ishin dukshëm më të ulëta. Pra, riaktivizimi i ankandeve të depozitave valutore në Bankën popullore, si instrument monetar, përfshirë edhe ndryshimin e kushteve për plasimin e depozitave valutore të bankave vendore në Bankën popullore<sup>42</sup>, e që u mundësoi bankave të plasojnë depozita valutore në Bankën popullore me një normë interesi pozitiv (për dallim nga normat negative të interesit që mbizotërojnë për plasmanet në euro në tregjet financiare ndërkombëtare), ndikoi në një rritje të konsiderueshme të shumës së depozitave

<sup>41</sup> Në përputhje me vendimin për depozitat në dispozicion („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 49/12, 18/13, 50/13, 166/13 dhe 35/15), bankat mund të plasojnë depozita në Bankën popullore çdo ditë pune me afat maturimi një ditë pune dhe një here në javë me afat maturimi 7 ditë. Këto depozita plasohen pa mundësi tërheqje të pjesëshme ose të plotë para kohe. Normat e interesit për këto depozita mbetën të pandryshuara gjatë gjithë vitit 2016, dhe arritën në 0.25% për depozitat brenda natës dhe 0.5% për depozitat me afat maturimi prej shtatë ditësh.


<sup>42</sup> Më 5.5.2016, Këshilli i Bankës popullore miratoi një vendim të ri për depozitimim valutuar pranë Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 87/16), ku ndryshimi kryesor në krahasim me depozitat e vendimit paraprak në fuqi për depozitimim valutuar pranë Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 42/2011), ishte në mënyrën e përcaktimit të normës së interesit për depozitat në euro që bankat do t’i plasojnë në Bankën popullore. Pra, me vendimin paraprak në fuqi këto norma të interesit ishin të barabarta me normat e interesit të mjeteve të plasuar në bankat qendrore të eurozonës, në institucionet financiare ndërkombëtare dhe kthimet e bonove të thesarit të vendeve anëtare të eurozonës, dhe me vendimin e ri normat e interesit përcaktohen nga Guvernatori.



Grafik. 37

Paratë e gatshme dhe kërkesat e bankave nga Banka popullore, sipas instrumenteve të veçanta, shuma (lartë) dhe ndryshimi vjetor (poshtë)

Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

valutore të plasura në Bankën popullore<sup>43</sup>. Për rrjedhojë, edhe ndryshimet në strukturën e përgjithshme të mjeteve likuide sipas karakteristikave valutore, ishin në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së mjeteve likuide valutore të bankave, e që arriti në 31.0% (nga 28.6% në vitin paraprak). Përkundër lëvizjeve të tilla, investimet e bankave në bonot e thesarit në vitin 2016 shënuan rënie vjetore prej 8.3%. Ankandet e bonove të thesarit, gjatë vitit 2016, u zbatuan përmes një tenderi me shuma të ofruara të përcaktuara dhe të kufizuara, ku me çrast gjatë vitit Banka popullore bëri disa ndryshime në lartësinë e normës së interesit dhe në shumën e ofruar të bonove të thesarit<sup>44</sup>.

**Investimet e bankave në letrat me vlerë shtetërore vendore shënuan rënie vjetore (nga 7 miliardë denarë ose për 18.4%, sipas vlerës neto kontabël).** Pra, në tremujorin e dytë të vitit 2016, në kushtet e tërheqjes së shumave të konsiderueshme të depozitave nga sistemi bankar, rrjedhimisht zvogëlimi i mjeteve likuide, bankat i shfrytëzuan plasmanet në letrat me vlerë shtetërore (si një nga instrumentet më likuide) për amortizimin e goditjes së likuiditetit. Nga ana tjetër, në tremujorin e katërt të vitit 2016, mjetet likuide të bankave gradualisht u kthyen në nivelet para episodit të krizës, kurse oferta e letrave me vlerë shtetërore në këtë periudhë të vitit u zvogëlua, duke pasur parasysh huamarrjen paraprake të


<sup>43</sup> Banka popullore ndërpreu mbajtjen e akandeve mbi depozitat valutore duke filluar nga 28.10.2016. Vendimi për depozitim valutor në Bankën popullore mbeti në fuqi, që mundëson përsëri riaktivizimin e këtij instrumenti sipas kushteve të tregut.

<sup>44</sup> Si përgjigje e rrjedhjes së depozitave nga bankat dhe nevojës për të zburur pritshmëritë negative të subjekteve ekonomike dhe presionet e intensifikuara në tregun valutor, në maj të vitit 2016, Banka popullore e rriti normën e interesit në bonot e thesarit për 0.75 pikë përqindje (nga 3.25% në 4.0%). Megjithatë, nën ndikimin e një stabilizimi të caktuar të pritshmërive të subjekteve ekonomike dhe likuiditetit strukturor dukshëm më të lartë të sistemit bankar, në muajin dhjetor të vitit 2016, janar dhe shkurt të vitit 2017, Banka popullore ndoqi tre ulje në normën e interesit nga 0.25 pikë përqindje, ku me çrast lartësia e saj u zvogëlua në 3.25% (ashtu siç ishte para ngjarjeve që lidhen me luhatjet e depozitimit dhe tregut valutor). Ndryshimet në lartësinë e normës së interesit të bonove të thesarit, u shoqëruan edhe nga disa ndryshime në lartësinë e shumës së ofruar të bonove të thesarit, edhe atë: në maj të vitit 2016 me një rënie prej 25,500 në 22,000 milionë denarë (me të cilën Banka popullore sterilizoi një shumë më të vogël të mjeteve nga sistemi), në dhjetor të vitit 2016 me një rritje nga 22,000 milionë denarë në 23,000 milionë denarë, në janar të vitit 2017, gjithashtu me një rritje nga 23,000 milionë denarë në 25,000 milionë denarë, kurse në mars të vitit 2017 me një rritje deri në 30,000 milionë denarë, gjegjësisht për 5,000 milionë denarë më shumë nga niveli i bonove të thesarit të maturuara. (25,000 milionë denarë).

Grafik. 38

Investimet e bankave në letrat me vlerë shtetërore vendore

Në milionë denarë dhe në përqindje




Burimi: Ministria e financave dhe Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.  
Vërejtje: Struktura e investimit të letrave me vlerë shtetërore është treguar sipas vlerës nominale të tyre.

shtetit në tregjet ndërkombëtare (përmes emetimit të Eurobondit). Kështu që, plasmanet e bankave në letrat me vlerë shtetërore<sup>45</sup> shënuan një rënie vjetore prej 10.6% (dhjetor 2016 - dhjetor 2015, sipas vlerës nominale të tyre), që u përcaktua tërësisht nga zvogëlimi i plasmaneve të bankave në obligacione shtetërore (në strukturën e maturitetit të obligacioneve shtetërore që i posedojnë bankat, pothuajse dy të tretat u përkasin obligacioneve me afat maturimi më të vogël, prej dy apo tre vjetësh). Megjithatë, bankat ende e luajnë rolin e investitorit më të rëndësishëm në tregun primar të letrave me vlerë shtetërore, me një pjesëmarrje pothuajse 40.0% në vlerën e përgjithshme të letrave me vlerë shtetërore.

Grafik. 39

Oferta dhe kërkesa dhe norma e interesit në akandet e bonove të thesarit të Bankës popullore

Në milionë denarë dhe në përqindje



Burimi: Banka popullore.

<sup>45</sup> Si letra me vlerë të vazhdueshme shtetërore konsiderohen bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara në tregun financiar vendor dhe nuk përfshihen letrat me vlerë strukturore, d.m.th. obligacionet e denacionalizimit.






Grafik. 40

Shuma neto e lëshuar (majtas) dhe oferta dhe kërkesa (djathtas) të letrave me vlerë shtetërore vendore

Në millionë denarë




Burimi: Ministria e financave dhe Banka popullore.

Grafik. 41

Ndryshimi vjetor i depozitave afatshkurtëra në bankat e huaja

Në millionë denarë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.


**Komponenti më i rëndësishëm valutor i mjeteve likuide të bankave<sup>46</sup> janë mjetet e plasura në bankat e huaja me një maturitet të kontraktuar më pak se një vit.**

Këto mjete në vitin 2016 vazhduan të zvogëlohen me një ritëm disi më të shpejtë, në krahasim me vitin paraprak, por megjithatë u mbajtën në një nivel të caktuar dhe të qëndrueshëm, që mundësoi shfrytëzimin e tyre si për qëllime operative ashtu edhe për nevojat e menaxhimit, para se gjithash me likuiditetin dhe rrezikun valutor. Zvogëlimi i këtyre mjeteve lidhet kryesisht me mundësinë e investimit të depozitave valutore në Bankën popullore. Pjesa më e madhe e mjeteve afatshkurtra të investuara në bankat e huaja janë plasuar brenda natës, respektivisht gjenden në llogaritë korresponduese të bankave vendore jashtë vendit, të cilat zakonisht kanë përfitime të ulëta, madje edhe negative. Në kundërshtim me lëvizjet e vitit paraprak, në vitin 2016, zvogëlim më të madh shënuan mjetet me afat maturimi prej tre deri në dymbëdhjetë muaj.

<sup>46</sup> Mjetet likuide valutore përbëjnë depozitat afatshkurtëra në bankat e huaja, përfshirë edhe mjetet në llogaritë korresponduese, investimet në letrat me vlerë shtetërore të huaj, mjetet valutore dhe plasmanet në depozita valutore në Bankën popullore.


**Grafik. 42**  
Normat bazë të interesit të brendshëm - vendor (lartë) dhe normat bazë të interesit ndërbankar SKIBOR, EURIBOR dhe LIBOR për dollarin amerikan (poshtë)

Në përqindje



Burimi: Banka popullore dhe faqja e internetit e Institutit Evropian për tregun e parave për Euribor dhe faqja e internetit e Bankës Federale të Rezervave nga St Louis (a.q. FRED) për LIBOR për dollarë amerikan.

**Grafik. 43**  
Dallimi i SKIBOR-it në raport me EURIBOR-in, për maturimet e zgjedhura  
Në pike përqindje



Burimi: Logaritja nga Banka popullore, sipas të dhënave publike në dispozicion për normat e interesit ndërbankar.


Pas zvogëlimit të normës bazë të interesit për bonot e thesarit në dhjetor të vitit 2016 (nga 4.0% në 3.75%), bankat në mënyrë të moderuar e zvogëluan normën e interesit indikativ për tregtimin ndërbankar me depozita (SKIBOR), ndërkohë që norma e interesit ndërbankar për transaksionet e realizuara brenda natës (MKDONIA) mbeti në nivel të qëndrueshëm prej 1.0%. Gjithashtu, u vërejtën disa ndryshime edhe tek normat bazë të interesit në tregjet ndërkombëtare ndërbankare. Pas vendimit të FED-it, për të rritur normën bazë të interesit në dhjetor 2015 dhe pritjet për rritjen e sërishme të saj (që ndodhi në dhjetor të vitit 2016 dhe në mars të vitit 2017), norma e interesit ndërbankar LIBOR për dollarët amerikan shënoi një rritje. Anasjelltas, EURIBOR, jo vetëm tek maturimet më të shkurtra por edhe tek maturiteti më i lartë i dymbëdhjetë muajve, mbeti në zonën e vlerave negative, që u zgjeruan edhe më tej<sup>47</sup>. Dallimi i interesit mes normave indikative të interesit të tregut në Republikë e Maqedonisë dhe në zonën e euros u zgjerua në gjysmën e parë të vitit 2016, kurse gjysma e dytë e vitit shënoi një ngushtim të lehtë.

<sup>47</sup> Banka Qëndrore Evropiane dërgoi sinjale për marrjen e masave shtesë për lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare, që gjatë marsit të vitit 2016 u shndërruan në vendime konkrete (zvogëlim të norms së interesit në operacionet bazë për refinancim nga 0.05% në 0.00%, të normës së interesit të depozitave nga -0.30% në -0.40% dhe të norms së interesit për sigurimin e kredive brenda natës nga 0.30% në 0.25%).




#### Grafik. 44

Pjesëmarrja në burime të reja të financimit në baza vjetore  
Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Vërejtje: Sipas bankave individuale, në fund të vitit 2016, pjesëmarrja e mjeteve likuide në mjetet e përgjithshme varioi në interval prej 16.4% në 43.7% (2015: prej 15.5% në 39.6%), me një mesatare prej 27.3%. Mbulimi i detyrimeve afatshkurtëra me mjete likuide është në interval prej 32.6% në 77.6% (2015: prej 31.7% në 75.2%), me një mesatare prej 50.1%, ndërsa mbulimi i detyrimeve me maturim të mbetur kontraktual deri në 30 ditë varion prej 37.2% në 146.4% (2015: prej 36.9% në 163.1%, me një mesatare prej 70.5%). Treguesi kreditë / depozitat varioi në interval prej 61.9% në 119.7% (2015: prej 72.5% në 128.7%), me një mesatare prej 93.2%.

Vëllimi i burimeve të reja<sup>48</sup> të financimit të gjetura nga bankat tregoi një shkallë të lartë të ndjeshmërisë ndaj zhvillimeve të brendshme politike dhe ngjarjeve spekulative që shkaktuan turbulencë në tregun e depozitave. Megjithatë, depozitat e subjekteve vendore jofinanciare vazhdojnë edhe më tej të kenë rol dominues në burimet e financimit të aktiviteteve të bankave vendore, si një nga karakteristikat kryesore të bankave maqedonase<sup>49</sup>.

Në vitin 2016, gatishmëria e bankave për të ndërmarrë rreziqe u mbajt në një nivel relativisht të lartë. Pra, më shumë se 70% e burimeve të reja të financimit të bankave në vitin 2016 janë përdorur për huadhënie.

## 2.2 Treguesit e likuiditetit

**Në vitin 2016, likuiditeti i sistemit bankar, i monitoruar përmes treguesve të likuiditetit<sup>50</sup> u konsiderua i kënaqshëm dhe i qëndrueshëm, edhe pse në baza vjetore treguesit shënuan një rënie modeste.**

Zvogëlimi ishte i pranishëm në gjysmën e parë të vitit, në kushte të oscilimeve (lëkundjeve) negative të depozitave dhe rritjes solide në aktivitetin kreditues të bankave. Trendi i rënies nuk ishte me intensitet të barabartë në treguesit individualë. Shuma tradicionalisht e lartë e mjeteve likuide (si përqindje e aktiveve të përgjithshme) që bankat e rruajnë, mundësoi shërbimin e qetë (pa pengesa) të kërkesës për pagesën e depozitave në tremujorin e dytë të vitit 2016. Por kjo, nga ana tjetër, çoi në një zvogëlim


<sup>48</sup> Burimet e reja të financimit dhe përdorimi i tyre nga bankat merren nëpërmjet llogaritjes indirekte, gjegjësisht përmes ndryshimit të saldove të llogarive individuale nga bilanci i bankave. Efekti në flukset monetare të bankave, për shkak të shpenzimeve dhe të ardhurave të cilat nuk përbëjnë një rrjedhje ose dalje të parave të gatshme (për shembull: shlyerjet e kredive, rivlerësimi i letrave me vlerë të disponueshme për shitje ose të mbajtura për tregtim, amortizimi i mjeteve bazë, dallimet neto të kursit, etj) është pjesë përbërëse e ndryshimit në zërat përkatës të bilancit ku referohet hyrja ose dalja përkatëse, përderisa efekti i zhvlerësimit të kredive dhe mjeteve tjera përfshihet në burimet e përgjithshme të financimit. Gjatë llogaritjes është përfshirë efekti i kërkesave dhe detyrimeve ndërbankare vendore.

<sup>49</sup> Në vitin 2016, pjesëmarrja e depozitave të subjekteve jofinanciare në strukturën e burimeve të reja të financimit të bankave, ishte pothuajse 80%.

<sup>50</sup> Gjatë llogaritjes së treguesve të likuiditetit në nivel të sistemit bankar nuk merren parasysh mjetet dhe detyrimet ndërbankare rezidente.



Grafik. 46  
Kreditë/depozitat  
Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Vërejtje: Pjesa e hijëzuar në grafik paraqet një dallim të një devijimi standard mbi dhe nën mesataren lëvizëse pesëvjeçare të treguesit.

të mjeteve likuide në tremujorin e dytë të vitit<sup>51</sup>, që shkaktoi uljen e treguesve për mbulimin e kategorive të caktuara të detyrimeve me mjete likuide. Megjithatë, deri në fund të vitit 2016, mjetet likuide të bankave u rritën dhe treguesit e likuiditetit pothuajse u kthyen në nivelin e fundit të vitit 2015.

**Në vitin 2016, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave të subjekteve jo-financiare shënoi përmirësim të konsiderueshëm** (zvogëlim për 3.6 pikë përqindjeje në krahasim me vitin 2015). Pra, ky tregues është më shumë se një devijim standard nën mesataren e tij lëvizëse dymbëdhjetë mujore dhe në të njëjtën kohë nën mesataren e tij lëvizëse pesëvjeçare. Arsyeja e rënies qëndron në rishikimin rregullativ të kredive jo-funksionale plotësisht të rezervuara. Nëse përjashtojmë efektin e shlyerjes, ky tregues do të arrinte në 91.2%, dhe do të ishte pak më i lartë krahasuar me vitin paraprak, por më i ulët se 100%. Vetëm tek katër bankat në sistem (të cilat përfshijnë 19% të aktiveve të sistemit bankar<sup>52</sup>) ky tregues është mbi 100%, që i referohet financimit të një pjese të kredive nëpërmjet burimeve jo-depozituese të mjeteve, të cilat, me rregull, konsiderohen burim financimi me ndryshueshmëri të lartë.

<sup>51</sup> Për dallim nga viti 2015, në kushtet e rritjes vjetore të depozitave të subjekteve jofinanciare vendore, historikisht norma të ulëta interesi mbi letrat me vlerë shtetërore dhe kthime relativisht të ulëta në tregjet financiare ndërkombëtare, nxitësi kryesor i uljes së mjeteve likuide ishte aktiviteti kreditues i bankave dhe pjesërisht faktorët e natyrës jo ekonomike (trazirat politike në vend, pastaj kriza e borxheve në Greqi), në gjysmën e parë të vitit 2016, rënia e mjeteve likuide u shkaktoi nga rrjedhja e depozitave, e shkaktoar nga reaksionet psikologjike të popullsisë vendore të mjedisit të brendshëm politik.


<sup>52</sup> Gjashtë bankat, me një pjesëmarrje në totalin e mjeteve prej 23.8% më 31.12.2015.



Grafik. 47

Treguesit e likuiditetit të sistemit bankar sipas valutës - denarë (lartë) dhe valutave (poshtë)

Në përqindje




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Nga aspekti i **karakteristikave valutore të mjeteve likuide dhe detyrimeve**<sup>53</sup>, treguesit e likuiditetit gjatë vitit 2016 treguan dinamikë të ndryshme. Pra, treguesit e likuiditetit valutore u përmirësuan dhe u shfaqën posaçërisht në gjysmën e dytë të vitit. Motori i kësaj lëvizjeje ishte rritja e komponentit valutore të mjeteve likuide të bankave, nën ndikimin e mundësisë për plasim në depozita valutore në Bankën popullore, por edhe lëvizjet e përmirësuara në tregun valutore. Përkundër kësaj, treguesit e likuiditetit në denarë shënuan kryesisht lëvizje rënëse, por akoma janë shumë më të larta krahasuar me treguesit e likuiditetit valutore, si rrjedhojë e pjesëmarrjes strukturore më të lartë të mjeteve likuide në denarë në totalin e mjeteve likuide të bankave.

Grafik. 48 Normat e likuiditetit për sistemin bankar

Në pikë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Normat rregulluese të likuiditetit të sistemit bankar**<sup>54</sup>, të paraqitura si raport mes mjeteve dhe detyrimeve, që maturohen brenda 30 ditëve dhe 180 ditëve të ardhshme, mbetën pothuajse në nivelin e njëjtë të vitit paraprak dhe janë më të larta se minimumi i përcaktuar prej 1.

<sup>53</sup> Bankat i pranojnë dhe i kthejnë detyrimet në denarë (depozita) dhe detyrimet (depozita) në denarë me klauzolë të valutës në denarë, duke krijuar një fluks parash (hyrje ose dalje) në denarë. Detyrimet valutore, në përputhje me dispozitat e ligjit për operacionet valutore, bankat i marrin dhe i kthejnë ato në valutë të huaj të përshtatshme dhe rrjedhimisht, kanë një fluks monetar të pritshëm (hyrje ose dalje) në valutë të huaj.


<sup>54</sup> Mënyra e llogaritjes së normave të likuiditetit deri në 30 ditë dhe deri në 180 ditë përcaktohet me vendimin për menaxhimin e rreziqut të likuiditetit të bankave („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 126/11, 19/12 dhe 151/13).

### 2.3 Struktura e maturitetit të mjeteve dhe detyrimeve

Grafik. 49

Struktura e mjeteve dhe detyrimeve të bankave sipas maturitetit të tyre të mbetur kontraktual

Në përqindje




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Në vitin 2016, lëvizjet në strukturën e mjeteve dhe detyrimeve, sipas maturimit të tyre të mbetur, synonin kryesisht rritjen e pjesëmarrjes së mjeteve me një maturim të mbetur deri në një muaj dhe mbi një vit, dhe detyrimeve me maturim të mbetur deri në një muaj.** Në anën e mjeteve, rritja e pjesëmarrjes së mjeteve me maturim të mbetur deri në një muaj shpjgohet me rritjen e mjeteve likuide, kryesisht nëpërmjet rritjes së mjeteve të bankave në Bankën popullore, ndërsa tek detyrimet e bankave, rritja vjetore, në pjesën më të madhe lidhet me rritjen e konsiderueshme të depozitave pa afat në gjysmën e dytë të vitit. Në të njëjtën kohë, për shkak të rënies së kredive afatshkurtra të subjekteve jofinanciare, e theksuar më së shumti në gjysmën e parë të vitit, në baza vjetore u rrit pjesëmarrja e mjeteve me një maturim të mbetur më shumë se një vit.

Grafik. 50

Struktura e hendekut mes mjeteve dhe detyrimeve, me maturim të mbetur kontraktual deri në një vit

Në million denarë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.


**Mospërputhja e maturitetit mes mjeteve dhe obligimeve të bankave është e lartë, kurse në vitin 2016 vuri në dukje thellimin e mëtejshëm.** Mospërputhja më e madhe mes mjeteve dhe obligimeve sipas maturitetit kontraktual të mbetur edhe më tej vazhdon në segmentin e maturimit deri në shtatë ditë, që zakonisht rrjedh nga përfshirja e detyrimeve të bankave në këtë segment të maturimit pa afat dhe pa maturitet fiks.



Grafik. 51

Stabiliteti i pritshëm i depozitave me maturim të mbetur deri në tre muaj, nga ana e bankave

Në përqindje




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Dhe në vitin 2016, bankat priten qëndrueshmëri të lartë të depozitave, si burim kryesor i financimit.** Pra, në fund të vitit 2016, bankat priten që 83.5% e depozitave me afat maturimi deri në tre muaj (82.8% më 31.12.2015) të mbeten në banka edhe gjatë tre muajve të ardhshëm. Disa përkeqësime janë vërejtur tek pritshmëritë e bankave për stabilitetin e depozitave pa afat krahasuar me vitin paraprak. Tek depozitat pa afat, përfshirë edhe mjetet e llogarive transaksionale, përqindja e stabilitetit të pritshëm arriti 78.1% (në vitin 2015: 82.7%). Bankat **ende presin një hendek maturimi pozitiv mes mjeteve dhe detyrimeve** (aneks nr. 33).

Grafik. 52

Zvogëlimi i mjeteve likuide gjatë simulimit për goditjet e kombinuara të likuiditetit

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

## 2.4 Simulimet e stresit për goditjet e likuiditetit

**Likuiditeti i kënaqshëm i sistemit bankar maqedonas u konfirmua edhe nëpërmjet rezultateve të marra nga simulimet për goditjet e likuiditetit.**

Vëllimi i mjeteve likuide mundëson rezistencë ndaj sistemit bankar, madje edhe në simulimin e një goditje ekstreme të likuiditetit, që përfshin daljet e kombinuara të shumë llojeve të burimeve të financimit<sup>55</sup> jashtë bankave. Me një simulim të tillë mjetet likuide të sistemit bankar përdoren plotësisht (mbi 100%). Përveç kësaj, mungesë e mjeteve likuide do të kishte në njëmbëdhjetë banka me një pjesëmarrje të përbashkët në mjetet e përgjithshme të sistemit bankar prej 59.5%, në fund të vitit 2016. Nëse për nevojat e këtij simulimi zgjerohet fushëveprimi i mjeteve likuide me instrumente tjera financiare<sup>56</sup>, për të

<sup>55</sup> Gjatë simulimit supozohet një rrjedhje e: depozitave të njëzet depozituesve më të mëdhenj, 20% të depozitave të ekonomive familjare, detyrimet ndaj subjekteve amë (detyrimet e bazuara në instrumente të varura dhe instrumentet hibridë të kapitalit përjashtohen nga simulimi, ngase në përputhje me rregulloren për llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit, pagesa e tyre është e rregulluar), 50% të detyrimeve ndaj jorezidentëve (me përjashtim të detyrimeve ndaj personave jo-rezidentë të bankave, që janë mbuluar tashmë me një nga simulimet e mëparshme) dhe konvertimin e detyrimeve të caktuara jashtë bilancore të bankave (akreditivi i pa mbuluar, linjat e pakthyeshme të kredisë dhe kufizimet e papërdorura në bazë të kartelave dhe miratimin e mbitërheqjeve në llogaritë e transaksioneve) në kërkesat e bilancit. Gjatë kryerjes së simulimeve për goditjet e likuiditetit është i përjashtuar „BMPZH“ SHA Shkup, për shkak të kufizimit ligjor për qasje në tregun e depozitave.


<sup>56</sup> Gjatë këtij zgjerimi të mbulimit të mjeteve likuide, përveç instrumenteve financiare që i përfshijnë mjetet likuide, shtohen edhe instrumentet financiare vijuese (në qoftë se janë të pranishëm): depozitat afatgjata në bankat e huaja, instrumentet e tregut të pasurisë të lëshuara nga emetuesit e huaj jo-shtetërorë, kreditë me maturim të mbetur kontraktual deri në 30 ditë, si dhe efekti i zvogëlimit të rezervës së detyrueshme për detyrimet valutore të bankave që është e ndarë në valuta për shkak të rrjedhjes së simuluar të depozitave valutore të ekonomive familjare.

cilën mund të supozohet se bankat brenda një afati prej 30 ditësh mund relativisht shpejt dhe lehtë t'i arkëtojnë ose t'i kthejnë në mjete në para, atëherë sistemi bankar do të dispononte me mjete likuide të mjaftueshme, respektivisht rënia e mjeteve likuide në nivelin e sistemit bankar do të arrinte 94.0%, (që do të thotë se pas goditjeve të tilla ekstreme madje do të mbetej në dispozicion një shumë e caktuar e mjeteve likuide, analizuar në nivelin e sistemit bankar).

Grafik. 53

Kontributi i goditjeve të veçanta të kombinuara në zvogëlimin e mjeteve likuide gjatë simulimit për goditje të kombunuar të likuiditetit

Si përqindje e zvogëlimin të mjeteve likuide



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Gjatë zbatimit të goditjeve individuale të supozuara të likuiditetit, bankat kanë mjete të mjaftueshme likuide për të shlyer rrjedhjet e simuluar të parasë.** Përveç kësaj, si më të rëndësishme janë simulimet për rrjedhjen e depozitave të 20 deponituesve më të mëdhenj dhe për rrjedhjen e 20% të depozitave familjare (amvisëritë). Sipas bankave të veçanta (individuale), tek goditja e para vërehet se ka një rëndësi të ndryshme për disa banka, kryesisht për shkak të dallimeve në shkallën e përqendrimit të depozitave. Tek simulimi për rrjedhjen e 20% të depozitave të ekonomive familjare (amvisëritë), rezulton një ngjashmëri më e madhe në rezultatet për bankat individuale, me të cilën konfirmohet rëndësia e depozitave për financimin e aktiviteteve të tyre, respektivisht qëndrueshmëria e pozicionit të likuiditetit të bankave, si dhe rritja potenciale e aktiviteteve, më së shumti varet nga ngjarjet dhe qasja e bankave në tregun e depozitave dhe ruajtja e besimit të depozitarëve vendas<sup>57</sup>.

Nga goditjet tjera të mbetura, disi me shumë rëndësi është vërejtur në simulimin për konvertimin e zërave të zgjedhur jashtë bilancor në kërkesat bilancore, kurse goditjet që lidhen me daljet e detyrimeve ndaj jorezidentëve ose daljet e detyrimeve ndaj personave amë pa trajtim të instrumenteve kapitale, kanë një kontribut më të vogël në formimin e përgjithshëm të daljeve të kombinuara, që pasqyrojnë volumnin më modest të financimit të bankave përmes këtij lloji të detyrimeve.

<sup>57</sup> Pikërisht ngjarjet që lidhen me uljen e depozitave të bankave në tremujorin e dytë të vitit 2016, kontribuan që bankat të ballafaqohen me një nga goditjet e likuiditetit të cilat supozohen në simulimet e zakonshme të stres - test-it.






### 3. Rreziku valutor

Në vitin 2016 u rrit ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut valutor, i matur përmes raportit të hendekut mes aktivitetit dhe pasivitetit me komponentin valutor dhe gjithsej mjetet vetanake, e që u rrit në një nivel prej 14.3%. Megjithatë, ekspozimi i drejtpërdrejtë i bankave ndaj rrezikut valutor është ende në një nivel të pranueshëm, kurse raporti ndërmjet pozicionit të valutës së huaj dhe mjeteve vetanake në secilën bankë është brenda kufirit të përcaktuar rregullator (30% e mjeteve vetanake të bankave). Euro është valuta e huaj më e zakonshme në bilancin e bankave dhe kështu, strategjia e aplikuar për mbajtjen e kursit valutor nominal të qëndrueshëm të denarit kundrejt euros, është me rëndësi të jashtëzakonshme për mbajtjen e probabilitetit të ulët për arritjen e rrezikut valutor. Denarizimi në bilancin e bankave, e cila vazhdimisht ishte e pranishme në vitet e mëparshme, në vitin 2016 u ndërpre, veçanërisht tek depozitat, që ishte një pasqyrim i besimit të lëkundur në stabilitetin e valutës vendase dhe bankave vendase nën ndikimin e politikës së brendshme.


Grafik. 54

Ndryshimi vjetor i aktivës dhe pasivës me komponentin valutor

Në milion denarë



Në përqindje




Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Grafik. 55

Pjesëmarrja e aktivës dhe pasivës me komponentin valutor \* në totalin e aktiveve të bankave

Në përqindje



Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

\* Në kuadër të aktivës, kreditë janë marrë në bazë - neto, gjegjësisht janë zvogëluar për shumën e zhvlerësimit. Është e përjashtuar „BMPZH” SHA Shkup.

**Më 31 dhjetor 2011, hendeku mes aktivitetit dhe pasivitetit me komponentin valutor u zgjerua për 1,558 milionë denarë krahasuar me 31 dhjetor 2015 dhe arriti në 6,791 milionë denarë.** Rritja më e lartë e aktivitetit me komponentin valutor (10,626 milionë denarë) në raport me rritjen e pasivitetit me komponentin valutor (9,068 milionë denarë), kontribuoi në zgjerimin e hendekut mes tyre<sup>58</sup>.

<sup>58</sup> Rritja e aktivës me komponentin valutor rrjedh nga rritja solide vjetore e kredive në denarë me klauzolën valutore (e miratuar për familjet), si dhe nga rritja e plasmaneve të depozitave afatshkurtëra në Bankën popullore (duke pasur parasysh riaktivizimin e depozitave valutore në BPRM-së, si instrument monetar). Në anën e pasivës me komponentin valutor, rritja e depozitave valutore pa afat (para se gjithash llogaritë rrjedhëse) të familjeve dhe kompanive jo-financiare, kontribuan më së shumti në rritjen vjetore të pasivës me komponentin valutor.


Për rrjedhojë, edhe raporti mes këtij hendeku dhe mjeteve vetanake të sistemit bankar u rrit, edhe atë për 2.9 pikë përqindje.

Shkalla më e lartë e rritjes së aktivitet me komponentin valutor, në kushtet kur aktivi i përgjithshëm shënoi një rritje më të ngadaltë, kontribuoi në rritjen e pjesëmarrjes së tij në totalin e aktiveve të sistemit bankar me 0.3 pikë përqindje, me të cilën u ndërpre trendi rënës i këtij raporti. Pjesëmarrja e pasivitet me komponentin valutor mbeti pothuajse në nivelin e njëjtë.

Grafik. 56


Struktura e hendekut mes aktivës dhe pasivës me komponentin valutor (majtas) dhe pjesëmarrja e hendekut mes aktivës dhe pasivës në mjetet vetanake (djathtas)

Në milionë denarë



— Hendeku në mes aktivitet dhe pasivitet në valutë të huaj  
 — Hendeku në mes aktivitet dhe pasivitet në Denarë me klauzol valutore  
 — Hendeku në mes aktivitet dhe pasivitet në komponent valutore

Në përqindje



— Hendeku në mes aktivitet dhe pasivitet në valutë të huaj / mjetet e veta  
 — Hendeku në mes aktivitet dhe pasivitet në Denarë me klauzol valutore / Mjetet e veta  
 — Hendeku në mes aktivitet dhe pasivitet në komponent valutore / Mjetet e veta

Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.


\* Është e përjashtuar „BMPZH“ SHA Shkup.

**Analizuar sipas statusit të rezidentit, hendeku pozitiv me komponentin valutor të aktiviteteve të bankave me jorezidentët është më i gjerë sesa hendeku negativ nga operacionet me rezidentët, që në nivel të agreguar kushtëzoi një hendek pozitiv mes totalit të aktivitet dhe pasivitet me një komponent valutor.** Pozicioni i shkurtër,



Grafik. 57

Kërkesat\* dhe detyrimet me komponentin valuator ndaj/prej rezidentëve dhe jo rezidentëve dhe hendeku mes tyre  
Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.


\*Kërkesat me komponentin valuator prej jo rezidentëve përfshijnë edhe efektiven valutore të bankave (e cila konsiderohet si kërkesë nga Banka Qëndrore - emetues i valutave).

\*\*Në analizë nuk është e përfshirë „BMPZH“ SHA Shkup.

Grafik. 58

Dinamika dhe struktura e hendekut mes aktivës dhe pasivës me komponentin valutor, sipas valutave

Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

gjegjësisht hendeku negativ nga aktivitetet me rezidentët, është rezultat i shumave relativisht të larta të depozitave valutore të arkëtuara, që tejkalon shumën e kredive me komponentin valutor e miratuar për rezidentët. Hendeku me komponentin valutor nga operacionet me jorezidentët është pozitiv dhe para se gjithash rrjedh nga plasmanet valutore të bankave në bankat e huaja, shuma e të cilave është më e lartë në krahasim me detyrimet valutore ndaj jorezidentëve (për pjesën më të madhe, ndaj subjekteve të huaja amë të bankave vendase).

**Analizuar sipas valutave, më 31 dhjetor 2016, zgjerimi i hendekut mes aktivitet dhe pasivitet me komponentin valutor doli kryesisht nga hendeku në dollarë amerikanë, i cili këtë vit për herë të parë, pas një periudhe të gjatë, ishte pozitiv.** Ky ndryshim doli si rezultat i rritjes së depozitave të bankave në dollarë amerikanë.<sup>59</sup> Nga ana tjetër, hendeku pozitiv mes aktivitet dhe pasivitet në euro u zvogëluar. Euro është valuta më e zakonshme në bilancet e bankave në Republikën e Maqedonisë, andaj mbajtja e kursit valutor stabil të denarit kundrejt euros është me rëndësi të jashtëzakonshme për mundësinë e arritjes së ekspozimit të bankave ndaj rrezikut valutor. Rritja e hendekut në dollarë amerikan rrit rrezikun valutor, megjithatë pozicionet në këtë valutë nuk janë të rëndësishme.


**Ndryshueshmëria më e theksuar e vlerës së Paundit britanik kundrejt monedhave tjera botërore e shënoi vitin 2016 në tregjet ndërkombëtare valutore.** Në pjesën më të madhe të vitit, vlera e Paundit britanik shënoi rënie (sidomos në periudhën menjëherë pas referendimit mbi tërheqjen e Britanisë së Madhe nga BE), e që u ndal pjesërisht në tetor të vitit 2016, pasi vlera e Paundit britanik shënoi një rritje të konsiderueshme. Megjithatë, ndryshimet më të rëndësishme në kursin e Paundit britanik kundrejt

<sup>59</sup> Depozitat e bankave në dollarë amerikanë u rritën për 3.090 milionë dollarë.

Grafik. 59

Lëvizja e kursit të denarit në raport me dollarin amerikan, frangën zvicerane, paundin britanik dhe dollarin australian.

Në denarë



Burimi: BPRM-së.

valutave tjera botërore nuk kanë pasur ndikim të madh në sistemin bankar vendor, për shkak të peshës së ulët të kësaj valute në strukturën e aktiveve dhe detyrimeve me komponentin valutator. Pra, Paundi britanik merr pjesë vetëm me 0.6% në totalin e aktiveve dhe pasiveve me komponentin valutator. Bankat pothuajse nuk kishin kredi të aprovuara në Paundi britanik, a në anën e depozitave (në pasiv) vërehen disa shuma më të vogla në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e nominuar në këtë valutë.

Tabela. 4

Struktura valutore e aktivës dhe pasivës me komponentin valutator

Në përqindje

Valuta	31.12.2015		31.12.2016	
	Aktivi	Pasivi	Aktivi	Pasivi
<b>Euro</b>	88,9	87,5	88,4	87,6
<b>Dollari Amerikan</b>	6,7	8,0	7,1	7,9
<b>Frangu Zviceran</b>	1,8	1,7	2,0	1,8
<b>Dollari Australian</b>	0,9	1,3	1,0	1,2
<b>Të tjerë</b>	1,6	1,6	1,6	1,6
<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>

Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.


Deri në fund të vitit 2016, vlera e dollarit amerikan filloi të rritet, që ishte në përputhje me pritjet për një rritje të normave të interesit në FED në dhjetor të vitit 2016. Dollari amerikan, pavarësisht se është valuta e dytë më e zakonshme në sektorin bankar, prapë se prapë pjesëmarrja në totalin e aktiveve, gjegjësisht pasivi me komponentin valutator është e ulët.



Grafik. 60

Depozitat në denarë dhe me komponentin valuator të personave fizik (majtas) dhe kompanive jofinanciare (djathtas)

Në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Në depozitat nuk janë të përfshirë llogaritë transaksionale të personave fizik dhe kompanive jofinanciare.

Grafik. 61

Raporti i agreguar i pozicionit valutor dhe mjeteve vetanake, veçmas për secilën bankë

Në përqindje



Burimi: BPRM - së, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Më 31 dhjetor 2016, të gjitha bankat ishin në përputhje me kufirin e përcaktuar për lartësinë e pozicionit agregat valutor, që nuk duhet të tejkalonte 30%-shin, e mjeteve vetanake të bankave. Bankat, kryesisht rruajnë pozitë të gjatë sipas valutave të veçanta.**


Tabela. 5

Shpërndarja e bankave sipas pjesëmarrjes në pozicionin e hapur valutor sipas valutave dhe pozicionit valutor agregat në mjetet vetanake

Përshkrimi	Numri i bankave										Pozicioni agregat valutor / Mjetet e veta
	Pozicioni i hapur valutor sipas valutave / Mjetet e veta										
	Euro		Dollari Amerikan		Frangu Zvicerian		Australian Dollar		Të tjerë		
	I gjatë	I shkurtë	I gjatë	I shkurtë	I gjatë	I shkurtë	I gjatë	I shkurtë	I gjatë	I shkurtë	
Nën 5%	4	1	12	2	7	6	8	1	13	1	4
Nga 5% gjer 10%	1										2
Nga 10% gjer 20%	5										5
Nga 20% gjer 30%	3										3
mbi 30%											

Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Grafik. 62  
Raporti mes pozicionit të hapur valutor dhe  
mjeteve vetanake, sipas vendeve  
Në përqindje



Burimi: Për Maqedoninë, BPRM, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave, ndërsa për pjesën tjetër të vendeve të dhënat janë marr nga faqja e internetit e FMN - së (treguesit e stabilitetit financiar).

Shënim: Të dhënat për Maqedoninë i referohen 31.12.2016, ndërsa për vendet tjera i referohen 31.12.2015.

**Mes vendeve të analizuara, pas Hungarisë, Maqedonia ka pjesëmarrjen më të lartë të pozicionit të hapur valutor në mjetet vetanake, që megjithatë nuk është e lartë. Nivel mjaft i ulët për këtë tregues, kuptohet, ka tek shtetet e eurozonës (Greqi, Sllovaki dhe Slloveni), si dhe në Kosovë ku euro është përdorur si valutë zyrtare, kurse, pjesëmarrje shumë e vogël e pozicionit të hapur valutor në mjetet vetanake vërehet edhe tek Polonia, Rumania dhe Turqia.**




#### 4. Rreziku nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare

Ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut të ndryshimit të normës së interesit në portofolin e aktiviteteve bankare në vitin 2016 shënon rritje, e cila rezulton nga rritja e maturitetit mesatar të mbetur në pozicionet aktive, gjatë zvogëlimit të njëkohshëm të periudhës mesatare deri në rivlerësimin e ardhshëm të normave të interesit tek pozicionet pasive. Hendeku midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit u rrit, e cila tërësisht është për shkak të zgjerimit të hendekut në pozicionet me norma fikse të interesit. Sipas pozicioneve të marra në portofolin e aktiviteteve bankare, sistemi bankar është i ekspozuar ndaj rrezikut të një rritjeje të ardhshme të normave të interesit. Zbatimi i normave të përshtatura të interesit, për shkak të klauzolave të aplikuara për përshtatshmëri të njëanshme të normave të interesit në marrëveshjet për kredi dhe depozita, e relativizon ekspozimin e bankave ndaj këtij rreziku. Por synimet për braktisje graduale të zbatimit të normave të përshtatshme të interesit dhe ndërlikime të ndryshimit të normave të interesit me faktorët e tregut, do të rrisë rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare, por edhe do të zvogëlojë rrezikun ligjor dhe atë të reputacionit ndërsa bankat do të duhet të përparojnë kapacitetin e tyre për të menaxhuar me rrezikun e ndryshimit të normës së interesit.

Grafik. 63

Vlera e përgjithshme e ponderuar e portofolit të aktiviteteve bankare\*, sipas llojit të normës së interesit, në vlerë absolute (shkalla e majtë) dhe në raport me mjetet vetanake (shkalla e djathtë) Në milionë denarë përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

\*Vlera e përgjithshme e ponderuar e portofolit të aktiviteteve bankare paraqet humbjen e mundshme të vlerës ekonomike të këtij portofoli, nën supozim të një goditje të jofavorshme të normës së interesit prej  $\pm 2$  pikë përqindjeje.



Vlera e përgjithshme e ponderuar e portofolit të aktiviteteve bankare shënon rritje vjetore prej 1,009 milionë denarë dhe u rrit në nivelin e 8.5% të mjeteve vetanake të sistemit bankar (6.7% në fund të vitit 2015). Zhvillimet e tilla në tërësi u kushtëzuan nga rritja vjetore e vlerës së ponderuar të portofolit të aktiviteteve bankare me norma fikse të interesit. Analizuar në veçanti për secilën bankë, raporti në mes të vlerës së përgjithshme të ponderuar dhe mjeteve vetanake të bankave varron nga 0.5% në 16.2%, që ende është nën nivelin e 20%<sup>60</sup>.

<sup>60</sup>Në përputhje me Vendimin për menaxhim me rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 163/2008 dhe 144/2009), në rast kur raporti ndërmjet vlerës së përgjithshme të ponderuar dhe mjeteve vetanake të bankës tejkalon 20%, banka është e detyruar të propozojë masa për uljen e këtij raporti, ndërsa Banka popullore mund të urdhërojë edhe ndarje të shumës së caktuar të kapitalit për të mbuluar rrezikun nga ndryshimi i normës së interesit në portofolin e aktiviteteve bankare.

Grafik. 64

Periudha mesatare deri në rivlerësimin e ardhshëm të normave të interesit\*, të përgjithshëm (lart) dhe sipas llojit të normës së interesit (poshtë)

në muaj



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

\* Për pozicionet me normë fikse të interesit, merret maturiteti mesatar i mbetur.

**Rritja e ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të ndryshimit të normës së interesit në portofolin e aktiviteve bankare vjen nga rritja e periudhës mesatare deri në ndryshimin e ardhshëm të normave të interesit me pozicionet aktive, ndërkohë që njëkohësisht shkurtohet periudha mesatare deri në ndryshimin e ardhshëm të normave të interesit tek pozicionet pasive.** Periudha mesatare deri në rivlerësimin e ardhshëm të normave të interesit (gjegjësisht afati mesatar i mbetur i maturimit) tek pozicionet aktive, u rrit me 1.2 muaj, gjë që u theksua më së shumti tek kreditë me normë fikse interesi. Në anën e pasives, periudha mesatare deri në ndryshimin e ardhshëm të normave të interesit shënon rënie për 0.6 muaj, që ishte kryesisht e pranishme tek detyrimet sipas kredive me normë fikse të interesit, por edhe tek depozitat me afat me normë interesi të përshtatur. Zvogëlimi i periudhës mesatare deri në ndryshimin e ardhshëm të normave të interesit tek depozitat me afat është përcaktuar nga rënia vjetore tek këto detyrime, nën ndikim të presioneve spekulative në prill dhe maj, kur u regjistrua një fluks dalës i konsiderueshëm dhe shkurtrim i maturitetit të depozitave.







Grafik. 65

Hendeku mes mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit (majtas) dhe ndryshimit vjetor të mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit (djathtas), sipas llojit të normave të interesit

Në milionë denarë



në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Në vitin 2016, hendeku midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit u rrit për 8,208 milionë denarë, ose për 80%, e cila tërësisht rrjedh nga hendeku pozitiv i pozicioneve me norma fikse të interesit.** Në fakt, rritja e kreditimit dhe e plasmanit në depozita me afat me norma fikse të interesit<sup>61</sup>, gjatë zvogëlimit të njëkohshëm të detyrimeve në bazë të kredive dhe depozitave me afat me norma fikse të interesit, zgjeroi hendekun midis pozicioneve me këtë lloj interesi, për 28,948 milionë denarë (ose 39.6%).

Zgjerimi i hendekut negativ midis pozicioneve me normë interesi të përshtatshme (për 18,599 milionë denarë ose 22.6 për qind) rezulton nga rënia më e madhe vjetore e kërkesave bazuar në kreditë me normë interesi të përshtatshme krahasuar me uljen e detyrimeve bazuar në depozitat me afat tek ky lloj i normës së interesit<sup>62</sup>. Më shumë detaje mbi strukturën e pozicioneve të ndjeshme ndaj interesave të

<sup>61</sup>Në bazë të Vendimit për depozitën valutore pranë Bankës popullore, duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, bankat mund të plasojnë depozita valutore në bankën qendrore me norma interesi më të larta se normat e interesit që mbizotëronin në tregjet financiare ndërkombëtare. BPRM-ja i ndërpreu ankandet në depozita valutore duke filluar nga 28.10.2016.


<sup>62</sup>Zvogëlimi vjetor i detyrimeve bazuar në depozitat me afat është rezultat i tërheqjes së shumave të konsiderueshme të depozitave nga sektori bankar në muajt prill dhe maj të vitit 2016.

bankave janë dhënë në aneksin nr. 36 dhe aneksi nr. 37.


Grafik. 66

Struktura e ndryshimeve vjetore në mjetet e ndjeshme ndaj interesit (majtas) dhe detyrimet (djathtas), sipas llojit të instrumentit dhe llojit të normës së interesit

Në milionë denarë



në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Grafik.67

Hendeku midis pozicioneve të aktives dhe pasives, sipas periudhës deri në rivlerësimin e ardhshëm të normave të interesit

Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

**Krahasuar me fundin e vitit 2015, është zgjeruar diferenca kumulative edhe në afat të shkurtër (hendeku negativ)<sup>63</sup> edhe në afat të gjatë (hendeku pozitiv). Duke pasur parasysh strukturën e hendekut sipas llojit të normës së interesit, këto pozicione e ekspozojnë sistemin bankar në rrezikun e rritjes së ardhshme të normave të interesit. Pozicioni i shkurtër deri në një vit ndërmjet pozicioneve aktive dhe atyre pasive të ndjeshme ndaj interesit, për të cilat bankat presin rishikim të lartësisë së normave të interesit për një periudhë jo më të gjatë se një vit, në tërësi rrjedh nga pozicionet me normë interesi të përshtatshme. Në fakt, normat e përshtatshme të interesit janë lloji dominues i normave të interesit në anën e burimeve të financimit të bankave.**


<sup>63</sup>Hendeku negativ midis aktiveve (mjeteve) dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit, ku periudha deri në rivlerësimin (ndryshimin) e ardhshëm të normave të interesit është relativisht e shkurtër dhe nuk kalon një vit, u rrit për 4.9 miliardë denarë dhe më 31.12.2016 arriti në nivelin e 19 miliardë denarë (38.3% e mjeteve vetanake të sistemit bankar).



Grafik. 68

Struktura e hendekut midis pozicioneve të aktives dhe pasives, sipas llojit të normës së interesit

Në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Grafik. 69

Struktura e aktives dhe pasives sipas llojit të normës së interesit

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Pozicioni i gjatë midis pozicioneve të aktives dhe pasives të ndjeshme ndaj interesit, rivlerësimi i normave të interesit të së cilës do të bëhej në një periudhë më të gjatë se një vit, pothuajse tërësisht, rezulton nga kërkesat e bankave me normë fikse interesi. Në fakt, për dallim nga pasivi, tek aktivet apo mjetet mbizotërojnë pozicionet me normat fikse të interesit, pjesëmarrja e së cilës vazhdoi të rritet në edhe në vitin 2016. Kështu, zgjerimi i hendekut midis pozicioneve të aktives dhe pasives në bllokun e maturimit prej një deri në pesë vjet rrjedh nga rregullat për raportim, sipas të cilave kreditë, normat e interesit të të cilëve janë fikse vetëm në vitet e para (ndërmjet tre dhe pesë vite) pas miratimit të tyre (dhe pas skadimit të kësaj periudhe parashikohet aplikim më i shpeshtë i normave të përshtatshme të interesit), në vitet e para ato paraqiten si kredi me interes fikse në shumën e plotë. Zbatimi i klauzolave të përshtatjes së normave të interesit në kontratat për kredi zvogëlon ekspozimin e bankave ndaj rrezikut të lartpërmendur nga rritja e normave të interesit, por i ekspozon ato në rrezik të tërthortë kreditor. Gjithashtu, zbatimi i klauzolave të tilla, jo vetëm në rastin e kredive, por edhe të depozitave, i ekspozon bankat vendore në rrezik ligjor dhe të reputacionit<sup>64</sup>, duke marrë parasysh faktin se normat e përshtatshme të interesit ndryshohen në mënyrë të njëanshme, bazuar në vendim të organit adekuat bankar. **Megjithatë, rreziku nga ndryshimi i normës së interesit në portofolin e aktiviteteve bankare gjithnjë e më shumë fiton rëndësi, duke pasur parasysh synimin për braktisje graduale të zbatimit të normave të interesit të përshtatshme dhe aplikim të normave të interesit të cilat janë të përcaktuara paraprakisht ose ndryshimi i të cilave do të bëhet në bazë të variablave të tregut.**

Me qëllim për të parë se si braktisja e mundshme e plotë e praktikës për përshtatje të njëanshme të lartësisë së normave të interesit nga ana e bankave do të ndikonte në nivelin


<sup>64</sup>Në tetor të vitit 2016, BPRM dërgoi një rekomandim tek bankat për të rritur shkallën e transparencës gjatë formimit të normave të interesit për kreditë dhe depozitat. BPRM pret që bankat të miratojnë kredi dhe të mbledhin depozita, tek të cilat shuma e normës së interesit do të ndryshohet në bazë të parametrevë të përcaktuara qartë paraprakisht në kontratat.

aktual të ekspozimit ndaj rrezikut të ndryshimit të normave të interesit, u përgatit një simulim i veçantë hipotetik. Ky simulim nisët nga supozimi se të gjitha pozicionet e ndjeshme ndaj interesit me norma të përshtatshme të interesit tek bankat, janë pozicione me norma fikse të interesit (gjegjësisht janë të alokuara sipas maturitetit të mbetur të kontraktuar).

Grafik. 70

Raporti i vlerës së përgjithshme të ponderuar të portofolit të aktiviteteve bankare dhe mjeteve vetanake, përpara dhe pas simulimit, për secilën bankë në veçanti

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të ofruara nga ana e bankave.

Rezultatet e simulimit tregojnë një rritje të konsiderueshme të raportit midis vlerës së përgjithshme të ponderuar të portofolit të aktiviteteve bankare dhe mjeteve vetanake, pothuajse tek të gjitha bankat. Kështu që, ky raport, pas zbatimit të simulimit, do të lëvizte në intervalin nga 7.0% deri në 34.4%, me një median prej 19.6%. Në këtë rast, madje shtatë banka do të kalonin raportin e përkthuar prej 20% dhe do të përballeshin me ndarje eventuale<sup>65</sup> të një shume shtesë të kapitalit për të mbuluar këtë rrezik. Raporti i vlerës së përgjithshme të ponderuar të portofolit të aktiviteteve bankare dhe mjeteve vetanake në nivelin e sistemit bankar do të ishte 19.4%, pas simulimit, i cili është më shumë se dyfish, ose për 10.9 pikë përqindje më shumë krahasuar me atë nivelin aktual (para simulimit). Kjo i konfirmon pritjet për rritjen e rrezikut nga ndryshimi i normës së interesit në portofolin e aktiviteteve bankare, pas largimit të normës së përshtatur të interesit.

<sup>65</sup>Në pajtim me rregulloren, në rastet kur raporti ndërmjet vlerës së përgjithshme të ponderuar dhe mjeteve vetanake të bankës tejkalon 20%, banka është e obliguar të propozon masa për uljen e këtij raporti ndërsa Banka popullore mund të urdhërojë edhe ndarjen e shumës së caktuar të kapitalit për të mbuluar rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve.




## 5. Rreziku nga josolventiteti

Në vitin 2016, rritja e mjeteve vetanake të bankave u ngadalësua, por ato ende janë pothuajse dy herë më të larta sesa kërkesat minimale të kapitalit rregullator për mbulimin e rreziqeve individuale. Nëse merren parasysh vëzhgimet e mbikëqyrësit (BPRM) dhe shtesën kapitale të përcaktuar sipas profilit të rrezikut të bankave individuale, atëherë mjetet vetanake të bankave janë për një të tretat më të larta se kërkesat e mbikëqyrësit. Vëllimi dhe struktura e mjeteve vetanake tregojnë një kapacitet solid të bankave për të përmbushur shtresat mbrojtëse të kapitalit që dalin nga marrëveshja ndërkombëtare Bazel 3. Përkundër emitimit të ri të aksioneve, për herë të parë në tre vitet e fundit rritja e mjeteve vetanake mbetet edhe mëtej e kushtëzuar nga të fitimi i akumuluar nga vitet e mëparshme. Treguesit e solventitetit dhe kapitalizimit të sistemit bankar shënuan një rënie të caktuar, që kryesisht është si rezultat i rritjes më të shpejtë të aktives së ponderuara sipas rreziqeve (për shkak të rritjes së kreditimit, por edhe nën ndikimin e ndryshimeve rregullatore). Rezultatet e stres-testit tregojnë një rezistencë të kënaqshme të sistemit bankar ndaj goditjeve të simuluar hipotetike.

Grafik. 71

Treguesit e solventitetit (lart) dhe normat vjetore të ndryshimit të përbërësve të tyre (poshtë)

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.


### 5.1. Treguesit e solventitetit dhe kapitalizimit të sistemit bankar dhe niveli i rrezikut të aktiviteve

Në vitin 2016, treguesit e solventitetit dhe kapitalizimit të sistemit bankar shënuan ndryshime të caktuara rënëse. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit u ul për 0.3 pikë përqindje dhe kap vlerën e 15.2%.

Zvogëlimi i treguesve të solventitetit rrjedh ekskluzivisht nga rritja më e theksuar e aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve, ndërkohë që të gjitha pozicionet kapitale, edhe pse me ngadalësi, vazhdojnë të rriten. Mjetet vetanake u rritën me 3.7% krahasuar me rritjen e realizuar prej 5.8% në vitin 2015, kurse kapitali themelor i sistemit bankar u rrit me një normë prej 5.0% (8.7% në vitin 2015). Në të njëjtën kohë, kapitali dhe rezervat shënuan rritje prej 2.8%, që është për 3.2 pikë përqindje më pak krahasuar me rritjen e regjistruar në vitin 2015. Aktivitetet e bankave gjithashtu shënuan rritje më të ngadalshme, por që akoma është më e lartë krahasuar me rritjen vjetore të regjistruar në pozicionet kapitale të bankave.

Grafik. 72


Niveli i borxhit, rrezikut dhe i solventitetit të sistemit bankar  
Në herë dhe përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Grafik. 73

Shuma dhe struktura e ekspozimit të përgjithshëm bilancor dhe jashtë bilancor, sipas peshave (ponderit) të rrezikut  
Në milionë denarë  
përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Shënim: \*Pesha (ponderi) mesatare e rrezikut llogaritet si raport midis aktives së ponderuar sipas rrezikut kreditor dhe ekspozimit të përgjithshëm bilancor dhe jashtë bilancor të sistemit bankar.


Në të njëjtën kohë, u rrit edhe niveli i borxhit të sistemit bankar (i matur si raport mes aktives dhe mjeteve vetanake).

**Në vitin 2016, niveli i rrezikshmërisë së aktiviteteve bankare, i matur si raport mes aktives së ponderuar sipas rrezikut kreditor dhe ekspozimit të përgjithshëm bilancor dhe jashtëbilancor, mbeti i pandryshuar (53.2%).** Në kuadër të aktives së ponderuar sipas rrezikut kreditor, rritja më e madhe prej 12.3 miliardë denarë kanë aktivitetet me peshë rreziku prej 150%, e cila kryesisht është për shkak të ndryshimeve rregulatore që ndodhën kah fundi i vitit 2015. Përkundër kësaj, aktivitetet e bankave të cilat në përlllogaritjen e aktives së ponderuar sipas rrezikut kreditor përfshihen me peshë rreziku prej 50% dhe 75%, u zvogëluan për 3.2 respektivisht 1.4 miliard denarë (ose për 14.4% respektivisht 1.4%)<sup>66</sup>. Në të njëjtën kohë, rritja e qëndrueshme prej 7.6 miliardë denarë (ose për 6.3%) shënojnë edhe aktivitetet me peshë rreziku prej 0%, e që është

<sup>66</sup>Nga 01.01.2016, bankat janë të detyruara të aplikojnë peshën e rrezikut prej 150% të kërkesave të bazuara në kreditë konsumatore të sapo miratuara me një periudhë të kontraktuar të maturimit i cili është i barabartë ose më i gjatë se tetë vjet. BPRM paraqiti kërkesa shtesë kapitale edhe për rritjen e tejkalimeve në llogaritë transaksionale dhe kartelat kreditore, të realizuara deri më 31.12.2015 (në të cilën aplikohet peshë rreziku prej 75%). Në të njëjtën kohë, u futën kërkesa më të ulëta të kapitalit për kërkesat e siguruar nga hapësirat komerciale, nëse plotësohen kushte të caktuara (për këto kërkesa zbatohet peshë e rrezikut prej 75% në vend të mëparshmes 100%) dhe për garancitë përmes së cilave garantohet pagesa në rast të mospërbushjes së detyrimeve të debitorit për pagesë ndaj palës së tretë, të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e caktuar biznesore (për të cilin aplikohet faktor konvertimi prej 50% në vend të mëparshmit 100%). Efekti i përgjithshëm neto i këtyre ndryshimeve në rregullativë është angazhimi i kapitalit shtesë prej rreth 470 milionë denarë, e cila ul normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për rreth 0.3 pikë përqindje, aq sa është edhe vlera e uljes vjetore të realizuar të mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar.




Grafik. 74  
Indeksi ZET për sistemin bankar  
Në nivele



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Grafik. 75  
Masat për shpërndajren e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në sistemin bankar  
Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

rezultat i investimeve të bankave në depozitin devizor të BPRM-së<sup>67</sup>.

Sipas lëvizjeve të indeksit Zet (ang. Z-index)<sup>68</sup>, stabiliteti i sistemit bankar është ende i lartë. Sikurse edhe vitin e kaluar, edhe përkundër profitabilitetit më të lartë të sistemit bankar (matur përmes normës së kthimit të aktives mesatare), zvogëlimi i indeksit Zet më masë të madhe është për shkak të ndryshueshmërisë së madhe të fitimeve bankare në vitin 2016 (matur përmes devijimit standard nga norma e kthimit të aktives mesatare). Edhe përkundër zvogëlimit të indeksit Zet, stabiliteti i përgjithshëm i sistemit bankar është relativisht i lartë dhe nevojitet një goditje negative prej së paku 46.6 devijime standarde nga norma e kthimit të aktives në mënyrë që plotësisht të vijë deri te shterimi i potencialit të kapitalit të sistemit bankar.

Analizuar në veçanti për secilën bankë, normat e mjaftueshmërisë së kapitalit kanë mbetur në nivel të ngjashëm, si në fund të vitit të kaluar. Dallimi midis bankës me mjaftueshmëri më të lartë të kapitalit dhe asaj me më të ulët mbeti pothuajse në të njëjtin nivel, si më 31.12.2015, kurse shtrirja mes tremujorit të tretë dhe atij të parë u zvogëluua me 0.4 pikë përqindje. Mjaftueshmëri më të ulët të kapitalit, e regjistruar në një bankë, ka shënuar rënie të caktuar dhe në fund të vitit 2016 arriti nivelin prej 12.2% (12.6% më 31.12.2015).


<sup>67</sup>Me riaktivizimin e depozitave valutore tek BPRM në maj të vitit 2016, bankat fituan mundësinë të plasojnë depozita valutore në bankën qendrore me norma pozitive të interesit. BPRM-ja pushoi së mbajturi ankandet e depozitave valutore më 28.10.2016.

<sup>68</sup>Indeksi Zet përlogaritet si vijon:  $Z = \frac{ROAA + E/A}{\sigma(ROAA)}$ , ku ROAA paraqet normën e kthimit të aktives mesatare, E janë kapitali dhe rezervat, A paraqet aktiven, kurse  $\sigma(ROAA)$  paraqet devijimin standard nga norma e kthimit të aktives mesatare, e përlogaritur për tre vitet e fundit. Nga formula mund të vërehet se kjo masë në vete kombinon disa tregues: tregues të performancës, profitabilitetit të bankave (ROAA), tregues të nivelit të rreziqeve në veprimtarinë bankare ( $\sigma(ROAA)$ ) dhe masë për stabilitetin dhe solventitetin e bankave (E/A). Kështu i llogaritur, indeksi zet mat "distancën" e bankës nga shterja e plotë e potencialit të kapitalit të saj, e shprehur në numër të devijimeve standarde nga norma e kthimit të aktives dhe, si i tillë, paraqet masë për kapacitetin e bankave për të absorbuar humbjet. Nivelet më të larta të këtij indeksi tregojnë një nivel më të ulët rreziku dhe një nivel më të lartë të stabilitetit të përgjithshëm të bankave. Indeksi Zet zakonisht shprehur në formë logaritmike (logaritëm natyror i formulës së mëparshme) por interpretohet më lehtë dhe është më tregues kur shprehur në nivele.

Grafik. 76

Lartësia dhe struktura e koston (çmimit) së kapitalit\* të bankave, aksionet e të cilave janë të listuara në tregun zyrtar të bursës së Maqedonisë

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

\* Është përllogaritur duke aplikuar modelin për përcaktimin e koston (çmimit) së kapitalit (ang. Capital-Asset Pricing Model - CAPM), ku çmimi i kapitalit është përcaktuar si shumë e: 1) normës së kthimit pa rrezik (përcaktuar si mesatare e të kthimit deri në maturimin e obligacioneve shtetërore të listuara në bursën e Maqedonisë), 2) produkt i koeficientit beta për aksion dhe diferenca midis normës së kthimit të tregut dhe të normës së kthimit pa rrezikut (ose të primit të rrezikut të tregut) dhe 3) primi i rrezikut të vendit (përcaktuar si diferenca midis kthimit të euroobligacioneve maqedonase dhe obligacionet e krahasueshme gjermane).

Në përllogaritje janë përfshin tetë banka, aksionet e të cilave janë të listuara në tregun zyrtar të bursës së Maqedonisë. Primi i rrezikut të tregut është përllogaritur si mesatare e primeve të rrezikut të tregut për secilën bankë veçmas, e ponderuar me madhësinë e aktives të tyre.

**Kostoja e kapitalit (norma e kërkuar e kthimit të investitorëve në aksionet e bankave), e përllogaritur duke përdorur të ashtuquajturin model CAPM (ang. Capital-Asset Pricing Model – CAPM), në mostër prej tetë bankave, shënon rritje të caktuar vjetore, që është rezultat i zgjerimit i primit të rrezikut të tregut dhe rritjes së normës së kthimit pa rrezik.** Kostoja e kapitalit, e llogaritur nga ky model, u rrit për gjysmë pikë përqindje dhe arriti nivelin prej 15.9% në fund të vitit 2016. Kjo është më e lartë për 0.9 pikë përqindjeje krahasuar me normën e kthimit të kapitalit të cilën e realizuan bankat e përfshira në analizë. Norma më e lartë e kërkuar e kthimit nga aksionet e bankave rrjedh nga zgjerimi i primit të rrezikut të tregut për 0.5 pikë përqindje (dhe atë si rezultat i rritjes së koeficientit beta për aksionet e bankave), si dhe nga rritja e normës së kthimit pa rrezik, nga 0.4 pikë përqindje (e pranishme, mbi të gjitha, në gjysmën e parë të vitit 2016). Primi i rrezikut të vendit, pas zgjerimit të vogël në gjysmën e parë të vitit 2016, në pjesën e mbetur të vitit shënoi rënie dhe në bazë vjetore ka shënuar zvogëlim.







Grafik. 77

Raporti ndërmjet çmimit të tregut dhe vlerës kontabile të aksioneve për katër bankat më të mëdha të sistemit (majtas) dhe përqindja e numrit të përgjithshëm të aksioneve të emetuara që janë tregtuar në periudhën e kaluar njëvjeçare, për katër bankat më të mëdha të sistemit (djathtas)

Në numër të herëve



në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Tregtimi me aksionet e bankave në bursën e Maqedonisë shënoi rritje në vitin 2016, e cila korrespondon me rritjen e çmimeve të këtyre aksioneve, midis tyre edhe të raportit mes çmimeve të aksioneve dhe vlerës së tyre të kontabël.

### Përparimi i kornizës rregullore për bankat

Në tetor të vitit 2016 u miratuan ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për bankat, të cilat kanë të bëjnë me futjen e shtresave mbrojtëse të kapitalit, përforcimin e kërkesave për kapitalin e nevojshëm, futjen e normës së borxhit, përparimin e qeverisjes korporative tek bankat dhe përforcimin e masave korrigjuese të cilat mund ti ndërmarr Banka popullore. Për shkak të aplikimit të duhur të këtyre ndryshimeve, Këshilli i Bankës popullore solli disa akte nënligjore përmes së cilave mundësohet harmonizim i mëtejshëm i legjislacionit vendor me reformat e standardit ndërkombëtar të kapitalit (të a.q. Bazel 3) dhe me dispozitat e rregullativës evropiane për operim dhe për kërkesat për kujdes të bankave.

Ndryshimi më i rëndësishëm i Ligjit i referohet detyrimit që bankat të mbajnë të ashtuquajturat shtresat mbrojtëse të kapitalit. Qëllimi kryesor i shtresave mbrojtëse të kapitalit është të mundësojnë siguri më të madhe të pozicionit të solventitetit të bankave mbi kërkesat ligjore lidhur me lartësinë e mjaftueshmërisë së kapitalit, veçanërisht në kushte të rritjes së konsiderueshme të humbjeve të realizuara. Bëhet fjalë për katër lloje shtresash mbrojtëse të kapitalit dhe atë:

1) **Shtresa mbrojtëse për ruajtjen e kapitalit** e përcaktuar në nivelin e 2.5% të aktives së ponderuara sipas rrezikut, të cilën bankat duhet ta mbajnë në mënyrë të vazhdueshme;



2) **Shtresa mbrojtëse kundërciklike e kapitalit** e cila mund të arrij deri në 2.5% e aktivitet të ponderuar sipas rrezikut, por edhe më shumë në varësi të faktorëve dhe indikatorëve të tjerë të sistemit dhe ka për qëllim të kufizoj rreziqet që lidhen me rritjen e shpejtë të kredisë. Norma e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit mund të jetë e ndryshme për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë dhe për ekspozimet në vendet të tjera. Banka popullore është përgjegjëse për përcaktimin e nevojës për futje, rritje, zvogëlim ose lirim, si dhe për përcaktimin e lartësisë së dy normave për shtresa mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, e cila më detajuar është e rregulluar me akt nënligjor përkatës të miratuar nga Këshilli i Bankës popullore;

3) **Shtresa mbrojtëse e kapitalit për bankat me rëndësi sistemore** i cili mund të lëviz nga 1% deri në 3.5% të aktives së ponderuar sipas rrezikut dhe të cilin duhet bankat ta ndajnë, të cilat në bazë të kriterëve dhe treguesve, sipas Vendimit mbi metodologjinë për identifikimin e bankave me rëndësi sistemore, janë identifikuar si banka, veprimtaria e së cilëve është e rëndësishme për stabilitetin e sistemit të përgjithshëm bankar. Bankat e rëndësishme sistemore janë të detyruara të hartojnë plan për rimëkëmbje, përgatitja dhe vlerësimi i së cilave nga Banka popullore është e përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Banka popullore; dhe

4) **Shtresa mbrojtëse e kapitalit për rrezikun sistemor** i cili mund të lëviz nga 1% në 3% të aktives së ponderuar sipas rrezikut dhe është futur nga guvernatori i Bankës popullore me qëllim të kufizimit të rrezikut të prishjes së sistemit financiar ose ekonomisë vendore. Kjo shtresë mbrojtëse e kapitalit mund të jetë e ndryshme për banka ose grupe të ndryshme të bankave.

Shtresat mbrojtëse të kapitalit plotësohen vetëm me pozicionet më cilësore të kapitalit, gjegjësisht me të ashtuquajturat kapital i rregullt themelor, dhe atë ajo pjesë që e tejkalon kapitalin e nevojshëm për mbulim të kërkesave ligjore për sasinë e mjaftueshmërisë së kapitalit (a.q. tepriçë e kapitalit të rregullt themelor). Banka e cila nuk ka sasi të mjaftueshme të tepërt të kapitalit të rregullt themelor për të mbuluar shumën e përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit është e kufizuar sa i përket shumës së rezultatit financiar i cili mund të shpërndahet. Mënyra e përcaktimit të shumës maksimale të shpërndarjes detajisht është e përcaktuar në Vendimin mbi metodologjinë për përcaktimin e shumës maksimale të shpërndarjes së rezultatit nga veprimtaria.


Me ndryshimet në Ligjin për bankar përveç dispozitave ekzistuese për lartësinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit prej së paku 8% nga aktivi e ponderuar sipas rrezikut, janë paraqitur edhe dy kërkesa ligjore lidhur me lartësinë e mjaftueshmërisë së kapitalit, dhe atë: 4.5% e aktives së ponderuar sipas rrezikut, për kapitalin e rregullt themelor dhe 6% të aktives së ponderuar sipas rrezikut, për kapitalin themelor. Këto risi më detajisht janë përshkruar në Vendimin e Këshillit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit mbi metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit nga dhjetori i vitit 2016, me të cilën përveç që u arrit harmonizim i mëtejshëm me kërkesat e Bazelit 3 në aspektin e strukturës dhe përbërjes së mjeteve vetenake, dukshëm u përmirësua cilësia e mjeteve vetenake të bankave përmes forcimit të kriterëve që duhet të plotësojnë disa pozicione të caktuara për të qenë pjesë e mjeteve vetenake të bankave. Në këtë drejtim, ndryshimi më i rëndësishëm ka të bëjë me strukturën e kapitalit themelor i cili ndahet në kapitalin e rregullt themelor dhe kapitalin shtesë themelor, ndërkohë që struktura e kapitalit shtesë ka mbetur pothuajse e pandryshuar. Në kapitalin e rregullt themelor përfshihen pozicionet kapitale të cilësisë më të lartë (kapital dhe rezervat aksionare) që janë plotësisht dhe menjëherë të disponueshme për mbulimin e rreziqeve dhe humbjeve gjatë operimit të bankës dhe për të cilat pozicione banka duhet të marrë miratimin nga Banka popullore. Në anën tjetër, në kapitalin shtesë themelor përfshihen instrumente që, ndër të tjera, përmbajnë klauzolë për konvertimin e tyre në instrumente nga kapitali i rregullt themelor ose për shlyerjen e tyre të përkohshme ose të përhershme (reduktim të vlerës së principalit të tyre), në raste të përcaktuara saktësisht.

Përveç parashkrimit të shtresave mbrojtëse të kapitalit dhe ndryshimeve në strukturën e mjeteve vetenake, në shkurt të vitit 2017 u miratua vendimi mbi metodologjinë e menaxhimit të rrezikut të borxhit, përmes së cilit detajohet mënyra e përllogaritjes së normës së borxhit, si një raport mes vlerës së kapitali themelor dhe vlerës së të gjitha aktivitetëve bilancore dhe jashtëbilancore të bankës.



Në drejtim të harmonizimit të mëtejshëm me standardet ndërkombëtare janë edhe kërkesat e shtuara sa i përket qeverisjes korporative të bankave, të parapara me ndryshimet në Ligjin për banka, të cilat do të përpunohen në mënyrë shtesë me akt të veçantë nënligjor, i cili do të silllet nga Këshilli i Bankës popullore gjatë në vitin 2017. Përmes aplikimit të standardeve të përcaktuara në direktivën evropiane, në parimet e reja të Bazelit për qeverisjen korporative të bankave të korrikut të vitit 2015 dhe rekomandimet e Autoritetit bankar evropian, bëhet përforsimi i kërkesave që duhet të plotësohen nga anëtarët e bordit mbikëqyrës dhe bordit të drejtorëve, mënyra e emërimit të tyre, monitorimi i punës dhe shkarkimit, si dhe i rolit të anëtarëve të pavarur të bordit mbikëqyrës.

Grafik. 78  
Struktura e ndryshimeve vjetore të mjeteve vetanake




## 5.2. Lëvizjet dhe cilësia e mjeteve vetanake të sistemit bankar

Në vitin 2016, mjetet vetanake të sistemit bankar shënuan rritje vjetore prej 1,794 milionë denarë (ose 3.7%), e cila kryesisht rezulton nga fitimi i pashpërndara, i realizuar në vitin paraprak, në shumën prej 1.7 miliardë denarë. Në vitin 2016, raporti ndërmjet fitimeve të rriinvestuara në mjete vetanake dhe fitimit nga viti i kaluar është në nivel dukshëm më të ulët, krahasuar me vitet e mëparshme. Përkatësisht, disa nga bankat e ruajtën fitimin, por si të disponueshëm për shpërndarje tek aksionarët (e cila sipas rregullores nuk rrit mjetet vetanake të bankës), ndërkohë që disa nga bankat realizuan pagesë më të theksuar të dividendit për aksionarët e tyre.

Burimi tjetër i rëndësishëm i rritjes së mjeteve vetanake në vitin 2016 ishte emetimi i realizuar i aksioneve të reja të një bankë në tremujorin e tretë të vitit (në vlerë prej 739 milionë denarë), e cila ishte emetim i parë i aksioneve në tre vitet e fundit.

Grafik. 79

Struktura e mjeteve vetanake para zërave të zbritshëm nga kapitali themelor dhe ai shtesë Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Pjesëmarrja e kapitalit themelor, para zërave të zbritshëm të kapitalit themelor dhe atij shtesë, në mjetet vetanake të përgjithshme (gjithashtu para zërave zbritës nga kapitali themelor dhe ai shtesë) ishte e lartë dhe u përforcua më tej në vitin 2016, duke arritur nivelin prej 90.9% (89.8 % më 31.12.2015).

**Pavarësisht zvogëlimit të pashmangshëm të shumës së përgjithshme të detyrimeve të bankave bazuar në instrumentet e lëshuara të varura (për shkak të shlyerjes së parakohshme të një instrumenti të varur tek një bankë dhe përdorimit të instrumenteve të varura tek një bankë tjetër për mbulimin e humbjeve të grumbulluara nga vitet e mëparshme), në vitin 2016, vërehet një përmirësim domethënës në profilin e maturimit të këtyre instrumenteve.** Kështu, 69% e shumës së përgjithshme të detyrimeve bazuar në instrumentet e varura kanë një maturim të mbetur më të gjatë se pesë vjet (59.2% më 31.12.2015), i cili u mundëson bankave, në përputhje me rregullativën, përfshirjen e plotë të këtyre instrumenteve në llogaritjen e mjeteve vetanake. Megjithatë, duhet pasur parasysh se instrumentet e varura janë një nga burimet më të shtrenjta të financimit për bankat, pasi që ato përmbajnë një klauzolë vartësie<sup>69</sup>.

Më shumë detaje rreth nivelit të mjeteve vetanake të grupeve të veçanta të bankave janë paraqitur në aneksin nr. 38.


<sup>69</sup> Sipas klauzolës së vartësisë, në rast të falimentimit ose likuidimit të bankës, detyrimet e varura do të shpërndahen përpara shlyerjes së detyrimeve ndaj aksionerëve të bankës dhe zotëruesve të instrumenteve hibride, por pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tjerë.




Grafik. 80

Shuma dhe struktura e detyrimeve të përgjithshme të bankave bazuar në instrumentet e varura, sipas afatit të mbetur deri në maturim (majtas) dhe norma e shpenzimeve të interesit\*, për burimet të veçanta të financimit (djathtas)

Në milionë denarë



në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

\* Shënim: Norma e shpenzimeve të interesit është përlogaritur si raport midis shpenzimeve të interesit të realizuara gjatë vitit dhe shumës mesatare të burimeve të financimit, të llogaritura për pesë datat tremujore të fundit.

\*\* Detyrimet e përgjithshme të bankave për instrumente të varura janë shprehur në bazë të vlerës kontabël neto, nga bilanci i gjendjes.

**Një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat do të përballen bankat në periudhën e ardhshme është harmonizimi me kërkesat e kapitalit nga marrëveshja ndërkombëtare e Bazel 3 (si në raport me strukturën e re të mjeteve vetanake ashtu dhe në raport me kërkesën për mbajtje të një sasi të mjaftueshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit), të cilat zbatohen në rregullativën e brendshme nga marsi i vitit 2017<sup>70</sup>. Shuma dhe cilësia relativisht e lartë e mjeteve vetanake me të cilat disponojnë bankat, tregojnë një kapacitet të qëndrueshëm për harmonizim me kërkesat e reja të kapitalit.**


<sup>70</sup> Nga 31.03.2017, bankat kanë detyrim të mbajnë një shtresë mbrojtëse të kapitalit për ruajtjen e kapitalit në vlerë prej 2.5% të aktives së ponderuar sipas rrezikut. Gjithashtu, bankat që do të përcaktohen si të rëndësishme sistemore sipas llogaritjeve të bazuara në të dhënat e datës 31.12.2016 (dhe të njoftuara në mënyrë të rregullt jo më vonë se 30.04.2017) do të kenë detyrim të përbushin vëllimin e duhur të një shtrese mbrojtëse të kapitalit për bankat e rëndësishme sistemore deri më 31.03.2018, me çka, gjysmën e shtresës mbrojtëse të kërkuar duhet ta ndajnë që nga data 30.09.2017.

### 5.3. Lëvizjet dhe struktura e kërkesave të kapitalit dhe kapitali i lirë i sistemit bankar


Grafik. 81

Struktura e ndryshimeve vjetore (majtas) dhe gjendjes (djathtas) së mjeteve vetanake, sipas përdorimit për mbulim të rreziqeve të veçanta

Në milionë denarë



në përqindje




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Grafik. 82

Shuma dhe struktura e kërkesave për kapital për mbulimin e rrezikut kreditor, sipas kategorive të ekspozimit

Në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

**Në vitin 2016, kapitali rregullator i kërkuar për mbulimin e rreziqeve u rrit për 1,377 milionë denarë ose për 5.6%.** Pjesa më e madhe e rritjes së kërkesave për kapital për mbulimin e rreziqeve është si rezultat i shumës më të lartë të kapitalit rregullator të nevojshëm për mbulimin e rrezikut kreditor, që kryesisht rezulton nga rritja e portfolit të kredive të vogla. Në mënyrë të ngjashme si vitin paraprak, një pjesë e shumës së re të mjeteve vetanake nuk ishte e angazhuar dhe mbeti "e lirë", mbi nivelin e nevojshëm për të mbuluar rreziqet. Prandaj, mjetet vetanake mbi nivelin minimal e nevojshëm për të mbuluar rreziqet edhe më tej kanë pjesëmarrje të lartë në mjetet vetanake të përgjithshme, me rreth 48%. Në qoftë se merren parasysh vrojtimit e mbikëqyrësit (BPRM-së) për profilin e rrezikut të bankave të veçanta dhe të minimumit të mjaftueshmërisë së kapitalit të kërkuar, atëherë mjetet vetanake mbi nivelin minimal të kërkuar për mbulimi i rreziqeve të bankave marrin pjesë me rreth një të katërtën e mjeteve vetanake të përgjithshme.



Grafik. 83

Krahasimi i rezultateve të simulimeve të goditjeve kreditore dhe atyre të kombinuara Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

\*Stres-testimi përfshin simulimet e mëposhtme:

Simulimi I: Rritja e ekspozimit jofunksional kreditor ndaj subjekteve jofinanciare me 50%;

Simulimi II:: Rritja e ekspozimit jofunksional kreditor ndaj subjekteve jofinanciare me 80%;

Simulimi III:: Transferimi i 10% të ekspozimit të rregullt ndaj ekspozimit jofunksional kreditor ndaj subjekteve jofinanciare;

Simulimi IV:: Riklasifikimi në "V-jofunksional" të pesë ekspozimeve më të mëdha të kredive ndaj subjekteve jofinanciare (përfshirë edhe subjektet e lidhura me to);

Simulimi V:: Rritja e ekspozimit jofunksional kreditor ndaj subjekteve jofinanciare me 80% dhe rritja e normave të interesit nga 1 në 5 pikë përqindje;

Simulimi VI: Rritja e ekspozimit jofunksional kreditor ndaj subjekteve jofinanciare për 80%, zhvlerësimi i kursit të denarit për 30% dhe rritja e normave të interesit nga 1 deri në 5 pikë përqindje;

\*\*Shënim: Ekspozimi kreditor ndaj subjekteve jofinanciare përfshin ekspozimin e përgjithshëm kreditor, të zvogëluar nga ekspozimi i bankave ndaj institucioneve financiare dhe shtetit, gjegjësisht ndaj klientëve në veprimtari "aktivitetet financiare dhe aktivitetet e sigurimit" dhe "administrata publike dhe mbrojtje dhe sigurimi i detyrueshëm social".

Më shumë detaje për kërkesat e kapitalit për mbulimin e rreziqeve dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas grupeve të veçanta të bankave janë paraqitur në aneksin nr. 39.

#### 5.4. Stres-testimi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar ndaj goditjeve hipotetike


**Testimi i kryer i qëndrueshmërisë së sistemit bankar dhe bankave individuale në Republikën e Maqedonisë, ndaj goditjeve të simuluar për vitin 2016, në përgjithësi tregon një qëndrueshmëri më të mirë të bankave krahasuar me vitin 2015.**

Përmirësimi i rezultateve të simulimeve të stres-testit, gjatë një norme më të ulët fillestare të mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar në krahasim me vitin 2015, është kryesisht për shkak të shumës së zvogëluar të ekspozimit jofunksional kreditor (e cila shpesh është subjekt i "stresit", gjatë simulimeve të veçanta të stres-testit, e që rrjedh nga masa rregullore për shlyerje të detyrueshme të kredive jofunksionale të rezervuara në tërësi, më gjatë se dy vjet.

Grafik. 84

Përkeqësim i nevojshëm i cilësisë së ekspozimit kreditor në mënyrë që mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar të ulet në 8%

Në përqindje



Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat.

Goditjet hipotetike në anën e rrezikut kreditor kanë ndikim më të madh në stabilitetin e sistemit bankar. Në kuadër të ekspozimit kreditor ndaj subjekteve jofinanciare, simulimet tregojnë se nevojitet rritje prej 150% të ekspozimit jofunksional kreditor (për bankat individuale, rritja e nevojshme e ekspozimit jofunksional kreditor lëviz nga 55.3% deri në 2,858.1%), përkatësisht kalim në 12.1% nga ekspozimi i rregullt drejt ekspozimit jofunksional kreditor (për bankat individuale, rezultati lëviz në interval nga 5.2% në 23.7%), që mjaftueshmëria e kapitalit të sistemit bankar të ulet në minimumin ligjor prej 8% . Këto simulime do të çonin në një rritje të trefishtë të pjesëmarrjes së ekspozimit jofunksional kreditor në ekspozimin e përgjithshëm ndaj subjekteve jofinanciare (nga aktualja 5.6% në 16.1%).

### Analiza e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm të bankave

Marrëveshja ndërkombëtare e kapitalit Bazel 2 përcakton parimet themelore të menaxhimit të rrezikut dhe të kapitalit nga ana e bankave, të vendosura në të ashtuquajturat "tre shtylla". Shtylla e parë ofron një pasqyrë komplekse të përkufizimeve, proceseve dhe formulave për përlllogaritjen e kërkesave minimale të kapitalit rregullator kurse shtylla e tretë tregon shpalosjet që bankat duhet të bëjnë për të siguruar transparencë të plotë për investitorët dhe publikun e gjerë, e cila ndikon në përmirësimin dhe përforsimin e disiplinës së tregut.

Shtylla e dytë e Bazel 2 përshkruan proceset që duhet të zbatojnë bankat dhe rregullatorët për të përmbushur kërkesat për mjaftueshmëri të kapitalit. Bankat, ndër të tjera, duhet të tregojnë përmes procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm (ang. Internal Capital Adequacy Assessment Process - ICAAP), se kanë vendosur metoda dhe procedura, të nevojshme për të siguruar burimet e nevojshme kapitale për të mbuluar të gjitha rreziqet e rëndësisë materiale në punën e tyre. Nga ana tjetër, rregullatorët/mbikëqyrësit zbatojnë proces të vlerësimit dhe evaluimit mbikëqyrës (ang. Supervisory Review and Evaluation Process - SREP), ndër të tjera, për të vlerësuar saktësinë e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm dhe, nëse është e nevojshme, të ndërmarrin aktivitete të duhura.

Faza e parë e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm i referohet identifikimit të të gjitha rreziqeve materiale në të cilat banka është e ekspozuar gjatë operimit të saj, bazuar në kriteret e brendshme të përcaktuara. Në këtë mënyrë, me këtë proces plotësohet metodologjia për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit (ku janë të përshkruara rregullat për përcaktimin e kërkesave minimale për kapital për mbulim të rrezikut kreditor, rrezikut të tregut, rrezikut valutor dhe atij operacional) dhe zgjerohet fushëveprimi i llojeve të rrezikut, por edhe i aspekteve të tyre të veçanta (specifike) që bankat duhet të marrin parasysh në procesin e përgjithshëm të menaxhimit me rreziqet dhe kapitalin.





Pas përcaktimit të rreziqeve të rëndësishme materiale në funksionimin e bankës, vijon faza e matjes, matja e secilit rrezik veçmas. Në këtë rast, banka duhet të zhvillojë qasje të veta, më pak ose më shumë të avancuara, sasiore ose cilësore, për të matur rreziqet, të përshtatshëm me natyrën dhe madhësinë e bankës, profilin e saj të rrezikut dhe të karakteristikave të procesit të menaxhimit të riskut. Përveç kësaj, gjatë matjes së rrezikut, bankat gjithashtu duhet të marrin parasysh rezultatet e stres-testit të kryera bazuar në përkufizimin rregullator të rregullave të stres-testit. Përfundimisht nga detyrimi për të zhvilluar qasjet të tyre për të matur rreziqet paraqesin (aspektet e) rreziqet e përfshira në metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, për matjen e së cilave banka mund të përdor qasjen rregullatore të përcaktuar me këtë metodologji. Rezultatet e matjes së rreziqeve janë të shprehura në shumë të kapitalit të brendshëm të nevojshme për të mbuluar secilin prej rreziqeve materiale të identifikuar, të ndarë veçmas, ndërsa kapitali i përgjithshëm i brendshëm fitohet si shumë e kapitalit të brendshëm të nevojshëm për të mbuluar secilin rrezik material të veçantë. Rezultatet e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm, pas vlerësimit dhe evaluimit mbikëqyrës të kryer<sup>71</sup>, mund të udhëzojnë në nevojën për alokim të kërkesave më të larta për kapital, në krahasim me ato të përcaktuara në rregullore, për shkak të përzjerjes më të gjerë dhe më komplekse të rreziqeve që duhen merren parasysh<sup>72</sup>.

Banka është e detyruar për siguroj dhe të ruaj nivelin e mjeteve vetanake të përcaktuara në përputhje me procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm dhe të konfirmuar përmes procesit të vlerësimit mbikëqyrës. Në qoftë se niveli i mjeteve vetanake nuk përshtatet me nivelin e kapitalit të brendshëm të përcaktuar, banka duhet të zhvillojë një plan të kapitalit, me një horizont kohor prej së paku tre vjet, në të cilën ajo do të parashikojë aktivitetet që do të ndërmerren për të arritur dhe ruajtur nivelin e kërkuar të mjeteve vetanake (rikapitalizimi, zvogëlimi i vëllimit të aktiviteteve, ndryshime në politikën e dividendit, etj.).

Dispozitat e rregullativës me të cilën bankat në Republikën e Maqedonisë janë të detyruara të zbatojnë procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm janë në fuqi nga 01.01.2010<sup>73</sup>. Në përputhje me rregullativën aktuale<sup>74</sup>, ky proces kryhet një herë në vit dhe gjatë çdo ndryshimi të rëndësishëm në profilin e rrezikut të bankës. Më poshtë është dhënë pasqyrë e disa prej gjetjeve (rezultateve) themelore të procesit të kryer të përcaktimit të kapitalit të brendshëm për vitin 2016<sup>75</sup>.

Bankat kryejnë identifikimin e rreziqeve materiale, bazuar në kriteret sasiore dhe cilësore të mëposhtme: monitorim i sasisë së ekspozimit të bankës ndaj rreziqeve të caktuara (duke përfshirë edhe mundësinë për realizim të tyre dhe sasisë së humbjeve gjatë realizimit eventual të rrezikut), pjesëmarrje në aktivitete të caktuara në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme, monitorim të zbatimit të kufijve të përcaktuar ligjor dhe të brendshëm për rreziqet individuale, zbatimi i analizës së të dhënave për ngjarje të paparashikuara të ndodhura, humbja që kanë shkaktuar dhe reagimi i bankave ndaj tyre, analiza e aplikuar për teknika të caktuara për zbutje të rreziqeve dhe rezultateve nga zbatimi i tyre, mendimi i ekspertëve, realizimi i anketave dhe të ngjashme. Për vitin 2016, bankat identifikuan 13 rreziqe materiale në të cilat ata janë të ekspozuar gjatë funksionimit të tyre. Sidoqoftë, duhet të pasur parasysh faktin se ka dallime të theksuara midis bankave në kuptim të përkufizimit dhe mbulimit të rreziqeve të veçanta (atë që një bankë e identifikon si rrezik material të veçantë, një bankë tjetër e identifikon atë si një nga aspektet e ndonjë rreziku tjetër).

<sup>71</sup>Mbikëqyrësi mund të kërkojë nga banka të bëjë ndryshime në procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm dhe/ose të mbajë një nivel më të lartë të mjeteve vetanake nga niveli i përcaktuar përmes procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm, nëse konsideron që procesi i përcaktimit të kapitalit të brendshëm dhe kapitali i përgjithshëm i brendshëm i përlogaritur për mbulim të rrezikut nuk korrespondon me profilin e rrezikut të bankës dhe mjedisit të saj.

<sup>72</sup>Teorikisht, procesi i përcaktimit të kapitalit të brendshëm mund të adresojë edhe nevojën për alokim të kërkesave më të ulta të kapitalit nga minimumi i përcaktuar, nëse banka arrin të tregojë që ka arritur nivel të lartë të diversifikimit të rreziqeve. Megjithatë, sipas rregullativës aktuale, Banka popullore nuk do të njoh efektet e diversifikimit dhe ndërlikimit (korrelacionit) ndërmjet rreziqeve të caktuara, gjatë përcaktimit të kapitalit të përgjithshëm të brendshëm për të mbuluar rreziqet. Prandaj, niveli i kapitalit të përgjithshëm të brendshëm është të paktën i barabartë me kërkesat minimale rregullatore të kapitalit.

<sup>73</sup>Vendimi për menaxhim me rreziqet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/2008).

<sup>74</sup>Vendimi për menaxhim me rreziqet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/2008).

<sup>75</sup>Në analizë janë përfshirë 14 nga 15 banka ("BMPZH" SHA Shkup nuk i nënshtrohet detyrimit për të përcaktuar kapitalin e brendshëm, në përputhje me ligjin).



Bankat matin rreziqet që janë pjesë e metodologjisë së mjaftueshmërisë së kapitalit duke zbatuar qasjen rregullatore<sup>76</sup>, ndërsa për rreziqet e tjera materiale përdorin kryesisht metoda të thjeshta, të brendshme dhe metoda për kuantifikimin e rreziqeve. Dy banka aplikojnë modele të avancuara ekonometrike për të matur disa nga rreziqet e identifikuar materiale (konkretisht, rrezikun kreditor, rrezikun nga ndryshimi i normës së interesit në portofolin e aktiviteteve bankare dhe rreziqet nga mjedisi i jashtëm), dhe atë në pjesën e kryerjes së stres-testeve, rezultatet e së cilit, sipas rregullativës duhet të merren parasysh në procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm për rreziqet materiale të identifikuar (zakonisht, stres-testet përdoren si plotësim të metodave tashmë të vendosura për matje të rreziqeve). Duke pasur parasysh faktin se më shumë se 90% e kapitalit të brendshëm të përcaktuar bie nën rreziqet për matjen e së cilave përdoret qasje që përmbahet në aktet nënligjore të BPRM-së, shumat e planifikuara të aktives të ponderuar sipas rrezikut janë madhësi të rëndësishme të cilat ndikojnë në rezultatet e procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm (kapitali i brendshëm për mbulimin e rreziqeve të cilat maten duke zbatuar qasjen rregullatore të përshkruar nga metodologjia për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, përllogaritet si një përqindje e caktuar e shumës së aktives së ponderuar sipas rreziqeve të veçanta të cilat banka i planifikon për fundin e vitit<sup>77</sup>).

Tabela. 6

Kapitali i brendshëm i përcaktuar nga bankat, kërkesat shtesë të kapitalit të përcaktuara nga mbikëqyrësi (BPRM) dhe shtresat mbrojtëse të kapitalit \*, \*\*

Në shumë, numër dhe përqindje

	Vlera e kapitalit të brendshëm (në 000 denarë)	Në % nga gjithsej kapitali i brendshëm	Numri i bankave	Në % nga gjithsej APR që bankat e shfrytëzojnë në procesin e përcaktimit të kapitalit intern
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik kreditor</b>	26,956,717	77.2%	14	8.3%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik valutor</b>	667,474	1.9%	13	0.2%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik operativ</b>	2,952,470	8.5%	14	0.9%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik nga koncentrimi</b>	2,148,057	6.2%	8	0.7%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare</b>	1,196,399	3.4%	10	0.4%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik nga rrethimi a e jashtme</b>	424,201	1.2%	2	0.1%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik nga likuiditeti</b>	126,625	0.4%	3	0.04%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik të reputacionit</b>	43,387	0.1%	4	0.01%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik strategjik</b>	354,715	1.0%	7	0.1%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik të drejtshëm</b>	7,321	0.0%	2	0.002%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik të larjes së parave</b>	6,398	0.0%	1	0.002%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik të rregullatorit</b>	27,144	0.1%	2	0.01%
<b>Kapitali i brendshëm për rrezik nga konkurrenca</b>	1,626	0.0%	1	0.0005%
<b>Gjithsej kapitali i brendshëm:</b>	<b>34,912,533</b>	<b>100.0%</b>	<b>14 nga 15 banka</b>	<b>10.7%</b>
<b>Kërkesa kapitale shtesë të përcaktuara nga vlerësimi dhe evaluimi i supervizorit, mbi kapitalin e brendshëm të përcaktuar nga bankat</b>	4,475,305	12.8%	9	1.4%
<b>Shtresat mbrojtëse të kapitalit në vitin 2017 (për ruajtjen e kapitalit dhe gjysma nga kapitali mbrojtës i planifikuar për bankat e rëndësishme sistemore)***</b>	10,314,060	29.5%	14	3.2%

Burimi: BPRM, Burimi: Banka popullore, sipas të dhënave të dorëzuara nga bankat

\* Analiza përfshin 14 banka, përveç "BMPZh" SHA Shkup.

\*\* Më 31.12.2016, mjetet vetanake ishin 47,523,947 mijë denarë ndërsa norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 14.9%.

\*\*\* Nga 31.03.2017, bankat kanë detyrim të mbajnë një shtresë mbrojtëse të kapitalit për ruajtjen e kapitalit në vlerë prej 2.5% të aktives së ponderuar sipas rrezikut. Bankat që do të përcaktohen si të rëndësishme sistemore deri më 31.12.2016 (për të cilat do të njoftohen deri më 30.04.2017) kanë detyrimin që të ndajnë shtresën e kërkuar mbrojtëse të kapitalit për bankat me rendësi sistemore, në tërësi me përfundim të 31.03.2018. Megjithatë, bankat janë të detyruara që gjysmën e kësaj kërkesë për kapital të alokojnë deri më 30.09.2017. Shuma e shtresa mbrojtëse të kapitalit është llogaritur në bazë të vlerës së aktivitetit të ponderuar sipas rrezikut, të cilat bankat e kanë përdorur në procesin e përcaktimit të kapitalit të brendshëm për vitin 2016.

<sup>76</sup>Një bankë zbaton qasje të brendshme për matjen e rreziqeve të përfshira në metodologjinë e mjaftueshmërisë së kapitalit (më saktësisht vetëm për një nga rreziqet), por ato tregojnë një nivel më të ulët të kapitalit të brendshëm nga ai i përcaktuar me zbatimin e qasjeve rregullatore për kuantifikim të këtyre rreziqeve. Prandaj, banka ka detyrim për përcaktim kapitalin e brendshëm për të mbuluar këto rreziqe në nivel të kërkesave rregullatore të kapitalit.

<sup>77</sup>Duhet pasur parasysh se gjatë zbatimit të procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm për vitin 2016, disa banka nuk përdorin shumë të planifikuar të aktives së ponderuar sipas rrezikut, por të dhënë të fundit të disponueshme në momentin e zbatimit të procesit.



Sipas rezultateve të procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm të zbatuar nga secila bankë veçmas, norma e nevojshme e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar për vitin 2016 është 10.7%, e që është gati 3 pikë përqindje më e lartë se minimumi rregullator (prej 8%). Mbi 77% e kapitalit të brendshëm të përcaktuar është i nevojshëm për të mbuluar rrezikun kreditor.

Vlerësimi mbikëqyrës i kryer i procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm vë në pah disa dobësi dhe mospërputhje në fazat e veçanta të këtij procesi, tek disa banka. Kështu, në përputhje me vlerësimin e mbikëqyrës (BPRM), nëntë banka duhet të kenë në dispozicion kapital pak më të lartë nga ai i përlogaritur përgjatë procesit të përcaktimit të kapitalit të brendshëm, ndërsa në të agreguar, norma e nevojshme e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar është 12.1%. Gjithashtu, në një bankë kapitali i nevojshëm të cilin e ka përcaktuar mbikëqyrësi është në një nivel që është më i lartë se mjetet vetanake në dispozicion me gjendjen më 31.12.2016. Bankat me mungesë të vazhdueshme të mjeteve vetanake janë të detyruara të përgatisin një plan të kapitalit, me horizont kohor prej së paku tre vjet, në të cilin do të parashikojnë aktivitetet që do të duhet të ndërmerren për të arritur dhe ruajtur mjetet vetanake në nivel më të lartë se minimumi i kërkuar. Gjithashtu, sfidë e rëndësishme për bankat në periudhën e ardhshme paraqet edhe futja e kërkesave të kapitalit nga marrëveshja ndërkombëtare Bazel 3, në rregullativën vendore, që do të fillojnë të aplikohen nga viti 2017 (në vitin 2017 bankat do të jetë të detyruara të mbajnë shtresë mbrojtëse të kapitalit për ruajtjen e kapitalit dhe shtresë të veçantë mbrojtëse të kapitalit do të duhet të ndajnë edhe bankat e rëndësishme sistemore). Kështu, analizuar në veçanti për secilën bankë, në qoftë se merren parasysh shtresat mbrojtëse të kapitalit që bankat do të duhet të ndajnë gjatë vitit 2017<sup>78</sup>, norma e nevojshme e mjaftueshmërisë së kapitalit për vitin 2017, për secilën bankë veçmas, lëviz në intervalin nga 12.6% deri në 20%. Aktualisht, me 31.12.2016, tek pesë banka, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit është nën minimumin e kërkuar duke marrë parasysh shtresat mbrojtëse të kapitalit, dhe ata në periudhën e ardhshme do të duhet të ndërmarrin aktivitete për arritjen e nivelit të duhur të mjaftueshmërisë së kapitalit. Deri atëherë, sipas rregullativës (Vendimi mbi metodologjinë për përcaktimin e shumës maksimale për shpërndarje të rezultatit nga operimi<sup>79</sup>), këto banka do të kenë kufizime në shumën e fitimit (për vitin 2016) që ata mund t'ua ndajnë aksionarëve të tyre dhe rrjedhimisht në politikën e bankave për ndarjen e dividendit.

<sup>78</sup>Nga 31.03.2017, bankat kanë detyrim të mbajnë shtresë mbrojtëse të kapitalit për ruajtjen e kapitalit deri në vlerë prej 2.5% të aktives së ponderuara sipas rrezikut. Bankat të cilat do të përcaktohen si të rëndësishme sistemore deri më 31.12.2016 (për të cilat do të njoftohen jo më vonë se 30.04.2017), kanë detyrimin që të ndajnë shtresën e kërkuar mbrojtëse të kapitalit për bankat me rendësi sistemore, deri më 31.03.2018. Megjithatë, gjysma e kësaj kërkesë për kapital bankat duhet ta alokojnë deri më 30.09.2017.

<sup>79</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17.

### **III. Ndryshime të dalluara bilancore dhe profitabiliteti i sistemit bankar**



## 1. Aktivitetet e bankave

Në vitin 2016, në veçanti gjatë pjesës së parë të vitit, aktivitete e sistemit bankar të vendit zhvilloheshin në trysinë e shprehur të gjendjes jostabël politike në vend, e shoqëruar kjo edhe nga spekulimet mbi stabilitetin e kursit të këmbimit të denarit si dhe spekulimet rreth stabilitetit të vetë bankave në vend dhe depozitave të bëra në to. Kjo rezultoi me lëkundje të besimit të publikut ( në veçanti të ekonomive familjare) si dhe tërheqje të depozitave nga ana e ekonomive familjare, gjatë muajve prill dhe maj të vitit 2016. Në rrethana të tilla, bankat menaxhuan me sukses të jashtëzakonshëm likuiditetin dhe pa pengesa arritën ti realizojnë të gjitha kërkesat për tërheqje të depozitave. Banka Popullore reagoi duke intervenuar në tregun valutor (për shkak të kërkesës së rritur për deviza), por gjithashtu bëri edhe ashpërsim të politikës monetare, përmes zmadhimit të normave të interesit të shënimeve të thesarit, dhe të normës së rezervës së obligueshme për obligimet e bankave në denarë me klauzolë devizore. Krahas kësaj, u bë riaktivizimi i aukcioneve të depozitave devizore të BPRM, edhe atë me kushte kontraktuese më të volitshme (normë interesi), me çka bankave u bë më e arsyeshme ruajtja e mjeteve likuide devizore në vend krahasuar me jashtë, mjete këto që në baza të tilla shënuan rritje. Sinjalet e para për stabilizim gradual të gjendjeve dhe qëndrimeve të subjekteve ekonomike u vërejtën në tremujorin e tretë të vitit 2016, përmes lëvizjeve pozitive në tregun valutor dhe zhvendosjes së lartë të bazës depozituese të bankave, dhe asaj që është me rëndësi të veçantë depozitave të familjeve. Rritja e depozitave shënoi përshpejtim edhe në tremujorin e katërt të vitit, me çka potenciali depozitues i bankave shënoi rritje solide vjetore, ndonëse me një intensitet më të ngadaltë në krahasim me fundin e vitit 2015 dhe gati në tërësi ishte shkaktuar nga zmadhimi i depozitave në shikim. Rritja e depozitave në masë më të madhe u kushtëzuar nga rritja e depozitave nga organizatat jofinanciare, ndonëse një kontribut të veçantë kanë dhënë edhe familjet, ndërsa rritja vjetore më intensive e depozitave devizore në krahasim me tempon e zmadhimit të depozitave në denarë e ndërpreu procesin e denarizimit të depozitave, proces ky që ishte mjaft prezent gjatë viteve paraprake.

Ndryshimet në nivelet e kredive të bilancet e bankave në masë të madhe u shkaktuan nga ndryshimet në rregullativën e Bankës Popullore për transfer të obligueshëm të kërkesave që janë tërësisht të rezervuara për më shumë se dy vite në evidencën jashtëbilancore të bankave. Efektet e ndryshimeve të tilla në rregullativë në mënyrë më të ndejshme u vërejtën në tremujorin e dytë të vitit, ndërsa më pas vërehet dhe shterim gradual i efekteve në fjalë. Poqëse bëhet shpërfillja e efekteve nga ndryshimet e lartpërmendura në rregullativë, në atë rast vërehet ngadalësim i rritjes vjetore të aktivitetit kreditues të bankave, andaj shkalla e realizuar e rritjes në fund të vitit 2016 është dukshëm më e ulët me shkallën e realizuar në vitin paraprak. Bankat edhe më tutje vazhdojnë që vëmendjen e tyre ta përqendrojnë në zmadhimin e përkrahjes kreditore të sektorit “familje” në valutë vendore, që ishte edhe fuqia kryesore lëvizëse e rritjes vjetore të aktivitetit kreditues të bankave.


Aty, nga fundi i vitit 2016 dhe fillimi i vitit 2017, Banka Popullore tre herë radhazi e zvogëloi normën e interesit të shënimeve të thesarit, me çka norma e interesit përfundimisht u kthye në nivelin që pati në fillim të vitit, përkatësisht në

**3.25%.** Krahas kësaj, që nga Tetori i vitit 2016 Banka Popullore ndërpreu praktikën e aukcioneve të depozitave devizore. Vendimet e tilla të Bankës Popullore për normalizim të politikës monetare janë rezultat i stabilizimit gradual të pritjeve të subjekteve ekonomike, pas masave paraprakisht të ndërmarra për ballafaqim me trysnitë nga pasiguria e ambientit politik, në kushte të ruajtjes së mëtutjeshme të vlerësimeve për stabilitetin e bazamentit ekonomik. Megjithatë, prezenca e vazhdueshme e jostabilitetit politik në vend paraqet një faktor të rëndësishëm risku me të cilin bankat do të vazhdojnë të ballafaqohen edhe në periudhën e ardhshme.

Grafik. 85

Ndryshim absolut vjetor i komponentëve të aktivës (majtas) dhe të pasivës (djathtas) së sektorit bankar

Në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Shënim: Kreditë janë të paraqitura në bazë neto, të zvogëluara për korrigjim të vlerës

Grafik. 86

Ndryshimi vjetorë i aktivës së sistemit bankar

Në milionë denarë dhe në përlind




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Më 31.12.2016 totali i aktivitetit të sistemit bankar ishte 444.680 milionë denarë duke shënuar rritje prej 21.013 milionë denarë, përkatësisht 5%.** Kjo rritje në masë më të madhe rezultoi nga zmadhimi i aktivitetit kreditues të subjekteve jo afariste dhe plasmanet e depozitave devizore në BPRM. Rritja e aktivitetit të përgjithshëm të sistemit bankar shënoi ngadalësim në krahasim me vitin 2015, që kryesisht ishte refleksion i rritjes së ngadalësuar vjetore të bazës depozituese, për shkak të tërheqjes së depozitave në tremujorin e dytë të vitit 2016.




**Grafik. 87**  
Struktura e aktivës (majtas) dhe pasivës (djathtas) të sistemit bankar  
Në përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Krahasuar me pjesën më të madhe të vendeve anëtare të UE, ndërmjetësimi financiar në Republikën e Maqedonisë është në një nivel më të ulët, ndonëse ka nivel të ngjashëm me shtetet tjera të regjionit. **Në vitin 2016 është shënuar ulje e rolit të përgjithshëm të sistemit bankar në cilësinë e ndërmjetësuesit financiar.**


**Grafik. 88**  
Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Republikën e Maqedonisë dhe vendet e UE dhe regjionit  
Në përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat, faqet zyrtare të FMN-së, BQE dhe bankave qendrore.


Shënim: Të dhënat kanë të bëjnë me muajin Dhjetor të vitit 2015, Me përjashtim të Maqedonisë (Dhjetor i vitit 2016) dhe Serbisë (Qershor i vitit 2015).

Grafik. 89  
Kredi të subjekteve jofinanciare  
Në milionë denarë



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik. 90  
Ndryshimi vjetor i kredive të subjekteve jofinanciare  
Në milionë denarë dhe përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

## 1.1 Kredi të subjekteve jofinanciare

Në vitin 2016, në kushte të jostabilitetit politik, e ndjekur nga spekulimet mbi stabilitetin e sektorit bankar, kreditimi i personave jofinanciar<sup>80</sup> shënoi rritje, por me një tempo më të ngadalësuar. Rritja e aktivitetit kreditues së bankave ndaj sektorit jofinanciar në vitin 2016 ishte 16.691 milionë denarë respektivisht 6.0%, që paraqet ngadalësim prej 3.7 pikë përqindje në krahasim me rritjen e shënuar në vitin 2015. Në Dhjetor të vitit 2015, Banka Popullore bëri ndryshim të kornizës ekzistuese rregulluese<sup>81</sup>, me çka më së voni deti më 30. Qershor. 2016 bankat kishin obligim që të fillojnë me transferimin e të gjitha kërkesave që janë tërësisht të rezervuara për më shumë se dy vite në evidencën jashtëbilancore. Ndryshimet në fjalë ndikuan mbi treguesit bilancore për rritjen e kreditimit. Gjatë vitit 2016 u bë çregjistrimi i gjithsej 13.262 milionë denarë<sup>82</sup>. Efektet më fuqishëm (përkatesisht 84% i shumës në fjalë) u ndjenë në tremujorin e dytë të vitit, me atë që deri në fund të vitit u shënuar shterim gradual i ndryshimit përkatës në rregullativë. **Andaj, duke i pasur parasysh efektet nga çregjistrimet e realizuara, rritja vjetore e kreditimit të subjekteve jofinanciare ishte 3.429 milionë denarë, përkatësisht 1.2%.**

<sup>80</sup> Kreditë ndaj subjekteve financiare i përfshinë kreditë e personave jofinanciar-residentë dhe joresidentë, edhe atë kreditë e shoqërive private dhe publike jofinanciare, pushtetit qendrorë, vetëqeverisjes lokale, institucionet jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për familje (kredi për klientë të tretë), personat që realizojnë aktivitete në mënyrë të pavarur dhe personat fizik (kredi për familjet).

<sup>81</sup> Vendim për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për menaxhim me rrezikun kreditor ("GZ e RM" nr.223/15).

<sup>82</sup> Nga shuma në fjalë, 10.185 milionë denarë kanë të bëjnë me çregjistrim të kredive tërësisht të rezervuara të shoqërive jofinanciare, ndërsa pjesa tjetër prej 3.077 milionë denarë paraqet shumën e kredive të çregjistruara të amvisërive.






Grafik. 91

Analiza krahasimore e lëvizjeve të kredive bruto të subjekteve jofinanciare, shoqërive jofinanciare dhe familjeve (majtas) dhe kredive jofunkionale të subjekteve jofinanciare, shoqërive jofinanciare dhe familjeve (djathtas) me dhe pa efektet e çregjistrimeve

Në milionë denarë dhe në përlind




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Grafik. 92

Struktura e kredive të familjeve, sipas produkteve

Në përlind




Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Rritja e kredive gati në tërësi rezultoi nga zmadhimi i përkrahjes kreditore të bankave për familjet, në kushte të ngadalësimit të shprehur të kreditimit të korporatave..** Në fakt, gjatë vitit 2016, kreditë për familjet shënuan rritje prej 11% (ngadalësim prej 2.4 pikë përqindje në krahasim me vitin paraprak), ndërsa kreditë e shoqërive jofinanciare u zmadhuan për 2.6% (7.1% në vitin 2015). Efektet nga çregjistrimet e detyrueshme, në masë më të madhe u ndien te kreditë e sektorit korporativ, andaj në qoftë se në analizë kyçet efekti i tyre, në atë rast vërehet zvogëlim i kredive për sektorin korporativ gjatë vitit 2016, edhe atë për 3.8%.

Grafik. 93

Kontributi i komponentëve të veçantë në rritjen vjetore të totalit të kredive të subjekteve jofinanciare.

Në përlind




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Kreditë në denarë, edhe më tutje luajnë rol qendrorë në strukturën valutore të totalit të kredive.** Në vitin 2016 është shënuar rritje e kredive në denarë, në kushte të një zvogëlimi gati të barabartë të kredive në valuta të huaja. Rritja e kredive në denarë ishte më e shprehur te kreditë për familjet<sup>83</sup> në krahasim me shoqëritë jofinanciare, ndërsa rënia e shënuar te kreditë në valutë të huaj gati në tërësi rezulton nga rënia e kredive të shoqërive jofinanciare.<sup>84</sup> Kreditë në denarë me klauzolë devizore shënuan rritje vjetore prej 3.759 milionë denarë (ose 5.2%), që në pjesën më të madhe rezultoi nga kreditë për familjet.

Grafik. 94

Struktura e totalit të kredive, sipas sektorit (majtas) valutës (në mes), dhe të kredive të rregullta sipas afatizimit të maturimit (djathtas)

Në përlind



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.


Analiza e ndryshimeve në strukturën e kredive në vitin 2016, sipas karakteristikave valutore dhe sipas afatizimit të maturimit, pjesërisht është pamundësuar nga mungesa e të dhënave për strukturën e çregjistrimeve në bazë të rregullativës së re sipas valutës dhe sipas afatit të maturimit. Në fakt, Banka popullore disponon me të dhëna vetëm për strukturën sektoriale të çregjistrimeve të realizuara (familje dhe persona juridik jofinanciar).

<sup>83</sup> Kreditë në denarë për familjet kanë shënuar rritje në bazë vjetore për 5.394 milionë denarë (ose për 8.7%), ndërsa rritja vjetore e kredive për shoqëritë jofinanciare është 805 milionë denarë (respektivisht 0.9%).

<sup>84</sup> Kreditë valutore për shoqëritë jofinanciare në bazë vjetore kanë shënuar rënie prej 6.943 milionë denarë (14.0%).




**Grafik. 95**  
Ndryshime vjetore te kreditë, sipas sektorit, valutës dhe afatizimit të maturimit  
Në milionë denarë dhe në përlind



**Burimi:** Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.  
Analiza e ndryshimeve në strukturën e kredive në vitin 2016, sipas karakteristikave valutorë dhe sipas afatizimit të maturimit, pjesërisht është pamundësuar nga mungesa e të dhënave për strukturën e çregjistrimeve në bazë të rregullativës së re sipas valutës dhe sipas afatit të maturimit. Në fakt, Banka Popullore disponon me të dhëna vetëm për strukturën sektoriale të çregjistrimeve të realizuara (familje dhe persona juridik jofinanciar).

**Shikuar sipas afatizimit të maturimit, kreditimi afatgjatë edhe më tutje mbetet faktori më i rëndësishëm në rritjen e aktivitetit kreditues, më atë që në vitin 2016 u shënua rritje e kontributit të njëjtës. Në rastin konkret, afro 78% e rritjes së kredive afatgjata rezultojnë nga sektori "familje"<sup>85</sup>.**

**Grafik. 96**  
Ndryshime vjetore te depozitat e subjekteve jofinanciare  
Në milionë denarë dhe në përlind




**Burimi:** Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

### 1.2. Depozite të subjekteve jofinanciare

Intensifikimi i konflikteve politike në vend, i ndjekur nga dyshimet publikisht të shprehura në stabilitetin e depozitave të bankat, në kushte të normave jashtëzakonisht të ulëta të interesit të depozitave, rezultoi me tërheqje të depozitave nga bankat, tërheqje këto që kryesisht ndodhën gjatë muajve prill dhe maj, të vitit 2016. Nga ana tjetër, kjo rezultoi me **ngadalësim të rritjes vjetore të totalit të depozitave të bankat në vitin 2016.**


<sup>85</sup>Kreditë afatgjatë për familjet në vitin 2016 shënuan rritje për 12.147 milionë denarë, rritje kjo që në masë më të madhe rezultoi nga rritja e kredive afatgjatë në denarë për familjet (për 7.089 milionë denarë), ndërsa në masë më të vogël edhe nga rritja e kredive afatgjatë në denarë me klauzolë valutorë për familjet (për 4.380 milionë denarë).

**Grafik. 97**  
Depozite të subjekteve jofinanciare  
Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Grafik. 98**  
Kontributi i komponentëve të veçantë në rritjen vjetore të totalit të depozitave të subjekteve jofinanciare  
Në përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Bankat pa kurrfarë pengesa i realizuan të gjitha kërkesat për tërheqje të depozitave, që kontribuoi që për një kohë relativisht të shkurtë të humbet "mosbesimi" i publikuat, andaj që në tremujorin e radhës, u shënuar një stabilizim i gjendjes. Në fakt, depozitat filluan të shënojnë rritje të serishme (ndonëse kryesisht bëhet fjalë për depozite në shikim), ndërsa nga fundi i vitit 2016 totali i tyre u përafërua ndaj trendit afatgjatë..

Shikuar në bazë vjetore, baza totale depozituese e bankave është për 16.607 milionë denarë më e madhe, pra për 5.4% që paraqet ngadalësim në krahasim me rritjen e shënuar në vitin 2015 për 1.3 pikë përqindje përkatësisht për 2.604 milionë denarë. Depozitat edhe më tutje mbetën burimi kryesorë i financimit të aktiviteteve bankare (me pjesëmarrje prej 72.6% në totalin e aktivitet, që është një nivel gati identik me atë të shënuar në fund të vitit 2015). Dinamika vjetore e bazës depozitare të bankave në masë më të madhe (61.3%) u përcaktua nga **depozitat e shoqërive jofinanciare**, rritja e të cilëve (për 10.183 milionë denarë ose 12.7%<sup>86</sup>) ishte dyfish më e madhe se rritja vjetore e **depozitave të familjeve** (5.667 milionë denarë ose 2.6%<sup>87</sup>). Megjithatë, edhe pranë kësaj, depozitat e familjeve mbetën burimi kryesorë u financimit të sektorit bankar vendor, me pjesëmarrje prej 68.5% në totalin e depozitave (70.4% më 31.12.2015).


<sup>86</sup> 13,3% në vitin 2015.

<sup>87</sup> 4,3% në vitin 2015.



Grafik. 99

Krahasim i lëvizjeve të totalit të depozitave të subjekteve jofinanciare, depozitave të familjeve dhe depozitave të shoqërive jofinanciare me mesataret lineare dhe dinamike Në milionë denarë




Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Luhajtja e besimit të publikut ndaj bankave në tremujorin e dytë të vitit, krahas tërheqjes së depozitave, erdhi në shprehje edhe përmes mosbesimit në stabilitetin e valutës vendore dhe paralelisht me këtë edhe zmadhimit të kërkesës për deviza (efektivë ose depozite devizore). Kjo shkaktoi ndërprerje të kontinuitetit të denarizimit permanent të denarizimit të depozitave të bankave që vërehej gjatë viteve të kaluara. Norma vjetore e rritjes së depozitave në denarë gatise u përgjysmua në krahasim me vitin paraprak dhe**

Grafik. 100

Struktura e totalit të depozitave, sipas sektorit, valutës dhe afatizimit të maturimit Në përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.


është njëherit më e ulët në krahasim me normën e rritjes së depozitave devizore, e cila shënoi

përsheptim në vitin 2016. Kjo shkaktoi zvogëlim të pjesëmarrjes së depozitave në denarë në totalin e depozitave, nga 57.6% në vitin 2015 në 56.9%<sup>88</sup> në fund të vitit 2016. Në vitin 2016, rritja e depozitave në denarë (që ishte rreth 4.1%<sup>89</sup>), në masë më të madhe u shkaktua nga rritja e depozitave korporative<sup>90</sup>. Depozitat në denarë të familjeve u zmadhuan për vetëm 0.7% që paraqet në ngadalësim të shumëfishtë, në krahasim me vitin paraprak, kur rritja ishte në shkallë prej 14%. Depozitat në denarë me klauzolë devizore si zakonisht kanë një pjesëmarrje të ulët në bazën e përgjithshme depozitare, me atë që interesi për to më i shprehur është te sektori korporativ, i cili për shkak të regjimit valutor nuk mundet të blejë valuta poqëse të njëjtat nuk janë të dedikuara për pagesë ndaj jashtë. Kështu, si masë preventive nga intensifikimi eventual i rritjes së depozitave me klauzolë devizore (para së gjithash nga shoqëritë jofinanciare), në maj të vitit 2016, Banka Popullore bëri zmadhimin e rezervës së obligueshme për obligime në denarë me klauzolë devizore të bankave nga 20% në 50%<sup>91</sup>.

Grafik. 101

Ndryshime vjetore të depozitave, sipas sektorit, sipas valutës dhe sipas afatizimit të maturimit

Në milionë denarë dhe në përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

Rritja vjetore e depozitave devizore (7.6%<sup>92</sup>) shënoi përsheptim, me atë që depozitat devizore të familjeve kishin një pjesëmarrje pak më të lartë (49.6%) në krahasim me kontributin e

<sup>88</sup> Në totalin e depozitave në denarë, depozitat e familjeve participojnë me 61.3% (63.4% më 31.12.2015).

<sup>89</sup> 7.4% në vitin 2015.

<sup>90</sup> 11.2% në vitin 2016 dhe 12.6% në vitin 2015.


<sup>91</sup> Vendim për rezervën e obligueshme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 87/16 dhe 218/16).

<sup>92</sup> 6.2% në vitin 2015



sektorit korporativ (41.6%). Banka Popullore reagoi ndaj kërkesës së zmadhuar për deviza përmes reagimit në tregun valutor dhe përmes zmadhimit të normës bazë të interesit nga 3.25% në 4%, ndërsa në maj të vitit 2016 bëri riaktivizimin e ankandëve të depozitave valutore në Bankën popullore (si instrument atraktiv për orientim të likuiditetit të lirë valutor të bankave).

Grafik. 102  
Struktura e depozitave të familjeve sipas afatizimit të maturimit  
Në përlind



Burimi: Banka popullore, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

**Ndërprerja e procesit të denarizimit të bazës depozitare u ndjek edhe më një shkurtrim të afatizimit të saj, që mundet të reflektojë edhe nga pasiguria politike në vend dhe nga mosbesimi i publikut.** Edhe në vitin 2016 vazhdoi zvogëlimi i kredive afatshkurtra, ndërsa rritje më të madhe shënuan depozitat sipas shikimit, norma vjetore e rritjes së të (13.7%<sup>93</sup>) është trefish më e lartë në krahasim me normën e rritjes së depozitave afatgjata. Ndonëse e pazakontë, por në rritjen e depozitave në shikim<sup>94</sup>, familjet kishin kontribut më të madh (55.6%) në krahasim me kontributin e sektorit korporativ (39.2%). Rritja vjetore e depozitave afatgjata (4.5%<sup>95</sup>), në masë më të madhe (përkatesisht 65%) është shkaktuar nga depozitat devizore të familjeve.

Transformimi valutorë dhe sipas afatizimit të maturimit, ndonëse kontribuon në uljen e kostove në bazë të normave të interesit në bilancin e bankave, megjithatë shkakton komplikim të menaxhimit të riskut të likuiditetit dhe imponon nevojën për një kujdes më të madh, respektivisht për rritje të shumave më të mëdha të mjeteve likuide, në bazë të cilave nga ana tjetër realizon të ardhura më të ulëta.


<sup>93</sup> 21.3% në vitin 2015

<sup>94</sup> Rritja vjetore e depozitave të familjeve në shikim në masë më të madhe (53.3%) u përcaktua nga depozitat valutore ndërsa në masë më të vogël (46.7%) nga depozitat në denarë. Rritja vjetore e depozitave të shoqërive jofinanciare në shikim në masë më të madhe (64.4%) ishte shkaktuar nga depozitat në denarë ndërsa në masë më të vogël (35.6%) të depozitave valutore.

<sup>95</sup> 4.6% në vitin 2015

Grafik. 103


Struktura (lartë) dhe ndryshimi vjetorë (poshtë) i portfolios së letrave me vlerë dhe investimet në shoqëri të asociuara  
Në përlind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Grafik. 104

Struktura e investimeve të bankave në letra me vlerë sipas afatizimit të maturimit  
Në përlind



Burimi: BPRM, bazuar në të dhënat e dorëzuara nga bankat.

### 1.3. Aktivitete tjera

Në fund të vitit 2016 **investimet e bankave në letra me vlerë**<sup>96</sup> janë më të ulëta për 6.033 milionë denarë (përkatësisht për 9.6%) në krahasim me fundin e vitit 2015, ndërsa pjesëmarrja e tyre e përgjithshme në aktivin e bankare rra në 12.8% (nga 14.9% në fund të vitit 2015). Kjo është pasojë e zvogëlimit të plasmanit të bankave në letra vendore me vlerë. Zvogëlimi më intensiv i investimeve të bankave në bono vendore (që është më e shprehur te bonot trevjeçare) në lartësi prej 4.891 milionë denarë (ose 38.7%) kishte kontribut më të shprehur në zvogëlimin e portfolit të përgjithshëm të letrave me vlerë.

Rënie është shënuar edhe te investimet e bankave në shënime thesari, edhe atë për 2.071 milionë denarë (8.3%). Krahas kësaj, investimet në shënime shtetërore shënuan rritje në bazë vjetore (për 920 milionë denarë, ose 3.9%). Në kushte të mungesës së alternativave për investime, karakteristikë bazë e portfolit të letrave me vlerë edhe më tutje mbetet mungesa e diversifikimit si dhe dominimi i letrave me vlerë të publikuara nga Republika e Maqedonisë dhe të shënimeve të thesarit.

**Në vitin 2016 u shënuar zvogëlim minimal i plasmaneve te bankat dhe institucione tjera financiare** (për 315 milionë denarë, përkatësisht për 0.6%), që në masë më të madhe rezulton nga zvogëlimi i kredive të bankave vendore, edhe atë në afate të gjata me periudhë maturimi mbi dy vite, në valutë të huaj. Një zvogëlim jo i konsiderueshëm është shënuar edhe te saldot e llogarive rrjedhëse në valutë të huaj në banka të huaja.

<sup>96</sup> Përfshirë edhe investimet në shoqëri të asociuara.


Investimet e bankave në letra të huaja me vlerë përfshijnë nivelin prej 1.2% të totalit të investimeve të bankave në letra me vlerë.





Grafik. 105

Ndryshime vjetorë i plasmanëve të institucionet financiare (majtas), obligimet në bazë të kredive (në mes) dhe të depozitave të shoqërive financiare (djathtas)  
Në përqindje




Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Në suaza të pasivit, **obligimet për kredi** u zvogëluan (për 1.185 milionë denarë, përkatësisht për 3.2%), që në masë më të madhe rezulton nga zvogëlimi i obligimeve në bazë të huazimit afatgjatë ndërbankar në valutë të huaj (pagesë e borxheve të bankave vendore ndaj "BMPZh" Sh.A, Shkup). Nga ana tjetër, pagesa e borxheve nga ana e "BMPZH" Sh.A, Shkup ndaj jorezidentëve reflektoi me zvogëlim të obligimeve në bazë të kredive ndaj jorezidentëve (kredi afatgjata në valutë të huaj ndaj jorezidentëve 0-shoqëri financiare).

Grafik. 106

Obligime (majtas) ndaj dhe kërkesa (djathtas) nga joresidentët  
Në milionë denarë dhe në përlind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Në vitin 2016, depozitat e bankave dhe institucioneve tjera financiare** shënuan rritje në krahasim me vitin paraprak, e që ishte kushtëzuar nga llogaritë transakionale të bankave të huaja në denarë (përkatësisht akumulim i mjeteve në denarë në llogari

jorezidente të bankës së huaj me qëllim të pagesës së dividendit) si dhe nga depozitat afatshkurta të shoqërive financiare-rezidente (përkatësisht depozite deri njëvjeçare në denarë). Një rritje e caktuar u shënuar edhe te depozitat afatgjate në fondet pensionale.


**Ngjashëm si në vitet paraprake, edhe në vitin 2016 bankat në Republikën e Maqedonisë aktivitetet e tyre kryesisht i realizojnë në tregun vendor.** Kërkesat nga , dhe obligimet ndaj jorezidentëve, janë në nivel të ulët, ndërsa në vitin 2016 është shënuar edhe zvogëlim i mëtejshëm i kërkesave nga jorezidentët (për 411 milionë denarë ose 1.1%). Nga ana tjetër, obligimet ndaj jorezidentëve kanë shënuar rritje për 519 milionë denarë (përkatësisht për 1.4%). Plasmanet e bankave vendore te jorezidentët janë zakonisht në formë të mjeteve likuide (respektivisht llogari koresponduese ose depozite afatshkurta) në banka të huaja, përderisa pjesa më e madhe e obligimeve të bankave ndaj jorezidentëve janë në formë të kredive afatgjata (kryesisht të "BMPZH" Sh.A, Shkup ndaj institucioneve ndërkombëtare financiare). Në vazhdimësi obligimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve janë më të mëdha se kërkesat nga to, ndonëse në vitin 2016 është shënuar një përafrim i vlerave të obligimeve ndaj jorezidentëve dhe kërkesave nga jorezidentët. Në përputhshmëri me këtë është shënuar edhe përafrim i pjesëmarrjes së kërkesave dhe obligimeve të bankave nga/drejt jorezidentëve në totalin e mjeteve/obligimeve (8.1% dhe 8.3% përkatësisht)<sup>97</sup>.

<sup>97</sup> Analizuar sipas bankave të veçanta, pjesëmarrja e kërkesave të bankave nga joresidentët në totalin e aktivitetit lëviz në interval nga 0.5% deri në 17.6%, përderisa pjesëmarrja e obligimeve të bankave ndaj joresidentëve në totalin e pasivitetit lëviz në interval nga 0.1% deri në 15.2%. "BMPZH" Sh.a, Shkup nuk është e përfshirë në këtë analizë.



Grafik. 107

Obligime të bankave ndaj personave amë  
Në milionë denarë dhe në përlind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Shfrytëzimi i mjeteve<sup>98</sup> nga subjektet amë nuk paraqet ndonjë burim të konsiderueshëm të financimit të aktiviteteve të bankave në Republikën e Maqedonisë.** Kështu, pjesëmarrja e obligimeve ndaj personave amë (përfshirë këtu edhe obligimet e subordinuara dhe instrumentet kapitale hibride) në totalin e obligimeve të sistemit bankar vendor, si dhe në totalin e obligimeve ndaj jorezidentëve<sup>99</sup>, në vitin 2016 është 2.4% dhe 25.3% përkatësisht. Pas periudhës disavjeçarë të zvogëlimit permanent të obligimeve ndaj subjekteve amë, në vitin 2016, këto burime të financimit shënuan rritje solide prej 37.7% (ose për 2.869 milionë denarë), e që është i përqendruar te tre banka dhe rrjedhin nga zmadhimi i obligimeve në bazë të depozitave afatshkurta dhe kredive afatgjata. Megjithatë, rritja vjetore e obligimeve ndaj subjekteve amë është rezultat i zmadhimit të tyre të konsiderueshëm, në tremujorin e fundit të vitit 2016. Me përjashtim të këtij zmadhimi më të konsiderueshëm, gjatë disa viteve të fundit, obligimet ndaj subjekteve amë shënojnë zvogëlim permanent, ndjekur edhe me shkurtim të afatizimit të maturimit të tyre.

<sup>98</sup> Burimet e financimit të bankave nga subjektet amë janë kryesisht në formë të depozitave afatshkurta dhe obligimeve në bazë të instrumenteve kapitale të subordinuara dhe hibride.

<sup>99</sup> Analizuar sipas bankave individuale, pjesëmarrja e obligimeve të bankave ndaj personave amë në totalin e obligimeve ndaj jorezidentëve lëviz në interval midis 1.4% dhe 35.1%.


## 2. Profitabiliteti

Edhe pranë jostabilitetit politik në vend, dhe rritjes së ngadalësuar ekonomike në vitin 2016, bankat ia dolën që në mënyrë të konsiderueshme ta përmirësojnë profitabilitetin e tyre, efikasitetin e të ardhurave respektivisht shpenzimeve, që nga ana tjetër kontribuoi në përmirësimin e produktivitetit të tyre. Rezultati financiar i realizuar është për një të tretën më i lartë në krahasim me vitin paraprak, që kryesisht rezultoi nga rënia e shpenzimeve. Kështu, edhe gjatë këtij viti, shpenzimet në bazë të normave të interesit shënojnë një rënie të konsiderueshme, në kushte të një rritje modeste të ardhurave nga normat e interesit, që në veçanti vërehet në rastin e ndërmjetësimit financiar me sektorin "familje". Zvogëlimi i korigjimit të vlerës, në veçanti për mjetet jofinanciare (të ndërmarra), paraqet të dytin faktor më të rëndësishëm lëvizës së profitabilitetit të lartë të sistemit bankar. Normat aktive dhe pasove të interesit shënuan rënie të ngadalësuar, ndërsa ndryshimet në politikën monetare, me qëllim të qetësimit të gjendjes në tregun e depozitave, kontribuuan në stabilizimin e normave pasove të interesit në denarë. Në rrethana të normave të ulëta të interesit, një ndër sfidat më të mëdha të bankave është mbajtja e profitabilitetit të lartë dhe përforsimi i kapacitetit për gjenerim të mëtejshëm të shumave solide të neto ta ardhurave nga normat e interesit.

Grafik. 108

Fitimi neto pas tatimit (lartë) dhe ndryshimi vjetorë i të ardhurave dhe të dalurave kyç (poshtë)

Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

### 2.1 Tregues të profitabilitetit dhe efikasitetit të sistemit bankar


Në fund të vitit 2016, rezultati financiar në nivel të sistemit bankar arriti nivelin prej 6.3 miliard denarë, që paraqet rritje për 1.7 miliardë denarë (ose 36.3%) në krahasim me vitin paraprak. Analizuar sipas bankave të veçanta, vetëm dy banka e kanë përmbyllur vitin me humbje. Tre bankat më të vogla shënuan rezultat financiar pozitiv, për herë të parë në dhjetë vitet e fundit. Në kushte të tregut jo mjaftueshëm të zhvilluar financiar, pasja e një sistemi bankar profitabël është me një rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh se fitimi i akumuluar luan një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e kapitalit dhe në ruajtjen e stabilitetit financiar.



Grafiku. 109

Norma e kthimit të aktivitet mesatar (POAA) dhe të kapitalit dhe rezervave mesatare (POAE) (majtas) dhe dinamika e komponentëve të tyre (djathtas)

Në përqind



Burimi: Banka Popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Fitimi më i lartë për vitin 2016, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikoi në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit dhe efikasitetit të sektorit bankar.** Normat e kthimit të aktivitet mesatar dhe të kapitalit mesatar shënojnë rritje permanente gjatë disa viteve të fundit dhe për vitin 2016 kapin nivelin prej 13.6% dhe 1.5% përkatësisht, që paraqet zmadhim për një të tretën krahasuar me vitin 2015<sup>100</sup>. Rritja e këtyre norma gjatë tre viteve të fundit, kryesisht mundet ti përshkruhet lëvizjeve më të konsiderueshme pozitive të margjina e profitit<sup>101</sup>. Krahasuar me vitin 2015 vërehet një rritje minimale e huazimit të bankave dhe nivelit të rrishtit të aktiviteteve bankare, por rritja më e konsiderueshme e margjinës së fitimit ka ndikim më të madh në zmadhimin e POAA dhe POAE. Treguesit e profitabilitetit dhe efikasitetit të sistemit bankar dhe grupeve të veçanta ta bankave janë të prezantuara në aneksin nr. 40 dhe tregojnë përmirësim të efikasitetit të bankave si në kontekst të ardhurave ashtu dhe në kontekst të shpenzimeve.

**Ndonëse fitimi neto shënon zmadhim të konsiderueshëm në vitin 2016, megjithatë margjina neto e normës së interesit ka mbetur e pandryshuar, respektivisht në nivelin 4.1%.<sup>102</sup>** Në fakt, zmadhimi i të ardhurave neto nga normat e interesit ( si një nga komponentët e neto margjinës së normës së interesit) paraqet forcë kyç lëvizëse të zmadhimit të rezultatit financiar (participon me 61.6% në rritjen e fitimit neto pas tatimit), por i njëjti kompensohet me rritje të njëjtë (relative) të aktivitet mesatar që sjell të ardhura në bazë të normës së interesit. Kështu të ardhurat neto nga normat e interesit shënojnë rritje solide prej 7.2% (ose 1.037 milionë denarë, ndërsa aktivi mesatar që sjell të ardhura në bazë të normës së interesit është zmadhuar për 25.299 milionë denarë (ose për 7.2%)<sup>103</sup>.

<sup>100</sup> Aktivi dhe kapitali janë të paraqitura si mesatare të gjendjes së aktivitet, respektivisht kapitalit më 31.12.2015 dhe 31.12.2016


<sup>101</sup> Norma e kthimit të kapitalit mesatar dhe rezervave mundet të paraqitet mesa vijon:  $POAE = \frac{P}{CR} * \frac{S}{S} * \frac{A}{A} * \frac{RWA}{RWA} = \frac{P}{CR} * \frac{S}{S} * \frac{A}{RWA} * \frac{RWA}{A}$   
 $PM * RWAturnover * L * RBAratio$ , ku: P=fitimi pas tatimit; CR=kapitali dhe rezervat mesatare; S=totali i të ardhurave të rregullta; A=aktivi mesatar; RWA=aktivi i ponderuar për riskun; PM=margjina e fitimit; RWAturnover=qarkullimi i aktivitet të ponderuar për riskun; L=leverixhi ose borxhi; RBAratio=treguesi i nivelit të pranuar të riskut.

Margjina e fitimit paraqet raport në mes fitimit (humbjes) dhe totalit të ardhurave të rregullta.

<sup>102</sup> Përcaktohet si raport në mes të ardhurave neto nga normat e interesit dhe aktivitet mesatar që mundëson realizim të ardhurave nga normat e interesit.


<sup>103</sup> Aktivi mesatar që mundëson të ardhura nga normat e interesit në vitin 2015 është rritur për 3.6% në krahasim me vitin 2014.

**Grafik. 111**  
Neto margjina e normës së interesit më 31.12.2016, në nivel të sektorit bankar (lartë) dhe sipas bankave të veçanta (poshtë)



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Grafik. 110**  
Shfrytëzimi i totalit së të ardhurave  
Në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

**Ndërmjetësimi financiar me familjet** ka luajtur rol kyç në mbajtjen e nivelit të normave marginale të interesit. Në vit të nivelit historikisht më të ulët të normave të interesit<sup>104</sup>, në kushte të ngadalësimit të rritjes së bazës depozitare<sup>105</sup> dhe ndryshimeve të konsiderueshme në strukturën e saj valutore dhe të afatizimit të maturimit, bankat arritën ti zvogëlojnë kostot në emër të normave të interesit, edhe atë madje për 14.7% (ose për 822 milionë denarë). Te të gjithë sektorët vërehet zvogëlim i kostove në emër të normave të interesit, por më e shprehur është te kostot në emër të normave të interesit për familjet, ku vërehet rënie prej 19.3% (respektivisht për 648 milionë denarë) duke kontribuar kështu me 79% në totalin e zvogëlimit të kostove në emër të normave të interesit<sup>106</sup>. Paralelisht me këtë, bankat i zmadhuan të ardhurat nga normat e interesit për 1.1% modeste (respektivisht për 215 milionë denarë), por sërish të ardhurat nga normat e interesit prej familjeve shënojnë rritjen më të madhe, prej 592 milionë denarë (ose 7.3%), që është rezultat i zmadhimit të aktivitetit kreditues me këtë sektor<sup>107</sup>. Përfundimisht, gjysma e rritjes së aktivitetit që sjell normë të interesit del nga rritja e aktivitetit kreditues me sektorin familje, ndërsa vetëm një e katërta e rritjes rezulton nga aktiviteti kreditues me shoqëritë jofinanciare.

**Edhe në vitin 2016 vazhdoi përforsimi i efikasitetit operacional të sistemit bankar, që vërehet përmes zvogëlimit të kostove operacionale për njësi të ardhurave totale dhe neto në emër të normave të interesit, si dhe për njësi të aktivitet mesatar, edhe pse kostot operacionale shënuan rritje prej 340 milionë denarë (ose**

<sup>104</sup> Më poshtë në raport vijon analiza e lëvizjes së normave të interesit. Për informata më të hollësishme mbi lëvizjen e normave të interesit vizitoni faqen zyrtare të Bankës Popullore.

<sup>105</sup> Për më detajistë mbi lëvizjet e depozitave shqyrtoni pjesën III 1.2 Depozite të subjekteve jofinanciare.


<sup>106</sup> Të dalurat në emër të normave të interesit për shoqëritë jofinanciare shënojnë rënie prej 48 milionë denarë (ose 8.5%).

<sup>107</sup> Të hyrat në emër të normave të interesit për shoqëritë jofinanciare shënojnë rritje prej 332 милиони денари, përkatësisht 3.9%.



Grafik. 112


Tregues të efikasitetit operacional të bankave  
Në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Grafik. 113

Shuma (lartë) dhe normat vjetore të ndryshimit (poshtë) të kostove për korrigjim të vlerës së mjeteve financiare dhe jofinanciare  
Në milionë denarë



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

3.1%). Gati gjysma e zmadhimit vjetorë të kostove operacionale është përqendruar te vetëm një bankë nga kategoria e bankave të mëdha, dhe e njëjta rezulton nga rezervimet shtesë më të larta për obligime potenciale në bazë të kontesteve gjyqësore. Krahas kësaj, rritje vjetore prej 128 milionë denarë (ose 2.9%) vërehet edhe te kostot për fuqinë punëtore, kategori kjo që individualisht ka pjesëmarrjen më të lartë në kostot operacionale prej 40.5%. Nga ana tjetër, është shënuar rritje edhe më e lartë e të ardhurave operacionale të bankave (për 6.8% ose 1.460 milionë denarë), në çka ndikim më të madh prej 71.1% kanë pasur të ardhurat neto në bazë të normave të interesit, por janë rritur edhe të ardhurat tjera jo<sup>108</sup>, për 6% respektivisht 422 milionë denarë (kjo rritje nuk rezulton nga zgjerimi i ndonjë aktiviteti jotrazicional bankar, por kryesisht është rezultat i zmadhimit të totalit të arkëtimit të kërkesave që paraprakisht kanë qenë të çregjistruara gjatë vitit 2016).


**Në kushte të përmirësimit permanent të funksionimit operacional të bankave, si në anën e të hyrave ashtu edhe në anën e të dalave, kostoja për përmirësim të vlerës që lëviz në mes 4 dhe 5 miliardë denarë, absorbon pjesë gjithnjë e më të vogël të ardhurave dhe fitimit të sistemit bankar.** Në vitin 2016 shpenzimet për korrigjim të vlerës së mjeteve financiare dhe jofinanciare shënojnë rënie prej 11% (ose për 549 milionë denarë) në krahasim me vitin 2015. Në përputhshmëri me këtë, një e treta e rritjes së rezultatit financiar në vitin 2016 ka të bëjë me zvogëlimin e korrigjimit të vlerës, si rezultat i një pjesë të pronësisë së konfiskuar<sup>109</sup>, por edhe zvogëlimin e nivelit mesatar të riskut të portofolit kreditore të bankave.

<sup>108</sup> Këtu bëhet fjalë për të ardhurat neto nga provizionet dhe kompensimet, të ardhura financiare neto dhe të ardhura tjera që nuk realizohen në bazë të normës së interesit.

<sup>109</sup> Shuma mesatare e bruto mjeteve të siguruar në bazë të kërkesave të pa-arkëtueshme gjatë vitit 2016 është zvogëluar për 14.3% (ose për 896 milionë denarë), në krahasim me vitin 2015. Kjo rënie kryesisht është e përqendruar te grupi i bankave më të mëdha.

Grafik. 114


Tregues të raportit në mes kostove për korigjim të vlerës dhe fitimit dhe të ardhurave neto në bazë të normave të interesit  
Në përqind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Grafik. 115

Norma aktive (lartë) dhe pasive (poshtë) të interesit  
Në përlind



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

## 2.2 Lëvizja e normave të interesit dhe diapazonit të tyre

**Normat aktive dhe pasive të interesit të bankave<sup>110</sup> vazhduan të zvogëlohen te të gjitha valutat, edhe gjatë vitit 2016 duke arritur kështu nivelin historikisht më të ulët në dy deceniet e fundit.** Kështu në vitin 2016, norma mesatare aktive dhe pasive e interesit ranë në 6.4% dhe 1.8% përkatësisht, që paraqet një zvogëlim prej 0.4 dhe 0.3 pikë përqindje përkatësisht, në krahasim me vitin paraprak. Rënia më e madhe e normës mesatare të interesit është vërejtur te kreditë në denarë me klauzolë devizore, edhe atë për 0.5 pikë përqindje si dhe te depozitat në denarë për 0.4 pikë përqindje. Krahasimi i normave të interesit për muajin Dhjetor të vitit 2016 në krahasim me po të njëjtin muaj të vitit 2015 tregon një zvogëlim të normave të interesit për totalin e kredive prej 0.3 pikë përqindje, si dhe lëvizje gati stagnuese të normave të interesit të depozitave, të cilat shënojnë një rënie për vetëm 0.1 pikë përqindje. Në vitin 2016 zvogëlimi i normave të interesit është më pak i shprehur në krahasim me vitin 2015.

Për dallim nga viti 2015 kur shtrirja e normave të interesit në një periudhë të caktuar shënoi rritje të jo konsiderueshme, **gjatë vitit 2016 diapazonet e normave të interesit, në përjashtim të diapazonit në denarë me klauzolë devizore, shënojnë një rënie të vogël por të vazhdueshme.** Në Dhjetor të vitit 2016 shtrirja në mes normave aktive dhe pasive të interesit është 4.4 pikë përqindje dhe është zvogëluar për 0.2 pikë përqindje në krahasim me po të njëjtin muaj të vitit paraprak. Diapazoni

<sup>110</sup> Duke filluar nga janari i vitit 2015, të dhënat mbi normat e interesit të bankave dhe kursimoret sigurohen përmes metodologjisë së re mbi normat e interesit. Të dhënat sipas metodologjisë së vjetër dhe asaj të re nuk janë tërësisht të krahasueshme, kështu që ndryshimet në normat e interesit në vete ngërthejnë edhe efektet nga ndryshimet metodologjike që janë në mënyrë më të hollësishme të elaboruara në faqen zyrtare të Bankës popullore si dhe në suaza të raportit mbi rreziqet e sistemit bankar në Republikën e Maqedonisë për tremujorin e tretë të vitit 2015, në faqen numër 70. Metodologjia e re mbi normat e interesit ndikim më të madh patën mbi normat pasive të interesit, meqë normat e interesit sipas shikimi dhe depozitat gjatë natës nuk shqyrtohen në suaza të përlogaritjes së normës së interesit të totalit të depozitave.






Grafik. 116

Diapazoni i normës së interesit, sipas valutës


Në pikë përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

Norma aktive dhe pasive të interesit në denarë, dhe shtrirja i normës së interesit të kreditë dhe depozitat e reja

Në pikë përqindje



Burimi: Banka popullore, në bazë të dhënave të dorëzuara nga ana e bankave.

mesatar në mes normave aktive dhe pasive të interesit është 4.6 pikë përqindje, që paraqet zvogëlim për 0.1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2015.

**Në maj të vitit 2016, për herë të parë që nga viti 2013, norma e interesit të shënimeve të thesarit u ndryshua, përkatësisht u rit nga 3.25% në 4%. Nga Dhjetori i vitit 2016 e deri në shkurt të vitit 2017, norma e interesit të shënimeve të thesarit u zvogëlua tre herë radhazi duke rënë në 3.25%.** Analiza e normave të interesit në denarë për depozitat dhe kreditë e reja tregon një shkallë më të lartë të reagimit këtyre norma të interesit ndaj ndryshimeve në politikën monetare krahasuar me reagimin e normave të interesit ndaj totalit të kredive dhe depozitave. Më konkretisht, efektet ishin më të shprehura në muajin kur ndodh ndryshimi i normës së interesit si dhe në muajin vijues.